

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**TRANSKRIPT**

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS  
TË MBAJTUR MË 11 MAJ 2006**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA  
ODRŽANE 11. MAJA 2006.**

---

Maj – Maja 2006.

## **RENDI I DITËS**

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 20,21 dhe më 27 prill 2006,**
- 3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore,**
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësinë publike,**
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike,**
- 6. Interpelanca e Ministrit Qemajl Ahmeti, me kërkesë të GP të PDK-së për gjendjen e rrugëve në Kosovë.**

## **DNEVNI RED**

- 1. Usvajanje dnevnog reda,**
- 2. Usvajanje zapisnika sa plenarne sednice održane 20/21 aprila 2006, i 27 aprila 2006,**
- 3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o građevinskom zemljištu, privatizaciji i davanju pod zakup građevinskog zemljišta,**
- 4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o javnom zdravstvu,**
- 5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o hidrometeorološkoj delatnosti,**
- 6. Interpelacija Ministra Qemajl Ahmeti, na zahtev PD PDK, o stanju puteva na Kosovu.**

## **T R A N S K R I P T**

### **I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS TË MBAJTUR MË 11 MAJ 2006**

**KRYETARI** – Kolegë deputetë, anëtarë të Kabinetit Qeveritar, mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë 76 deputetë, që do të thotë se mund t'ia fillojmë punës.

Gjithashtu ju njoftoj se rendi i ditës i propozuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës, bashkë me materialet e nevojshme, u janë shpërndarë deputetëve me kohë, andaj propozoj t'ia fillojmë punës.

Në pajtim me rrëgullat 6. dhe 23. të Rregullores së punës, në bázë të raportit të rekomanduar nga Komisioni Parlamentar dhe sipas kërkesës së grupeve parlamentare, Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka përgatitur dhe i propozon Kuvendit ta miratojë rendin e ditës të seancës së sotme plenare sipas ftesës u është shpërndarë deputetëve.

Lus deputetët që me ngritje dore ta miratojnë rendin e ditës të seancës së sotme.

Kush është për? Urdhëroni z. Emrush.

**DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI** – I nderuar kryetar i Kuvendit, të nderuar të pranishëm dhe kolegë deputetë.

A ka mundësi që të na jepet një informacion më i plotë për fatin e Ligjit për pjesëmarrësit e UÇK-ës dhe për viktimat e luftës së Kosovës, të miratuar kohë më parë nga Kuvendi ynë dhe të nënshkruar nga PSSP më 2 maj 2006, një ditë para protestave të studentëve dhe të atyre në vijim të lëvizjes "Vetëvendosje", për të cilin më vonë nga mediat morëm vesh se Zyra Ligjore e UNMIK-ut e ka ndryshuar dhe ia ka bërë një aneks, me të cilin i është ndryshuar përbajtja.

Kjo zyrë disa herë na ka ndihmuar, por edhe na ka penguar për nxjerrjen e ligjeve. Tash propozoj, sot ndërkohë të përpilohet dhe në fund të kësaj seance të miratohet një kërkesë e Kuvendit drejtuar z. Petersen, z. Kofi Anan dhe z. Ahtisari që Zyra Ligjore e UNMIK-ut përfundoj punën tanë, e para nga të gjitha zyrat e tjera, sepse në mbarim të mandatit ajo mund të luajë si në rastin e mësipërm që thashë, rol më shumë negativ sesa pozitiv. Ju faléminderit. Kërkoi të hyjë në rend të ditës.

**KRYETARI** – Ju faléminderit. Ne ende nuk kemi marrë kurrgjë nga z. Petersen, prandaj nuk kemi sqarim për këtë pyetje. Urdhëroni z. Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryetar. U futëm shumë shpejt në votim në rend të ditës, por nuk na u dha mundësia t'i shprehim vërejtjet tona lidhur me rendin e ditës.

Mendoj se sot në këtë seancë duhet të diskutojmë edhe për çështje të organizimit të brendshëm të Kuvendit. Siç e dini të nderaur kolegë deputetë, Kuvendi i Kosovës ka kohë që funksionon pa sekretar të përgjithshëm, madje ndërkohe është shpallur konkursi për sekretar.. Kjo seancë do të duhej të ishte e informuar me kohë për rrjedhën dhe për mënyrën e zhvillimit të këtij procesi. Sa kemi marrë vesh jozytarisht është formuar një panel 5- anëtarësh për përzgjedhjen e një rrethi më të ngushtë të kandidatëve, nga të cilët më vonë Kryesia do të përcaktohej për njërin prej tyre. Ky panel, duhet ta shpreh befasinë time, përbëhet nga 5 anëtarë, por vetëm 2 prej të cilëve janë anëtarë të këtij Kuvendi. Këta janë z. Nekibe dhe z. Nuran. Këtu duhet ta shpreh befasinë time, sepse është pozita jashtë këtij paneli. Ky sekretar i përgjithshëm a do të jetë sekretar vetëm për koalicionin qeveritar apo do të jetë sekretar për tërë Kuvendin e Kosovës. Pra për këtë kontest për opozitën që është një pjesë bukur e mirë e Kuvendit dhe janë 3 persona që vijnë nga shoqëria civile, nga qarget akademike, bile edhe nga ministria, kurse nuk e di pse, ndoshta për mungesë kuadrosh në këtë Kuvend, ky Kuvend ta zgjedhë njeriun që do t'i kryente punët administrative, apo pse, pra, duhet të shkojmë të marrim tjetërkund kuadër kur këtu kemi një sërë juristësh dhe kuadrosh që mund ta kryejnë këtë punë përmrekulli. Pra në këtë rast më duhet të kërkoj nga ju z. kryetar, që ta futni në rend dite këtë pikë që të mund t'i jepet një informacion seancës lidhur me mënyrën se si është përcaktuar që z. Gashi, z. Deda, z. Hoxha të janë anëtarë të panelit dhe opozita të lihet anash. Këtu e kam parasysh një vërejtje. Kryesia e Kuvendit është paraparë të punojë me konsensus, nuk e di se a ka pasur përpjekje të arrihet konsensusi në Kryesi. Siç kam marrë vesh, votimi ka qenë 3 me 3, pra një mbledhje e vetme, një diskutim i vetëm, një grup i vetëm i propozuar-, votimi 3 me 3- ka vendosur vota e kryetarit, pra sipas Rregullores parashihet se 1 me 2, pra ne duhet ta ndryshojmë konceptin e punës në këtë Kuvend. Me këtë, më duket po i kthehem praktikës së vjetër të imponimit dhe të zgjidhjeve të cilat bëhen sipas vullnetit vetëm të njërit anë. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ky është mendimi i juaj dhe keni të drejtë të mendoni asisoji. Sekretari do të zgjidhet për punët e Kuvendit, jo të partisë dhe mendoj, të lutem, se kjo çështje nuk është urgjente që të futet sot në rend të ditës. Fjalën e ka z. Ramë Buja. Urdhëroni një minutë e keni.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – z. kryetar, me respektin më të madh më duhet t'ju them që sekretari i Kuvendit zgjidhet për gjithë Kuvendin dhe ai duhet të jetë përgjegjës për të gjitha grupet në këtë Kuvend, prandaj nuk mund të jetë njëri që i përgjigjet vetëm një partie dhe vetëm një koalicioni. Mendoj se kjo gjendje tash është krejtësisht e papranueshme..

KRYETARI – Këtë e thashë edhe unë, sekretari është për tërë Kuvendin, jo vetëm për një parti.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Po vetëmse paneli është njëpartiak.

KRYETARI – Është Rregullorja që përcakton procedurën si shkon.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Do të kishim pasur dëshirë të kemi informacion z. kryetar.

KRYETARI – Urdhëroni z. Buja.

DEPUTETI RAMË BUJA – Të nderuar kolegë deputetë , i nderuari z. kryetar.

Unë do ta riaktualizoj çështjen që e shtroi z. Xhemajli, çështja e Ligjit për dëshmorët e luftës, viktimat civile, familjet e dëshmorëve, për aq sa është folur në mediat publike, është një intervenim skandaloz.. Është një precedent që ka ndodhur në mënyrë të çuditshme, procedura e ligjeve në Kuvend përfundon me nënshkrimin e kryetarit të Kuvendit dhe i përcillet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe ai mund të bëjë ndryshime, siç ka bërë shpesh, por duke ia kthyer përsëri Kuvendit për ta shqyrtuar në lexim të tretë.

Dhe kjo nëse ndodh që ky Ligj të shkojë me aq ndryshime dhe i nënshkruar nga kryeministri dhe, fatkeqësisht, nuk besoj se do taketë lexuar fare, sepse po ta kishte lexuar dhe po ta kishte parë se në Kosovë nuk paska pasur luftë, s'paska pasur dëshmorë, s'paska heronj etj. etj. nuk e kishte nënshkruar, por ne sugjerojmë që ky Kuvend të marrë qëndrim të kërkojë që ai ligj gjithsesi t'i kthehet Kuvendit për ta rishikuar dhe s'ka çka rishikon në fakt, sepse kemi vendosur ose të kundërtën :ne nuk mund ta njohim si ligj që është nxjerrë dhe është miratuar nga Parlamenti.

Dhe një çështje tjeter që dua ta ngre këtu është çështja e dhunës së përdorur nga Shërbimi Policor i Kosovës, për të cilin duhet të kemi qëndrim ne si kuvendarë. Unë në emër të Grupit Parlamentar ju them se nëse dikush nga qytetarët e Kosovës shkel ligjin si qytetar - Shërbimi Policor i Kosovës nuk duhet ta shkelë . Dhe skenat që i kemi parë në televizion për mua kanë qenë shqetësuese dhe m'i kanë kujtuar skenat e dikurshme dhe po ju them që Kuvendi duhet të apelojë duhet të sugjerojë që Shërbimi Policor i Kosovës të mos e komprometojë vetveten me veprime të tilla.

Unë nuk dua të hyj, a e paskan shkelur ligjin ata djem dhe vajzat që kanë bërë veprime të tilla ,por assesi nuk mund të arsyetohet shkelja e ligjit nga Shërbimi Policor i Kosovës, duke përdorur dhunën.

KRYETARI - Sa i përket ligjit posa ta marrim tekstin nga z. Petersen, mund të procedojmë në Kuvend. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDK-ës z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI - I nderuari z. kryetar. Ne si Grup Parlamentar e mbështesim rendin e ditës me një pyetje që e kemi shtruar me kërkesën e kryetarëve të grupeve parlamentare me kryetarin e Kuvendit.

Sipas Rregullores së punës së Kuvendit ,pikë e fundit e rendit të ditës duhet të jetë rendi i ditës i seancës e ardhshme.

Dhe pyetja ime është, pasi që këtu nuk e shohim atë propozim, cilat janë pikat për seancën e ardhshme, mos është paraparë që në seancën e jashtëzakonshme që është nesër,

për debat të jetë ,përndryshe lutja jonë është të respektohet Rregullorja e punës e Kuvendit. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Gjergj Dedaj.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Faleminderit shumë z. kryetar, të nderuar kolegë. Jam i të njëjtë mendim me ju, për një shqetësim shumë të drejtë që e paraqitet deputetët Xhemajli dhe Buja, por mund të vë në dijeni Kuvendin se atë ditë kur e kemi miratuar Ligjin për dëshmorët dhe për pjesëmarrësit e luftës, jeni ju -deputetë- që keni bërë lëshim dhe ju kujtohet mirë kur unë nuk votova për këtë ligj për faktin se martirët e luftës i keni quajtur "persona të vdekur" gjatë luftës në Kosovë dhe se ata nuk mund të jenë të vdekur gjatë luftës së Kosovës nëse janë vrarë, të ekzekutuar, që ua kanë marrë trupat dhe i kanë dërguar në Serbi, shumë prej cilëve ende nuk janë kthyer në Kosovë.

KRYETARI - Z. Dedaj nuk është në rend dite tash.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Z. kryetar a është a s'është në rend dite unë dua të flas për këtë çështje se është më e rëndësishme se ky farë Ligji për dhënien më qira, as toka ndërtimore, as rrugët që i keni bërë me gropë dhe nuk ke nga të ecësh.

KRYETARI – E kuptoj që është shumë më me rëndësi ky ligj, por kur të vijë radha do të bisedojmë. Ju lutem përbajuni rendit të ditës.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju lutem z. kryetar mos ma merrni fjalën, është hera e fundit që ma merrni fjalën kur kërkoj të flas, le të jetë hera e fundit, shikoni nuk mund të ma merrni fjalën z. Kryetar, se jam deputet i zgjedhur, nuk jam i nominuar, nuk ma ka falur kush këtë karrige, pra nëse ma merrni fjalën atëherë kemi metoda të tjera demokratike.

KRYETARI – Të gjithë që jemi në sallë i kemi votat e dikujt.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Kështu pra ,atëherë s'mund të ma merrni fjalën. Ju lutem mos ma merrni fjalën..

KRYETARI - Po të them se ta marr fjalën nëse fjala nuk i përket rendit të ditës.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Z. kryetar ju mund të ma merrni fjalën, se e keni njëfarë pulle atje, por ju them se kjo nuk është aspak demokratike e më së paku e ndershme, kur po flasim për njerëz që e kanë larë me gjak tokën e Kosovës, pra nëse ju nuk lini përshtypje, një gjë e tillë, po e përfundoj a është ky Kuvend që martirët e dëshmorët e Kosovës i ka quajtur "persona të vdekur" sikur të kishin vdekur prej gripit në Kosovë dhe për atë arsy e kemi devalvuar dhe shkelur gjakun dhe do të kemi pasoja të tjera gjithnjë.. Faleminderit.

KRYETARI – Ju thashë se posa ta marrim informatën e parë për Ligjin do ta vëmë në rendin e ditës dhe do ta shqyrtojmë. Urdhëroni,- deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA** – Ju faleminderit i nderuar z. kryetar. Grupi Parlamentar i Aleancës është i interesuar për funksionim të mirë të Kuvendit, por edhe për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit.

Më lejoni t'i referohem rregullës 23, në të cilën është rendi i ditës dhe ku thuhet:Në fund të çdo seance kryetari i Kuvendit ose një anëtar i Kryesisë, propozon rendin e ditës,- përveç në rastet nëse ndonjë grup parlamentar ose 6 deputetë e kundërshtojnë këtë. Dhe është çështje urgjente rregulla 29, ku në çdo seancë plenare deputeti në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit propozon që Kuvendi ta shqyrtojë me një çështje urgjente.

Mendoj që në këto seanca jemi duke krijuar një praktikë tjeter. Çështja është se rrjedha e seancës duhet të jetë propozimi dhe miratimi i rendit të ditës Ju pastaj shqyrtoni dhe shtroni çështje të tjera, ka rregulla si kryhet kjo dhe është shumë mirë e shkruar në Rregulloren e punës. Nëse deputetët duan të shtrojnë çështje të tjera, mund të bëjnë në fund ose mund ta bëjnë me shkrim ose në qoftë se është një çështje urgjente. Ju kisha latur ta zbatoni këtë rregull. Ju faleminderit.

**KRYETARI** – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

**DEPUTETI HYDAJET HYSENI** – Faleminderit z. kryetar. Unë sërisht për të satën herë një pyetje për pyetjet parlamentare.E kam pasë bërë një pyetje në Parlament, kërkoi përgjigje.Pyes pse nuk vijnë përgjigjet? Faleminderit.

**KRYETARI** – Vazhdojmë me rendin e ditës. Në pajtim me rregullin 6 pika 23 të Rregullores së punës, në bazë të raportit të rekomanduar nga komisionet parlamentare, si dhe sipas kërkesës së Grupit Parlamentar, Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka përgatitur dhe i propozon Kuvendit miratimin e rendit të ditës i seancës së sotme plenare sipas ftesës dhe materialit të shpërndarë. Lus deputetët që me ngritje dore ta miratojmë rendin e ditës.

Kush është për? Ju lutem numëroni votat. Faleminderit, a ka kundër? Po, 6 vota kundër. Ju faleminderit. Konstatoj se rendi i ditës miratohet.

Para se të kalojmë në miratimin formal të këtyre procesverbaleve, do të thotë në pikën e dytë të rendit të ditës, në emër të Kryesisë së Kuvendit më duhet ta jap një sqarim lidhur me vendimmarrjen e 4 anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media. Lidhur me procesverbalin e seancës plenare të datës 27 prill 2006 pika 7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad-hoc parlamentar për emërimin e 4 anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, me kërkesën time dhe në pajtim me rregullin 62 të Rregullores së punës, Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2006, i rekomandon Kuvendit ta miratojë ndryshimin që do të pasqyrohet në këtë procesverbal, si vijon.

Në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 27 prill 2006, me rastin e shqyrtimit dhe të votimit të rekomandimit të Komisionit ad-hoc Parlamentar për emërimin e 4 anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, për shkak të paqartësive dhe të shpërputhjeve gjuhësore të tekstit në dispozitat e Ligjit me ttë cilat rregullohen mënyrat e vendimmarrjes, është aplikuar nenii 4 pika 3 c) në vend të nenit

4.4. g) të Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim. Sipas nenit 4.3 c) të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetim - në tekstin shqip-thuhet: citoj: Anëtari vendor i Këshillit konsiderohet i emëruar kur për të të kenë votuar më se 50% të deputetëve të Kuvendit, ndërsa teksti anglisht është: Anëtari vendor i Këshillit konsiderohet i emëruar kur për të kanë votuar më se 50% të deputetëve të pranishëm të Kuvendit.

Pra është një mospërputhje gjuhësore që ka ndikuar në procesin e vendimmarrjes në seancën e kaluar.

Ndërsa sipas nenit 4.4 g) të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, që ndërlidhet me rekomandimin e Komisionit ad-hoc Parlamentar thuhet, citoj: Kuvendi i Kosovës duhet ta vërtetojë formalisht emërimin e anëtarit të Këshillit nga shoqëria civile brenda 30 ditësh pasi të jenë paraqitur zyrtarisht nominimet. Sipas ... pikës 9.1.33 të Kornizës Kushtetuese si dhe të rregullës 31.3. të Rregullores së punës vendimet e Kuvendit miratohen me shumicë votash të deputetëve të pranishëm të Kuvendit që votojnë, përvèç rasteve kur në Kornizë Kushtetuese ose me Rregullore parashihet ndryshe.

Siq dihet në seancën e datës 27 prill 2006, gjatë procedimit me vendimmarrje, propozimi për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga shoqëria civile, nga gjithsej 74 deputetë të pranishëm, 57 deputetë kanë votuar për, 11 kundër dhe 6 abstenime.

Duke pasur parasysh dispozitat e lartpërmendura Kuvendi duhet të konfirmojë se deklarimi i 57 deputetëve ka qenë i vlefshëm për të konstatuar miratimin e propozimit për emërimin e 4 anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm të Pavarur për Media nga shoqëria civile.

Lus deputetët që me ngritje të dorës të deklarohen për miratimin e këtij sqarimi. Kush është për? Faleminderit. Kundër 1. Urdhëroni z. Rahmani.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Z. kryetar lidhur me këtë çështje unë herën e kaluar kam ngritur këtë çështje, madje, edhe jam ngritur në këmbë dhe ju thashë që 50%, apo shumica e deputetëve që kanë votuar në këtë parlament, ky vendim duhet të shkojë i aprovuar, por kryesuesi më ka thënë që nuk është ashtu, duhet të jenë 61 deputetë e tash po del ashtu qysh kam thënë. Për këtë arsyesh kundër.

KRYETARI – Faleminderit. Kemi votuar për këtë plotësim, përkatësisht për këtë sqarim. Ju faleminderit.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 20 e 21 prill 2006 dhe të seancës plenare të datës 27 prill 2006 me vërejtjet e prezantuara. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

### **3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tokën ndërtimore, privatizimin dhe për dhëni me qira të tokës ndërtimore**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 10 prill 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Vërejtjet parimore do t'u drejtohen për shqyrtim Komisionit Funksional përgjegjës për reportin dhe komisioneve kryesore.

Ftoj sponsorin e ligjit ta marrë fjalën. Zëvendëskryeministri, z. Haziri, urdhëroni.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI LUTFI HAZIRI – Faleminderit i nderuari z. kryetar, të nderuar, zonja dhe zotërinj.**

Në këtë mbledhje të Kuvendit, Qeveria para jush e paraqiti Projektligjin për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhëni me qira të tokës ndërtimore, iniciativë që ka filluar vitin e kaluar në Zyrën e kryeministrat.

Ky projektligj është i nevojshëm me qëllim që në Kosovë të rregullohen të drejtat dhe detyrimet lidhur me tokën ndërtimore dhe me rregullimin e saj, me kushtet, me mënyrën dhe procedurat e privatizimit të tokës dhe me dhëni me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Kosovës dhe në pronësi tjetër.

Nevoja për këtë projektligj është e madhe, se është i domosdoshëm, ngase Kosovës i nevojitet një legjislativ i tillë i reformuar dhe demokratik për rregullimin e kësaj fushe, sepse Kosova po kalon në një ekonomi të lirë dhe treg të hapur ku rregullat juridike për zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore juridike në rregullimin e tokës ndërtimore, privatizimin dhe dhëni me qira të kësaj toke, duhet t'u përshtaten rrethanave të reja të krijuara në Kosovë dhe standardeve evropiane.

Po ashtu ky ligj, kompetencat e rezervuara të çështjes e pronësisë ka paraparë me kreun 8 të Rregullores nr. 2 me 1/19 dhe 9 të Kornizës Kushtetuese. Mirëpo, duke pasur parasysh nevojën për këso ligjesh, me qëllim që të rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me tokën ndërtimore, si dhe duke u bazuar në faktin se ky projektligj ka qenë i paraparë në planin legjislativ për vitin 2005, si prioritet nga plani i standardeve për Kosovën, përgatitja e tij ka qenë e detyrueshme dhe përgjegjësi e institucioneve të Kosovës.

Projektligji është hartuar nga grupei qeveritar i përbërë nga ekspertë vendorë të fushës përkatëse, ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme të parapara me Rregulloren e punës së Qeverisë, po ashtu është harmonizuar edhe standardizuar, në përputhje edhe me legjislativin e Bashkësisë Evropiane.

Sipas rëndësisë që ka ky ligj për e vendin tonë, ju propozoj ta miratoni në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen të vijnë në suazat e Kornizës ligjore adekuate në Kosovë. Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit z. zëvendëskryeministër. Fjalën e ka Nerxhivane Dauti.

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë.

Projektligji për tokën ndërtimore, për privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore, Ligji për të drejtat sendore, Ligji për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme, Ligji për detyrimet dhe Ligji për koncesionet, janë ligje kryesore që paraqesin bazamentin e ekonomisë së lirë të tregut. Duke u mbështetur në mësimin kryesor të formimit të infrastrukturës ligjore për rregullimin e fushës juridike për trokën ndërtimore, Projektligji i propozuar rregullon detajisht tërësinë e të drejtave dhe të detyrimeve lidhur me rregullimin juridik të tokës ndërtimore, procedurën e privatizimit të tokës ndërtimore dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Kosovës. Toka ndërtimore është e mirë me interes të përgjithshëm të Kosovës dhe gjëzon mbrojtje të veçantë juridike. Si e tillë toka ndërtimore, në procedurë të caktuar mund të privatizohet, të jepet me qira dhe me koncesion.

Ligji është mjaft voluminoz, gjithsej i ka 102 nene. Është kompleks, në shumë kapituj mjaft i ndërlikuar. Ligji mund të sjellë probleme në praktikë, sidomos tek implementuesit e ligjit të propozuar edhe për nga fakti se kjo sferë ende konsiderohet kompetencë e rezervuar. Sipas nenit 10 të këtij ligji, tokën ndërtimore në pronësi të Kosovës e administron Qeveria e Kosovës. Me këtë rast duhet të saktësohet cili është organi kompetent që duhet t'i bëjë administrimin, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore në pronësi të Kosovës.

Bartja e pronësisë dhe dhënia me qira e tokës ndërtimore bëhen me ankand publik dhe me marrëveshje të drejtpërdrejtë. Toka ndërtimore e Kosovës mund të jepet me koncesion konform Ligjit të koncesioneve. Tokën ndërtimore në pronësi të Kosovës, Qeveria e Kosovës mund t'ia japë me koncesion personit fizik dhe juridik të brendshëm ose të jashtëm, nëse destinimi i saj është në interes të përgjithshëm të Kosovës.

E drejta e qirasë afatgjatë është një çështje tjeter me rëndësi kapitale që e rregullon ky ligj. Në tokën ndërtimore mund të konstituohet e drejta e qirasë afatgjatë në favor të personit fizik dhe juridik të brendshëm, në procedurën ligjore.

Qiradhënia afatgjatë është e drejtë sendore dhe regjistrohet në librat publikë për regjistrimin dhe për evidencimin e të drejtave për paluajtshmëri. Ligji parashev decidivisht se qiradhënia mund të jetë më së shumti për 99 vjet. Bartësi i së drejtës së qirasë afatgjatë është personi në emër dhe në favor të cilët kjo e drejtë është themeluar, ose ka kaluar tek ai.

Sipas Ligjit e drejta e qirasë afatgjatë detyrimisht regjistrohet në librat publikë për regjistrimin e të drejtave në pajtueshmëri me nenin 34 të Ligjit që ka të bëjë me shuarjen e së drejtës së qirasë afatgjatë për shkak të shuarjes të së drejtës së pronës, kur duhet harmonizuar me Ligjin për të drejtat sendore, ndërsa për shuarjen e së drejtës për qira afatgjatë, heqje dore me zgjidhjen e kontratës duhet të harmonizohet dhe të zbatohen dispozitat e Ligjit për detyrimet.

Një çështje tjetër, objekt i rregullimit të këtij ligji, është edhe privatizimi i tokës ndërtimore. Toka ndërtimore në pronësi të Kosovës mund të privatizohet me të drejtë pronësie të personave fizikë dhe juridikë të brendshëm – vendorë, shfrytëzues të tokës ndërtimore. Ky privatizim mund të jetë në tërësi ose në pjesë. Ligji parashevë në nenin 55 afatin prej dy vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji për urdhëresën për privatizim, që mendoj se është afat i gjatë.

Në nenin 70 të Ligjit është përcaktuar se lartësia e qirasë për tokën ndërtimore, që është objekt i qirasë afatgjatë, mënyrën dhe procedurën e pagimit të saj ,i cakton Qeveria e Kosovës, i propozon ministrit kompetent. Vërejtja e parë është cili është ai ministër që e bën një gjë të tillë, siç theksohet në Ligj. Në të njëjtin nen, paragrafi 2 theksohet se Qeveria e Kosovës cakton me akt të veçantë organin kompetent që përcakton zonat e tokës ndërtimore dhe lartësinë e qirasë ,që duhet të paguhet, por nuk e precizon aktin juridik të veçantë të domosdoshëm.

Vërejtja III konsiston në nenin 7, ku duhet të precizohen dispozitat konkrete për privatizimin e tokës ndërtimore,në të cilën është njohur e drejta e qirasë afatgjatë që mund të privatizohet me shpërblim.

Vërejtja IV kontrata për qiranë afatgjatë të tokës ndërtimore rregullohet me nenin 79.Ky nen duhet të harmonizohet ne pjesën e veçantë të Ligjit për detyrimet, me qëllim të përcaktimit të mënyrës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore, në të cilën njihet e drejta e qirasë afatgjate, detyrimi për bartjen e së drejtës së qirasë afatgjatë pronarit të objektit në rast të shitjes së objektit të ndërtuar në tokën në të cilin është fituar e drejta e qirasë afatgjatë.

Vërejtja V ka të bëjë me nenin 82, ku theksohet se aktvendimi për qiranë afatgjatë i dërgohet bartësit të së drejtës dhe organit kompetent, por nuk precizohet cili është ai organ kompetent.

Vërejtja VI lidhet me nenin 84, ku duhet të precizohet cili është organi kompetent i Kosovës që paraqet padi për mospërbushjen e plotë të kontratës së qirasë afatgjatë të tokës ndërtimore.

Vërejtja VII Paraqitet në nenin 85 paragrafi 2, ku patjetër duhet të precizohet ministri kompetent që e administron tokën ndërtimore, që parashevë formën, përmrbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës, kur kërkesat e paraqitura për aktvendimet e miratuarë dhe të anuluara për kontratat për qiranë afatgjatë, si dhe për paraqitjen e padive për përbushjen e detyrimeve për qiranë afatgjatë.

Vërejtja VIII duhet të precizohet saktësisht cila është procedura e veçantë për lirimin dhe për ndërprenjen e pagimit të shpërbimit. Sipas rregullës, procedura për lirimin e përkohshëm nga pagesa e shpërbimit për privatizim, për marrjen e qirasë afatgjatë, fillon me kërkesën e personit fizikë si bartës i të drejtave të caktuara në tokën ndërtimore dhe kërkesës i bashkëngjitet aktvendimi i organit shtetëror të administratës kompetent për çështje sociale, me të cilin vërteton statusin e shfrytëzuesit të ndihmës sociale ,përkatësisht të mbrojtjes sociale.

Vërejtja IX në nenin 91, të precizohet konkretisht cili është organi shtetëror kompetent i administritimit për çështje pronësore – juridike.

Ligi në nenin 94, parasheh marrjen e së drejtës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore me interes publik, me propozim të tokës- organit që kujdeset për mbajtjen e pronësisë së Kosovës, por nuk precizohet se në cilin ligj konkret të veçantë dhe me cilën procedurë do të merret e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore që është me interes vital publik.

Vërejtja e fundit dhe më fundamentalja është se toka ndërtimore – pra administrimi i saj, si tokë në pronësi të Kosovës, privatizimi dhe dhënia me qira e tokës ndërtimore janë kompetencë e rezervuar.

Ky ligj është i lidhur ngushtë edhe me ligje të tjera, në veçanti me Ligjin për të drejtat sendore që rregullon çështjet më vitale të shoqërisë sonë, siç janë pronësia, posedimi, servitet, hipoteka, uzufruki etj. Ky ligj është miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2004, por që nuk është nënshkruar nga Përfaqësuesi Special. Në Kosovë z. zëvendëskryeministër ende zbatohet Ligji i aplikueshëm i lartpërmendur. Mosbatimi i Ligjit të ri për të drejtat sendore është duke paraqitur probleme të mëdha në praktikën gjyqësore, që në kohën e fundit ka raste edhe më të rënda të vrasjeve në Prishtinë, Shtime, Besianë, ku si shkak kryesor janë konfliktet e rënda të pa zgjidhura pronësore.

Kërkoi nga Qeveria e Kosovës të marrë masa adekuate – urgjente për përvijimin e nënshkrimit të këtij ligji.

Sa i përket Projektligjit të propozuar, me gjithë vërejtjet e shumta të paraqitura në emër timin dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, e përkrah parimi i Ligjin në shqyrtimin e parë, ndërsa kontributin tim profesional lidhur me amendamentet përkatëse të Ligjit do ta jap në Komisionin funksional.

Ju faleminderit.

**KRYETARI** – Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës fjalën e ka deputeti Shaban Halimi.

**DEPUTETI SHABAN HALIMI** – I nderuari z. kryetar, z. zëvendëskryeministër, ministra të nderuar, kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike në mbledhjen e vet të rregullt ka pasur në shqyrtim edhe Ligjin për tokat ndërtimore, dhëni me qira të tyre e në shfrytëzim dhe në këtë drejtim deputetët në komisionet funksionale kanë dhënë kontributin e tyre në punën për ligjin në fjalë.

Vërejtjet dhe sugjerimet që u janë dhënë nga anëtarët e komisioneve funksionale dhe nga deputetë të tjera të Grupit Parlamentar, kanë rezultuar se ligji meriton t'i jepet vota pro në lexim të parë. Projektligjit në lexim të parë t'u mundësohet komisioneve funksionale për punë të mëtejshme.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike është bazuar në këto arsyet që të japë votën e vet pro këtij Projektligji.

Nën 1 materia të cilën e rregullon Projektligji në fjalë është mjaft komplekse dhe shumë interesante, jo vetëm për qytetarët, por edhe për bizneset rurale si dhe për vendet urbane.

Nën 2, kjo materie nuk ka qenë e rregulluar me ligje funksionale, që kanë qenë në interes, por me ligje jofunksionale të cilat kanë qenë të bazuara në ekonominë shoqërore dhe me ekonominë në realitet në pronën shoqërore dhe në ekonominë planifikuar, kurse tani jemi në kushtet e ekonomisë së tregut dhe në kushtet e pronës private.

Nën 3, ky ligj do mundësojë përshpejtimin e veprimeve në drejtim të shfrytëzimit të tokës ndërtimore dhe

Nën 4, ky ligj do ta përspejtojë nevojën e nxjerrjes së një ligjit të tjetër bazik shumë të domosdoshëm, ligjin për pronat.

Sigurisht këtë ligj e përshkojnë edhe mungësi që grupei parlamentar përfundon në mungesë së një ligji përtokat do ta ngushtojë veprimtarinë e tij në të gjitha tokat dhe në statusin e tyre.

Prandaj nxjerrja e Ligjit pér pronat është e domosdoshme, pér çka Qeveria sa më parë duhet ta merrë iniciativën pér ta nxjerrë këtë ligj. Në këtë ligj sigurisht se ka mangësi edhe në përkthime kur fjalitë në gjuhën shqipe nuk janë në përputhje dhe humbin kuptimin në gjuhën serbokroate dhe anasjelltas. Nën 3, ka edhe afate shumë të shkurtra të shfrytëzimit të tokave në shfrytëzim. Nën 4, ka nene të përsëritura që duhet të precizohen dhe ka nene që duhet të eliminohen.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike mendon se këto të meta janë të riparueshme, prandaj mendon që t'i jepet vota pro në leximin e parë të këtij Projektligji. Faleminderit z. kryetar.

KRYETARI – Ju faleminderit. Në emër të AAK-ës fjalën e ka deputeti Mazlum Kumnova.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Z. kryetar, zëvendëskryeministër dhe ministër. Grupi i AAK-ës në këtë Kuvend ka marrë në dorë Projektligjin për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore, të hartuar nga Qeveria dhe me këtë rast ka konstatuar se ky ligj është kuadër që cakton norma për rregullimin e regjimit të tokës ndërtimore në mënyrën, kushtet dhe në procedurat e privatizimit dhe me qira të tokës ndërtimore në pronësi, do të thotë çfarë është me rëndësi për realizimin e së drejtës dhe të detyrimeve të marrëdhënieve pronësore juridike në tokën ndërtimore.

Ky Projektligj ka qenë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për t'i kapërcyer dispozitat e një ligji të viteve 80-ta që zbatohej i kufizuar në raste të veçanta në realitetin e ri të krijuar në Kosovë, sipas qëllimeve të përaktuara që janë formësuar. Me dispozitat e këtij projektligji vërehen qasjet e pretendimet që të rregullohen edhe disa çështje të pronësisë edhe pse ende nuk kemi ligj të tillë në Kosovë.

Nga kapitulli IV deri në kapitullin VII janë propozuar zgjidhjet për privatizimin e tokës ndërtimore në pronësi të Kosovës të personave fizikë dhe juridikë me ose pa shpërblim, çështjet të trashëgimisë, fitimi i së drejtës afatgjatë e tjera. Me siguri këtu kemi të bëjmë me dispozitat me të cilat duhet të rregullohet, me Ligjin për pronën, që nuk e kemi, pa dyshim kjo çështje duhet të shqyrtohet e hapur.

Sipas hartuesit të gjitha këto çështje janë harmonizuar me standarde ndërkombëtare, duke hapur mundësi dhe dhënie sigurie, sidomos tek investimet e huaja. Në këtë drejtim dispozitat janë harmonizuar me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe për mbrojtjen e natyrës, me ligjet që ka miratuar ky Kuvend. Kostoja e zbatimit e këtij ligji do të jetë e lartë, mirëpo sipas hartuesit nuk mund të tejkalohet lehtë, sepse krijon të hyra nga procesi i privatizimit, i dhënies me qira etj.

Ne mendojmë se ky projektligj duhet të mbështetet në parim dhe ta procedojmë në komisione, ku mund të bëhen edhe korrigjimet e nevojshme. Faleminderit z. kryetar.

KRYETARI – Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ fjalën e ka deputeti Husnija Beshkoviq.

**DEPÙTETI HUSNIJA BESHKOVIQ** - Nacrt zakona o građevinskom zemljištu, privatizaciji i davanju pod zakup građevinskog zemljišta je Zakon koji određuje norme regulisanja građevinskog zemljišta, uslova, način i postupak privatizacije kao i pravila o davanju pod zakup građevinskog zemljišta u vlasništvu Kosova, na osnovu kojih nosioci prava ostvaruju ova prava i obaveze imovinsko-pravnih odnosa preko nadležnih institucija Kosova.

Nacrt zakona o građevinskom zemljištu je još jedan u nizu Zakona koji je neophodan radi kompletiranja zakonskog okvira Kosova. Pošto Kosovo prolazi kroz tranzicije i u ekonomiji i ide se ka tržišnoj ekonomiji i novoj fazi demokratskog sistema gdje se i pravna pravila o rešavanju imovinsko pravnih odnosa u režimu građevinskog zemljišta trebaju prilagoditi novonastalim okolnostima na Kosovu.

Ova zakonska materija dosada je bila regulisana prevaziđenim starim zakonima iz 80.tih godina koji nisu bili standardizovani međunarodnim standardima i direktivama Evropske Zajednice i kao takve neophodno je bilo ih zamjeniti novim Zakonom.

Nacrt zakona o građevinskom zemljištu je po našoj oceni veoma sadržajan i kvalitetan i na veoma dobar način daje zakonska rešenja materiji koju tretira i nastoji da odgovarajući subjekti – pravni i fizički – na što efikasniji i racionalniji način ostvaruju prava i obaveze imovinsko pravnih odnosa građevinskog zemljišta u procesu privatizacije i davanja u zakup istog.

Ovaj Nacrt zakona zadire u rezervisane nadležnosti UNMIK-a u djelu imovinskih pitanja međutim, imajući u vidu potrebu za ovim zakonom i da je isti 2005. godine predviđen kao prioritet iz plana o standardima o Kosovu, njegova priprema usvajanja i implementacije je u odgovornosti i nadležnosti institucija Kosova.

Parlamentarna Grupa 6+ u načelu prihvata N.Z. o građevinskom zemljištu i dače svoj doprinos u daljem procesiranju Zakona.

**KRYETARI** – Ju faleminderit. Në emër të ORËS fjalën e ka deputeti Gazmend Muhaxheri.

**DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI** – Faleminderit z. kryetar, të nderuar z. zëvendëskryeministër, ministra, deputetë.

Kemi para nesh një ligj i cili mund të sjell probleme të mëdha në të ardhmen, një ligj i ngjashëm nuk ekziston në vendet e bashkësisë evropiane këto na thotë edhe shpresa që na është bashkëngjitet bashkë me ligjin do me thanë Zira për procese të integrimit evropian thotë se një ligj i ngjashëm nuk ekziston në vendet e Bashkësisë Evropiane. Shtrohet pyetja pse duhet të ekzistoj atëherë në Kosovë.

Neni 10 i këtij ligji në mënyrë eksplikite ose me një akt të veçantë thotë se Qeveria do të caktojë organin kompetent i cili do të merret me çështjen e administrimit, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore. Në një mënyrë po tentohet të krijohet një AKM-ë e vogël ose një mini AKM-ë e cila pronën e Kosovës atë që ka mbet pa u privatizuar në të ardhmen do ta privatizoj me akte të veçanta.

Neni 30 thotë se Qeveria do t'i jap me qira komunave tokën ndërtimore edhe atë në afatgjatë, do me thanë komunat po privohen nga pasuria e tyre ndoshta e vetme që munden me e pas toka ndërtimore, telashet që do të dalin nga ky privatizim posaçërisht mbasi jemi në tranzicion edhe ku papërgjegjshmëria dhe jo transparencë dhe korrupzioni janë në mitje të sipërm ky ligj do të legalizoj do me thanë shitjen edhe e asaj prone që ka mbet në pronësi të Kosovës.

Ne si Grup Parlamentar nuk epim pikën ose përkrahje këtij ligji.

**KRYETARI** – Faleminderit. fjalën e ka deputeti Rifat Krasniq.

**DEPUTETI RIFAT KRASNIQ** - Faleminderit z. Kryetar.

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Tarım ile Çevre Komisyonu adına, birkaç Bakanlığın işbirliği sayesinde hazırlanan İnşaat arazilerine ait Yasa Tasarısının hazırlanmasını selamlıyorum. Kosovanın ekonomi gelişmesi, buna benzer Yasalara bağlıdır ve Kosova Meclisinde Yasalar onaylandığı sırada, buna benzer Yasalara öncelik verilmelidir diye düşünüyorum. Çünkü, bayındırlık objelerinin inşa edilmesi, çevrenin korunması ve alan planlaması gibi ekonominin değişik alanlarında yabancı yatırımların sağlanması ile uyumlaştırılması büyük önem taşımaktadır.

Kosova Enstitülerinin sorumluluğu, mülk hakları sözkonusu olduğunda, bu Yasanın zeddeleyebileceği yedek yetkileri teşkil etmektedir. Yukarıda sözünü etmiş olduğumuz nedenlerden ötürü, bu Yasaya büyük gereksinimin duyulmasına rağmen, Tarım ile Çevre Komisyonu, sözkonusu Yasa Tasarısı görüşüldüğünde Fonksiyonal Komisyonunun çalışmalarına katılmış olacaktır.

İlginize teşekkürler!

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelemndi

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit. I nderuari kryetar, zëvendëskryeministër, të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, kolegë deputetë dhe të pranishëm të tjerë.

Duke ju përvendetur më lejoni të paraqes disa vlerësimë të mia lidhur me propozimligjin për tokat ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokave ndërtimore.

Në fazën kur Kosova po kalon në ekonominë e tregut dhe rregullat juridike përrregullimin dhe zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore juridike po ndryshojnë, është më se i domosdoshëm miratimi i këtij propozim ligji, ndonëse ka disa të meta, Në anën tjetër ligji i vjetër përrregullimin e tokave ndërtimore është tejkaluar me zgjedhjet e vjetra juridike, ekonomike tani të papranuara përrrethanat tona. Për këto shkaqe dhe shumë të tjera ne në Kosovë na duhet infrastruktura ligjore për tokat ndërtimore në pajtueshmëri me standarde ndërkombëtare për ta bërë specifikimin e tokave ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tyre.

Vlerësoj se edhe ky propozim ligj është dashur të miratohet pas pënxjerrjes së Ligjit përrpronën, sepse në këtë mënyrë ne nuk mund ta sigurojmë infrastrukturën për investime të huaja, nuk mund të realizohet ndërtimi urban, mbrojtja e ambientit dhe as planifikimi hapësinor pa ligjet themelore.

Pra, ky propozim ligj vështirë do të zbatohet, pa kthimin edhe të tërë dokumentacionit kadastrat të uzurpuar nga serbët, për këtë nuk duhen shumë komente. Paraprakisht në propozim ligj do të duhet përcaktuar në nivelin qendror se cilat toka ndërtimore do të jepen për ndërtim dhe përrprivatizim dhe cilat do të mbeteshin në nivelin komunal, sepse në këtë rrafsh do të lindin problemet pronësore. Duke pasur në konsideratë punën që ka bërë grupi i ekspertëve përhartimin e këtij propozim ligji, me gjithë atë vlerësoj se duhet t'i them edhe këto:

1. Preamble ende nuk është në rregull dhe në përputhje me vendimin e këtij Kuvendi.
2. Është mirë se prona shoqërore me këtë propozim ligj është bërë pronë e Kosovës, por nuk kemi instrumente juridike të mjaftueshme se si të mbrohet ajo. Shiko nenin, 3 pikën 1.
3. Çdo qyteti duhet t'i përcaktohet vija kadastrale në mes tokës urbane ndërt dhe asaj jo urbane, për të pasur pastaj raporte të qarta ndërtimore në nivelin komunal atje ku gjendet toka dhe prona.
4. Mënyra dhe kriteret e privatizimit të tokës ndërtimore në pronësinë e Kosovës nuk janë përcaktuar sa duhet përrrethanat kosovare.
5. Pra, në nenin 5 nuk duhet të figurojë regjim juridik, por rend juridik.
6. Propozim ligji nuk përcakton veprimtarinë juridike dhe masat preventive kur tokat ndërtimore nuk shfrytëzohen sipas destinimit si dhe përparësive të blerjes së tokave

ndërtimore, duke mos e saktësuar organin kompetent ,që do ta administronc, privatizonte dhe do t'i jepte me qira tokat ndërtimore në pronësi të Kosovës

7. Bartja e pronës dhe dhënia me qira e tokave ndërtimore duhet të bëhet vetëm me ankand publik dhe assesi me marrëveshje drejtpërsëdrejti (shiko nenin 13, pika 2), sepse hap mundësi për keqpërdorime dhe forma të tjera të cilat janë prezente në të gjitha shoqëritë dhe pronat tona.

8. Propozimligji le në kompetencë të komunave t'i rregullojnë tokat ndërtimore, por nuk përcakton organi as procedura se si të realizohet kjo në kuptimin juridik.

9. Dhënia e tokave me qira për 99 vjet edhe pse është standard , është e padrejtë në rrëthanat tona, pa arsy e paargumentuar nga fakti se te ne nuk janë bërë denacionalizimi dhe dekonfiskimi i pasurisë së qytetarëve, në veçanti të atyre shqiptarë nga regjimet paraprake ku është marrë ,siç e dimë të gjithë, në mënyrë jo vetëm kundërligjore, por edhe me dhunë dhe me pasoja të rënda.

10. Dhënia e tokës ndërtimore pa shpërblim në këtë propozimligj nuk është përpunuar dhe përcaktuar sa duhet si dhe në cilat raste nuk mund të bëhet . Së fundi ,shikuar në tërësi, ky propozimligj i plotëson kriteret për procedim të mëtutjeshëm kuvendor, ndonëse ka nevojë për paraqitje të amendamenteve.. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Milazim Haliti, le të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi dhe kandidati i fundit.

DEPUTETI MILAZIM HALITI – I nderuari z. kryetar, të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, të nderuar deputetë.

Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore i përcakton normat për rregullimin e tokës ndërtimore, procedurën e privatizimit si dhe rregullat për dhënien me koncesion dhe për dhënien me qira në kohëzgjatje 99 vjet.

Nevoja për miratimin e këtij projektligji është e madhe. jo vetëm pse është prioritet nga plani i standardeve për Kosovës. por se me këtë projektligji krijohet infrastruktura ligjore dhe harmonizohet me standarde ndërkombëtare për rregullimin e tokës ndërtimore . Pra, rregullat juridike të marrëdhënieve pronësore – juridike për tokën ndërtimore duhet t'u përshtaten rrëthanave të reja në Kosovë, ndërsa ligji i vjetër për tokën ndërtimore i takon një sistemi të kaluar juridik.

Projektligji është i hartuar mirë dhe ka strukturë të duhur ligjore, është i ndarë në 11 kapituj me gjithsej 102 nene. Me dispozita juridike të këtij projektligji parashihet që toka ndërtimore në pronësi të Kosovës mund të privatizohet ,të jetet me koncesion, me qira nëpërmjet ankandit publik, marrëveshjes së drejtpërdrejtë si dhe ndarjes së tokës nga organi kompetent. Edhe pse dispozitat e këtij projektligji prekin kompetencat e rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese sa i përket çështjes së pronësisë në këtë drejtim po i afrohemë kohës së bartjes së kompetencave nga UMIK-u në institucionet vendore.

Projektligji përmbrush kriteret për miratim në parim ,por nuk është krejtësisht pa vërejtje. Unë do t'i përmend disa nga ato:

Neni 8, paragrafi 2 dhe 3 , në vend të termit parcelë ndërtimore, pastaj parcelë kadastrave, mendoj se duhet të jetë ngastër.

Neni 14, paragrafi 5 thotë: Organet kompetent bëjnë eksproprijimin e tokës ndërtimore dhe objekteve të tjera ndërtimore. Mendoj se duhet të parashihet me ligj se cili organ bënë eksproprijimin e jo kjo çështje të parashihet me akte nënligjore.

Në parim e mbështes miratimin e këtij projektligji ,ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet e parashtruara gjatë diskutimit do të merren në shqyrtim nga Komisioni Funksional gjatë fazës së amendamentimit. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, të nderuar z. ministra, të nderuar kolegë.

Nuk e pata ndërmend të marrë pjesë në diskutim lidhur me këtë.

KRYETARI – Ftoj deputetët që janë jashtë sallës të kthehen në sallë se duhet të votojnë. Më fal z. Nekibe.

NEKIBE KELMENDI – Jo s'ka problem. Po citoj vetë titulli i projektligjit thotë: Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore.

Privatizimi dhe dhënia e tokës me qira e tokës ndërtimore urbane, janë dy çështje krejtësisht të ndryshme dhe nuk mund të rregullohen me një ligj. Mendoj se duhet të kemi ligj të veçantë për privatizimin dhe ligj të veçantë për tokën ndërtimore dhe dhënien e saj me qira. Kjo është e para.

E dyta, mendoj se nuk mund t'i njihet e drejta e shfrytëzimit të tokës shfrytëzuesit ,që ka të ndërtuar objektin në kundërshtim me ligjin, pra pa leje ndërtimi në tokën ndërtimore të qytetit, ose në tokën urbane.

E treta, nuk mund të zbatohet ky ligj në praktikë nëse nga Serbia nuk merret lënda kadastrave, të cilën çështje unë e kam ngritur qyshtit 2000, sepse do të kemi shumë probleme për kufizimet për manualet që nuk i kemi e për të cilat qytetari i Kosovës paguan edhe nga 2000 euro për të shkuar në Kushumli për ta marrë atë dhe për ta zgjedh një kontest që ka në gjykatë.

Më tutje, këtij ligji i mungojnë dispozitat sankzionuese lidhur me usurpimin e pronave shoqërore sidomos të pjesëve të trotuareve, prandaj ishte dash që, të parashihet si vepër penale usurpimi i tokës ndërtimore në pronësi shoqërore me që kjo çështje nuk është e rregulluar me Kodin penal të Kosovës që është një zbrasti por është rregulluar me një Rregullore të UNMIK-ut, edhe atë kur është vërejtur se Kodi penal i Kosovës e ka këtë mangësi.

Dhe nē fund, pa u bërë denacionalizimi, pa u nxjerr ligji pér denacionalizimin e tokës së nacionalizuar urbane nuk mund tē disponohet aq lehtë me këtë tokë, sepse do tē kemi problem me ish-pronarët tē cilëve, ndonëse toka e tyre u është nacionalizuar. Ata me Ligjin pér nacionalizimin e kanë mbajtur tē drejtën e shfrytëzimit tē pérhershëm dhe ajo e drejtë do tē thotë se e kanë nē posedim .por mund t'u merret vetëm me anë tē eksproprijimit dhe sipas procedurave që i rregullon Ligji pér eksproprijimin pasi tē vërtetohet interes i përgjithshëm shoqërorë apo interes i përgjithshëm i shtetit, e jo interes i personave privat siç po ndodhë nē praktikë.

Mu pér këtë arsy mendoj se ky ligj nē parim duhet tē miratohet, por tē ndryshojë titulli i tij dhe tërë ajo pjesë e përbajtjes së ligjit që ka tē bëjë me privatizimin, Pra ,le të rregullohet me këtë ligj vetëm çështja e tokës ndërtimore dhe dhënie së saj me qira, kurse çështja e privatizimit, po e përsëris duhet tē rregullohet me një ligj tē veçantë. Sa i përket lidhshmërisë së këtij ligji me Ligjin pér tē drejtën sendore mendoj se nuk ka lidhshmëri midis këtij dhe atij ligji, sepse atje rregullohen çështje tē tjera , rregullohet çështja e mënyrës së fitimit tē së drejtës pronësore, mënyra e humbjes së saj, e ruajtjes apo e mbrojtjes së posedimit tē saj, e drejta e servituteve tē pérhershme apo tē përkohshme etj. etj. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Meqë nuk ka më kandidatë tē interesuär pér diskutim, lus deputetët që tē deklarohemi nē parim pér miratimin e këtij ligji.

Në sallë janë 67 deputetë, lus regjinë tē përgatitet pér votim.

Votojmë tash.

Pér ..... 58  
Kundër..... 8

Ligji kalon.

Në bazë tē rregullës 23, pika 6 dhe rregullës 35 pika 2 Kuvendi ngarkon këto komisione:

Komisionin pér Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese si Komision Funksional dhe Referues.

Komisionin pér Buxhet dhe Financa dhe  
Komisionin pér Komunitete.

Komisionet duhet që nē afatin jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë tē shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime sipas rregullës 35, pikë 6.

Kalojmë nē pikën e katërt tē rendit tē ditës

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësinë publike**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 11 prill 2006 dhe janë përmbrushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftohet ministri Sadik Idriz që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin. Urdhëroni z. ministër.

**MINISTRI SADIK IDRIZ - Poštovano predsedništvo, poštovani gospodine predseniče, poštovani poslanici**

Pozdravljam otvaranje procedure za usvajanje Zakona o javnom zdravstvu u Parlametnu Kosova, zakonskому dokumentu od velike važnosti za zdravje građane i zdravstveni sektor u celini.

Imajući u vidu činjenicu da Kosovo u površini od 10 miliona kvadratnih metra, sa oko 2.5 miliona stanovnika odražava se sa:

- 100.000 slučajeva zaraznih bolesti godišnje ( od kojih 5 vrsta pripadaju bioterosnoj grupi ),
- 50% stanovništva pije nehigijensku vodu,
- samo 30% stanovništva je priključeno na vodovodsku i kanlizacisku mrežu,
- upotrebom prehrambenih sumnjivih artikala uvezениh iz raznih mesta sveta,
- visokim stepenom kontaminacije ambijenta,
- visokim stepenom smrtnošću novorodjenčadi,
- niskim stepenom obrazovanja i zdravstvenog vaspitanja, što predstavlja razloge koji čine neophodnim donošenje Zakona o javnom zdravstvu.

Javno zdravstvo je nezavisna disciplina koja se bavi, identifikovanjem i rešavanjem svih problema zajednice sa svih zdravstvenih gledišta, sprečavanjem bolesti, istraživanjem etiologije bolesti, promocijom zdravlja, rehabilitacijom i readaptacijom hendikepiranih, zdravstvenom edukacijom i socialnim pitanjima. S toga, Zakon o javnom zdravstvu, osim što će popuniti zakonski vakum u ovoj oblasti neophodan je zbog značaja oblasti koju pokriva.

Cilj Zakona o javnom zdravstvu je da osigura prikladni zakonski osnov radi primene efektivnih politika koje će urediti organizovanje i funkcionisanje Javnog zdravstva i odrediti institucije koje su glavni nosioci odgovornosti za javno zdravlje.

Ovaj nacrt-zakona ima i druge ciljeve koji su veoma jasni: način funkcionisanja Javnog zdravlja, njegovo organizovanje i podela odgovornosti i obaveza u njegovom okviru.

Radna Grupa tokom izrade Nacrta-Zakona, zasnivajući se na veliki broj odluka, rezolucija i zaključaka donetih od strane Saveta Evropske Zajednice, koje uredjuju oblast Javnog zdravlja, a koje imaju za cilj koordiniranje pitanja iz ove oblasti, istovremeno je pokušala da ih prilagodi uslovima i okolnostima Kosova, u memorandumu objašnjenja dati su odluke da ne pominjem pojedinačno.

Dame i gospodo,

Nacionalni Institut za Javno Zdravstva Kosova, javna je institucija referentna za primenu delatnosti u oblasti javnog zdravstva, u užu saradnju sa relevantnim ministarstvima, Ministarstvom za obrazovanje, Ministarstvom sredine, KUCK, glavnim Centrom porodične medicine, Inspektoratom zdravstva, Sanitarnim inspektoratom. Finansiski troškovi za Javno zdravstvo planirani su uglavnom po budžetskoj poziciji NIJZK, budžeta Ministarstva za zdravstvo, kao i u drugim sektorima koji su implicirani u Javnom zdravstvu.

Glavno finansiranje za primenu ovog zakona vrši Ministarstvo za zdravstvo, druga ministarstva za posebne i zajedničke projekte kao i donatori.

Vremenski rok implementacije Zakona, nakon dana usvajanja je 1(jedna) godina.

Fnansiski troškovi u skladu su sa budžetskim planiranjem Ministarstva za Zdravstvo i drugih impliciranih sektora za podršku i delatnost sa Javnim zdravstvom.

Nadam se da će vaše diskusije doprineti da se ovaj Nacrt zakona obogati i da će amandmani biti popunjeni eventualni proposti i nedostaci. Hvala.

KRYETARI - Faleminderit z. ministër. Në emër të LDK-ës fjalën e ka z. Naim Jerliu.

DEPUTETI NAIM JERLIU – Faleminderit z. kryetar dhe z. zëvendëskryeministër, anëtarë të Kabinetit qeveritar dhe kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për shëndetësinë publike dhe vlerëson se ky projektligj siguron një bazë të mirë për realizimin e politikave që irregullojnë organizimin dhe funksionimin e shëndetësisë publike në Kosovë, si një disiplinë që ka të bëjë me të gjitha problemet nga të gjitha pikëpamjet shëndetësore.

Ky ligj konsideroj se e mbulon fushën shumë të rëndësishme, duke i përcaktuar institucionet që janë bartës kryesor të përgjegjësisë të shëndetësisë publike, përkatësisht duke e rregulluar mënyrën e funksionimit të shëndetësisë publike, veprimtarinë edhe shërbimet shëndetësore në këtë fushë, organizimin dhe ndarjen e përgjegjësive, obligimeve në kuadër të kësaj. Me fakt ky ndoshta mund të quhej edhe Projektligji për institutin kombëtar të shëndetësisë publike si një institut publik referent për zbatim të veprimtarisë në fushën e shëndetësisë publike dhe në përqindjen më të madhe. Pra, po thuaj se kryekëput trajton apo irregullon funksionimin e këtij institacioni që është strumbullari i organizimit të funksionimit të shëndetësisë publike, i trajton çështjet në fushat të veçanta për raportet e shëndetit mjedisor të banimit, të ushqimit dhe të shëndetit, gjendjes shëndetësore, ushqyeshmërisë, shëndetit dhe rrezatimit, mbrojtjes shëndetësore në kushtet e jashtëzakonshme të veprimtarisë diagnostiko, mikrobiologjike, masat parandaluese kundër epidemike e të tjera.

Projektligji është në përputhje me standarde ndërkombëtare, pra nuk është në kundërshtim me parimet themelore të BE-së, normalisht s'është i adaptuar për veprimtarinë edhe zbatim në rrëthana të Kosovës. Gjithashtu është i shoqëruar me deklaratën

financiare që është në përputhje me planifikimin buxhetor të Ministrisë së Shëndetësisë. Është i hartuar mirë dhe konciz, prandaj Grupi Parlamentar i LDK-ës e mbështet miratimin në parim të këtij projektligji dhe do të japë kontributin e vet me amendamentim eventual, me shqyrtimin e mëtutjeshëm në Komision. Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës fjalën e ka Zyhrije Jusufi me kartelën e Hatixhe Hoxhës.

DEPUTETJA ZYHRIJE JUSUFI – Inderuari z. kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë.

Projektligji për shëndetësinë publike është i rëndësishëm ngase merret me identifikimin e zgjedhjen e shumë problemeve shëndetësore. Kosova ka shkallë të ulët të edukimit dhe arsimimit shëndetësor, numër shumë të madh të sëmundjeve ngjitime. Vetëm një e treta e popullsisë janë të kyçur në ujësjellës dhe kanalizim, pra konsumon ujë jo higjenik, artikuj ushqimor të importuar të dyshimtë, pra shkalla e ndotjes së ambientit është e lartë. Ky projektligj afrojn mënyrën e organizimit dhe funksionimin e shëndetësisë publike, përcakton institucionet dhe bazën e përgjegjësi për ndarjen e tyre. Në përgjithësi projektligji është hartuar mirë, nga grupi punues- profesionistë të shëndetësisë publike, që, përveç tjerash është mbështetur në vendime dhe në rezoluṭa të Këshillit Evropian.

Mendoj se projektligji duhet të ishte më i detajuar në aspektin e kompetencave me inspektoratin shëndetësor, inspektoratin sanitair, me Ligjin e ushqimit, Ministrinë e Ambientit, Qendrën Klinike Universitare, qendrat e mjekësisë familjare. Do të veçojmë për shembull ninen 43.5.

Në projektligj ka disa paqartësi, për shembull neni 7.3. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës bashkëpunon ngushtë me Ministritë relevante. Mirëpo nuk janë specifikuar kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë ndërministrore, ato duhet të ishin në koordinim strikt me nenet 16.2., nenen 21.7.

Neni 24.1. Veprimtaria mikrobiologjike publike dhe ajo diagnostike referente kryen vetëm në sektorin publik. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për shëndetësinë private.

Neni 29.1. dhe neni 26.4 nuk kanë lidhshmëri kuptimi.

Neni 23.3 duhet të plotësohet.

Neni 37 a) është i paqartë.

Mendoj se ligji mund të jetë jo i zbatueshëm pas një viti, duke e njojur dinamikën e nxjerrjes së akteve nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë, nga se gjithë veprimtaria e projektligjit rregullohet me akte nënligjore.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, projektligjin e mbështesim në parim dhe do të kontribuojmë në shqyrtimin e mëtutjeshëm. Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Në emër të AAK-ës fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit i nderuari z. kryetar, të nderuar ministra , deputetë të nderuar.

Shëndeti është çështje sociale, ekonomike dhe politike,por është edhe e drejtë fundamentale e njeriut. Prandaj përmirësimi i shëndetit të popullatës dhe sigurimi i jetës së shëndoshë janë interes kombëtar dhe ndërkontëtar.

Projektligji për shëndetësinë publike krijon bazën ligjore për realizimin e këtij qëllimi. Me këtë projektligji përcaktohen sistemi i mbrojtjes shëndetësore, veprimtaria dhe shërbimet shëndetësore nga fusha e shëndetit publik. Po ashtu, sigurohet zbatimi i politikave të shëndetit publik dhe përcaktohet institucioni kombëtar i shëndetësisë publike të Kosovës si institucion përkatës për zbatimin e tyre.

Ligji është në pajtim me standartet ndërkontëtare për shëndetin publik. Shëndeti publik dhe sfera e angazhimeve është përshkruar në projektligji në mënyrë precize dhe përkufizimet janë të qarta. Përcaktohen saktë puna dhe angazhimet e Institutit Kombëtarë të Shëndetësisë Publike, planifikimi dhe zbatimi i masave përkatëse për politikat shëndetësore, analizimi dhe vlerësimi i gjendjes shëndetësore.

Angazhimi i shëndetësisë publike është i bazuar në përvojat kryesore të shëndetit në mbarësi në edukimin e popullatës dhe kontrollin e saj, promovimin e shëndetit, ushqimit adekuat, furnizimit përkatës me ujë, imunizimin, parandalim dhe kontrollin e sëmundjeve epidemike dhe endemike.

Sfera të cilën e rregullon ky projektligji si riafirmim i shëndetit, etimologja e sëmundjes, ngritura e nivelit të njojurive të shëndetësore si dhe e shërbime shëndetësore nga fusha e shëndetit publik, promovimi i amësisë dhe rritjen e zhvillimin e shëndoshë të fëmijës, promovimin e zhvillimit harmonik trupor dhe mendor te të rinjve në ofrimin e shërbimeve për rehabilitimin dhe riadaptimin e personave me aftësi të përkufizuar, bëjnë të mundur që të respektohet dinjiteti dhe të drejtat e tyre.

Ambienti i shëndoshë, promovimi dhe mbrojtja e shëndetit të njerëzve, të gjitha këto janë esenciale për mirëqenien fizike, psikike dhe sociale dhe rrjedhimisht për ekonominë e qëndrueshme dhe zhvillimin e shoqërisë që kontribuon në kualitetin më të mirë të jetës.

Megjithëkëtë kam disa vërejtje në projektligji. Mendoj se më shumë i përgjigjet emërtimi Projektligji për Institutin Kombëtar Shëndetësisë Publike. Kam edhe disa vërejtje teknike në kapitullin I ku bëhet përkufizimi i termit imunizim,ku janë dhënë 2 paragrafe f) dhe l). Mendoj se duhet të futen në një paragraf . Vërejtja ime e fundit ka të bëjë me bashkëpunimin e institucioneve të tjera qeveritare që duhet të saktësohet.

Sa i përket implikimeve buxhetore thuhet se sponzoruesi ka thesar për vitin 2006 nuk ka implikime buxhetore, për vitin 2007 kërkohen 210 mijë euro dhe për vitin 2008, 190 mijë euro . Është paraparë që vetëm Institutit do të gjenerojë të ardhura vetjake 300 mijë euro. Shpresoj se do të jetë një planifikim i mirëfilltë i buxhetit në mënyrë që ky projektligji të mund të zbatohet.

Në fund Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim këtë projektligj dhe do të angazhohet në procesin e mëtejshmë të përpunimit të këtij projektligji. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Në emër të Partisë ORA fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollçaku.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU- Faleminderit z. kryetar. Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Reformiste ORA e mbështet në parim hartimin e Projektligjit për shëndetësinë publike.

Ne ,nëse nisemi nga Deklarata Internacionale e të Drejtave Shëndetësore që thotë se kujdesi shëndetësor duhet të jetë i bazuar në dialog të mirëfilltë dhe bashkëpunim ndërmjet qytetarëve, profesionistëve, do të thotë komuniteti dhe politikë bërësve në anën tjetër.

Shërbimet shëndetësore duhet të janë efektive dhe të përshtatshme, pra shëndeti para të gjithash varet nga mundësia e sigurimit të ushqimit të sigurt, të ujut të sigurt, strehimit, edukimit, punësimit, mbrojtjes nga ndotja dhe preventivës të izolimit social. Fusha e shëndetësisë publike është e pandarë dhe multidisciplinare. Ajo në fokus ka popullatën, me theks në preventivën e sëmundjeve dhe promovimin e shëndetit për tërë komunitetin.

Shkencat sociale mund t'i konsiderojmë , gjithashtu, si pjesë integrale të edukimit shëndetësor publik. Misioni i shëndetit publik është ta nxisë interesin e shoqërisë për sigurimin e konditave për jetë të shëndetshme. Profesionistët e shëndetësisë publike monitorojnë dhe hulumtojnë çështjet me interes për tërë shoqerinë dhe promovojnë praktikat dhe sjelljet ,gjegjësisht stilin jetësor,i cili siguron që popullata jonë të jetë e shëndetshme.

Duke u nisur nga të gjitha faktet që u përmendën sa i përket kushteve jetësore,mjedisit ku jetojmë dhe siç u cek që vetëm 50% e popullatës ka qasje në ujë të pijshëm, ndotja e ambientit dhe shumë çështje tjera, ne mendojmë se ky projektligj, megjithëkëtë rregullon kryesisht veprimtarinë e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, ndërsa në deklaratën financiare ceket edhe nevoja për buxhet për disa institute rajonale. Mendoj që, gjithashtu, në ligj është dashur të përmenden edhe institutet rajonale me qenë se kryejnë një punë mjaftë të rëndësishme dhe janë pjesë e pandashme të Institutit Kombëtar.

Gjithashtu. dëshiroj të cek se edhe Institutit është dashur që një pjesë të mjeteve ta parashesh edhe për Institutin rajonal të Shëndetësisë Publike në Pejë si instituti më i vjetër, institut me një traditë 80 vjeçare ,do me thënë ekziston, prandaj gjendja në të cilën është kërkon që një pjesë e buxhetit të ndahet edhe për renovimin e Institutit të Pejës.

E përkrahim projektligjin e tillë dhe kontributin tonë do ta japim në amendamentim në Komision Funksional. Faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ fjalën e ka zonja Shpresa Murati.

## DEPUTETJA SHPRESA MURATI – Faleminderit.

Poštovani predsedniče, poštovani ministri i kolege poslanici. Nacrt zakona o javnom zdravstvu zajedno sa nacrtom zakona o reproduktivnom zdravlju i nacrtom zakona o prekidu trudnoće koji su u načelu usvojeni i nalaze se u skupštinskoj proceduri su jako značajni zakoni koji će popuniti zakonsku prazninu u oblastima koji ovo zakoni pokrívaju. Ovim se zakonom utvrđuje sistem zdravstvene zaštite, delatnosti i zdravstvenih usluga iz oblasti javnog zdravstva. Ovaj nacrt zakona će pružiti čvrst zakonski osnov za način organizovanja i funkcionisanja javnog zdravlja. Odrdbe ovog nacrta zakona pored ostalog uređuju dužnost zdrave sredine ta istraži faktore sredine koji utiču na zdravlje stanovništva, i da preuzme zaštitne mere radi sprečavanja štetnih efekata po zdravlje. Takođe, uređuju zdravstveno stanje i ishranu, zdravstvenu zaštitu u vandrednim uslovima, imunizaciju, preventivne i protiv epidemiske mere, promovisanje zdravlja, zdravstvenu negu majke i deteta, omladine itd. Naročito je značajno poglavlje 14. koje se odnosi na promovisanje zdravlja. S obzirom na poznatu činjenicu da na zdravlje mislimo tek kada ga izgubimo, zdravstveni stručnjaci obučeno osoblje u zdravstvenoj edukaciji, zdravstvene institucije dužne su da organizuju i primene aktivnosti promovisanja zdravstvene edukacije u cilju poboljšanja kvaliteta života i smanje ili otklone faktore koji negativno utiču na zdravlje. Međutim, moramo istaći izvesne primedbe koje se naročito odnose na član 8.2. koji sadrži čak 55 podtačaka, smatramo da je preopširan sa velikim nabranjima i mislimo da se može sažeti. Takođe, sadržaj teksta podtačke 33. pomenutog člana kao i sadržaj teksta člana 23.2. treba usaglasiti sa verzijama na albanskom i engleskom jeziku. I na kraju Parlamentarna Grupa 6+ podržava ovaj predlog zakona u načelu i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYETARI – Faleminderit. Në emër të Grupit për Integrim fjalën e ka deputeti Ferid Agani. Urdhëroni doktor.

DEPUTETI FERID AGANI – Faleminderit z. kryetar, i nderuari z. kryetar të nderuar ministra, kolegë deputetë.

Projektligji për shëndetësinë publike paraqet, pa dyshim, një dokument gjithëpërfshirës ligjor që pretendon ta rregullojë një fushë tejet të rëndësishme për shëndetin publik të Kosovës dhe në veçanti për disa aspekte të mirëqenies së përgjithshme në shoqërisë sonë.

Grupi Parlamentar për Integrim qysh në fillim them se në parim e përkrah këtë projektligj me disa vërejtje që do t'i paraqes ne këtë rast dhe të cilat do t'i paraqesim më tutje në procedurën e amendamentimit pranë Komisionit përkatës funksional.

Janë tri çështje për të cilat kisha pasur dëshirë t'ua tërheq vërejtjen sot e që mendoj se janë të rëndësishme të debatohen dhe t'i kemi parasysh në punën e mëtutjeshme.

E para është baza ligjore për përmirësimin e këtij ligji, me qenë se ekziston një diskrepancë me Ligjin për shëndetësinë të Kosovës, i cili në nenin 36 dhe 46 pika g) e parashev që fusha e shëndetësisë publike duhet të rregullohet me një akt nënligjor dhe jo me ligj të veçantë. Kjo mendoj se është edhe një arsy që Ministria e Shëndetësisë t'i hyjë edhe për shkaqe të tjera të shumta procedurës së amendamentimit të Ligjit për

shëndetësi të Kosovës. Mendoj se rregullimi i fushës së shëndetësisë publike me ligj të veçantë është një domosdoshmëri e kohës.

Çështja e dytë ka të bëjë me numrin tejet të madh të akteve nënligjore që janë paraparë të nxirren me qëllim që ky ligj të jetë funksional dhe i zbatueshëm. Bëhet fjalë për 30 akte nënligjore, që mendoj se dukshëm do të ngadalësojë procesin e zbatimit të këtij ligji. Unë mendoj se duhet të shikuar mundësia që nëpërmjet racionalizimit të tekstit ligjor ku ka shumë përsëritje dhe ka ndërhyrje me ligjet e tjera, të cilat tani janë në fuqi, të shikohet mundësia që të bëhet më operacional, më funksional, që përmes zgjidhjeve të cilat nuk do të parashihen vetëm me akte ligjore të hyjnë në fuqi, por nëpërmjet vetë ligjit. P.sh. konkretisht në këtë tekst ligjor kemi disa nene të cilat rregullojnë çështjen e mënyrës së mbikëqyrjes së institucioneve shëndetësore në fushën e shëndetësisë publike, çështje kjo e cila është e rregulluar me nenet 49 dhe 101 deri më 105 të Ligjit për shëndetësinë të Kosovës, pastaj çështjen e mënyrës së financimit të tyre që është rregulluar me nenin 57 etj.

Çështja e tretë që unë mendoj se duhet të kihet parasysh është fakti se Ligji duhet ta përcaktojë në mënyrë të quartë strukturën e organizimit të sistemit

të shëndetësisë publike në Kosovë, duke identifikuar quartë strukturat bartëse të tij dhe atë në tri nivele të kujdesit shoqëror në ligj është përcaktuar dhe definuar quartë roli i Institutut Kombëtar të Shëndetësisë Publike që është plotësish e drejtë, por mungon definimi, quartësimi i parimeve themelore të organizimit nën nivelin parësor dhe në atë gjyqësor. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Flora Brovina,

DEPUTETJA FLORA BROVINA – Faleminderit. I nderuari kryetar, ministra, kolegë dhe kolege deputetë.

Një ndër strategjitë që dalin nga Ligji për shëndetësinë e Kosovës të miratuar në këtë Parlament është edhe kujdesi dhe obligimet e Ministrisë së Shëndetësisë për kujdesin publik. Kjo fushë shumë e rëndësishme, më e rëndësishmja pa dyshim për sigurimin e shëndetit të popullatës, është përfshirë dhe është temë edhe e këtij projektligji. Andaj kjo është edhe rëndësia e jashtëzakonshme e tij. E vetmja gjë që më shtyn të votoj për ligjin, duke qenë e sigurt se ai do të përmirësohet gjatë procedurës në vazhdim ku të gjithë do të japim kontributin, madje edhe qytetarët në debate publike, natyrisht edhe unë timin, konkretisht në Komisionin për Shëndetësi, Pra, dihet se ky është një projektligj bazik për rregullimin e problematikës jetike dhe përfshin një spektër të gjerë, një disiplinë të veçantë në politikën shëndetësore. Jam e vetëdijshme për nevojën e këtij ligji dhe për tërë fushën që duhet të mbulojë, por duke studiuar hollësish projektligjin kam vërejtur se ka të meta të mëdha, me të cilat do të ballafaqohet edhe Komisioni. Ndonjëherë edhe këto probleme do të janë ndoshta edhe të pariparueshme.

Në rend të parë teksti gjuhësish ka aq të meta sa duhet një intervenim gjuhësor gati në çdo nen. Pra, fare nuk tingëllon shqip, pra fjalitë humbin kuptimet e kështu edhe neneve të veçanta. Në përkufizime kemi 31 shpjegime edhe këto nuk mjaftojnë, sepse shumë shpjegime mbeten pa u sqaruar. Në anën tjetër kemi edhe përsëritjet e shpjegimeve siç u përmend nga një kolege, p. sh. pika f) dhe l) kur flitet për imonizimin

përsëritet dy herë me dy definicione, ose kur vet përkufizimi nuk është i tillë ,sepse nuk flet asgjë.

Gjithashtu kolegët e mi folën edhe për problemin se sa është kompatibil ky projektligj me Ligjin themelor për shëndetësinë. Nene të veçanta që, gjithashtu, duhet të riformular janë nenet 6 dhe nenit 7. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe numërimi i fushëveprimit të tij, nenit 7 pika, 7.2 nën a) deri në pikën nën u) duhet rregulluar gjuhësisht, sepse kështu siç janë humbin çdo kuptim. Unë kam edhe shembuj konkret kur thuhet p.sh. instituti publik, referent për zbatimin e veprimeve në fushën e veprimtarisë si në vijim, p.sh. infeksionet intero- spitalore, nuk tingëllon mirë ose qendra referente përzonzoza ,njësia për nënën dhe fëmijën dhe çka më tutje ose sistemi gjeografik i informimit.

Pika 7.3. flet për bashkëpunimin e Institutit dhe të ministrite relevante pa i cituar se cilat . Një ligj nuk bënë të jetë enigmatik,por duhet të thuhet me kënd duhet bashkëpunuar.

Neni 8 ose pika 8.1 na lë në dilemë kush organizon dhe kush zhvillon, mbikëqyr dhe kush merr pjesë në zbatimin e politikave të shëndetësisë! dhe sidomos në politikat e shëndetësisë publike, Ministria e Shëndetësisë apo vetë Institutit. Kush kujt i përgjigjet, kjo ngatërrrohet në ligj. A është Institutit i pavarur apo i përgjigjet themeluesit. Përgjigja natyrisht se dihet se ajo është në Ligjin për shëndetësi. por këtu lihet dilema.

Neni 8 pika 8.2 dhe nenit 9 kur përkufizohet veprimtaria thuhet: zvogëlimi i incidencës dhe vdekshmërisë nga sëmundjet vaksine prenëntabile. Jam mjeke që në kohë të gjatë kam punuar në preventivë, por asgjë nuk kuqtoj nga kjo fjalë as në përkufizime nuk ekziston shpjegimi. Në tekstin në gjuhën angleze dhe sidomos në serbishtë kuptohet se fjalë është për smrnost od bolesti preventivne vaksine nga e merr shpjegimin, por shqip fare nuk tingëllon.

Pika 23 ,gjithashtu, ka shumë fjalë që duhet dhënë në shpjegime. P.sh. mediumet ushqyese, testet seorologjike, ujërat kreative, ajrosedimenti tipik ose edhe më keq janë shkruar- mostrat humane mukotoksina etj. Edhe një fjalë që fare nuk ekziston ,do me thanë alfa s'di si toksina që mandej pak a shumë nënkuftohet në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe që është fjala për alfatoxinet, pa detergjentet në ujë dhe në artikujt ushqimorë.

Neni 9 dhe 9.2 në ndotjen e ajrit brenda lokalit jo brenda një objekti. Për t'u bërë funksional ky projektligj duhet të nxjerrë më së paku 29 ose 30 nënligje do me thënë akte ligjore. Intervenimi duhet të bëhet edhe në nenin 16, në secilën pikë.

Vërejtje kam edhe në kapitullin VI, në nenit 21 dhe 21.6, 21.7, 21.8. Në kapitullin VII kur flitet për kujdesin shëndetësor të punësuarve dhe në kapitullin VIII për mbrojtjen shëndetësore në kushte të jashtëzakonshme. Fjala është për kompetencat, rolin që ka Ministria e Shëndetësisë,pra ky institucion lidhur me Ligjin për shëndetësi.

Gjithashtu kam vërejtje në kapitullin X kur flitet për imunizimin .Për të mos e zgjatur më tutje diskutimin, vërejtjet e mia do t'ia paraqes Komisionit.

Dispozitat disiplinore dhe ato ndëshkimore fare nuk janë përcaktuar si të veçanta. Këtu vetëm citohet Ligji për shëndetësi dhe pikërisht këtu janë vërejtjet kryesore. Mendoj se duhet të përshkuhen shumë hollësishët këto, mosbatimi i politikës së shëndetit publik,bartësit kryesor të saj dhe masat.

Është një ligj i dobët që në çdo paragraf ose në çdo nen parashevë akte nënligjore ,është i gjyqtë dhe jo funksional. Prandaj ju bëj vërejtje që në të ardhmen ligjet e huazuara ose të adaptohen mirë për nevoja tona ose të mos cungohen gjatë përkthimit,sepse po e humbin edhe kuptimin.

Mbetet për t'u diskutuar edhe çështja e financimit të shëndetit publik dhe e këtij instituti që përfshihet në pikën 47.2 aq më tepër kur edhe këtu kjo çështje rregullohet me akte nënligjore. Ju faleminderit.

KRYETARI – Ju faleminderit. fjalën e ka deputetja Teuta Hadri.

DEPUTETJA TEUTA HADRI – Të nderuar deputetë, i nderuari z. kryetar. Duke pasur parasysh faktin se Kosova kaloi një luftë barbare me një shkatërrim 80% të infrastrukturës, të rrjetit të ujësjellësit, të kanalizimit, ndotjes së lartë të ambientit, hyrjen e ushqimit nëpërmjet pikave doganore pa kurrfarë kontrolli sanitari, sikur asnjë ligj nuk funksionon. Mendoj se Ligji për shëndetësi publike ka qenë jo ligj për ta mbuluar vakumin e shëndetësisë ,siç flitet, por një ligj bazë. Miratimi i këtij ligji do të ndihmojë edhe miratimin e ligjeve të tjera të shëndetësisë që kanë qenë me rëndësi më të pakët apo më të lidhura me funksionimin e këtij ligji që sot pas 6 vjetëve shtrohet për miratim.

Edhe Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë kanë bërë maksimumin që në ato ditë shumë të rënda të punës për miratimin e këtij ligji për të cilin sot po diskutojnë, por dikush nga lartë na pengonte ne kosovarëve sikur po na shkon jeta duke na thënë dikush nga lartë, bën apo s'bën.

Hartimi i këtij ligji bazë ka penguar për zgjidhjen e të gjitha problemeve të grumbulluara që 6 vjet, për identifikimin, parandalimin e gjitha sëmundjeve, sidomos këto të fundit siç është diskutuar edhe në seancat e mëparshme të Parlamentit të Kosovës,që e shqetësuan popullatën siç janë: gripi i shpendëve, sëmundjet e triqgrave, tularmia dhe sëmundjet që sot po i kanosen rinisë së Kosovës si AID-sit që janë bërë një ndër sëmundjet permanente duke atakuar atë.

Ligji për shëndetësinë publike është ligj që me organizmin e punës së tij do t'i sigurojë popullatës një shëndet publik, duke marrë masa për të siguruar dezinfektim, dezinsektim, degatizim, imunizim të rregullt, parandalim të sëmundjeve ngjitetëse epidemike, intervenim strategjik të bazuar në shkencë, me qëllim të reduktimit apo të shkatërrimit të shkaktarit që bën dëmtimin e shëndetit. Ky ligj duke aplikuar këto masa shkencore bën edukimin shëndetësor ,duke e ngritur nivelin e njohjes dhe mundësinë qytetarit të mësojë për vetën. Duke e përkrahur punën e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, angazhimin e palodhur të këtij institucioni dhe të personelit të tij, nga dita e parë e pasluftës e deri sot kam mbrojtur funksionimin dhe punën e këtij instituti, pa përkrahje të fuqishme të Qeverisë dhe me buxhet qesharak të ndarë nga Qeveria e Kosovës për të

ekzistuar ky institucion. Shpresojmë se miratimi i këtij ligji do të përkrahet sot nga ky Kuvend. Propozoj që Qeveria e Kosovës ta ndryshojë politikën e vet lidhur me ndarjen e buxhetit këtij institucioni, duke e ngritur përqindjen për këtë buxhet se Instituti është një ndër institucionet më të rëndësishme të shëndetësisë së Kosovës. Vërejtjet e tjera do t'i japim në komisionin përkatës. Ju faleminderit

**KRYETARI – Ju faleminderit fjalën e ka deputeti Ilaz Pireva**

**DEPUTETI ILAZ PIREVA - Faleminderit z. krytar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë.**

Pajtohem me vërejtjet që u dhanë më parë lidhur me Projektligjin për shëndetësinë publike. Desha edhe unë të jap kontributin tim, megjithëse do të jem pak ma i thukët në punën e Komisionit të Shëndetësisë.

Duke pasur parasysh grupin punues që ka punuar në këtë projektligj mund të konsideroj se vërtetë janë njerëz me kompetencë, duke u nisur prej kryesuesit të grupit të prof. Dedushaj dhe kolegëve të tij, megjithëse lidhur me këtë unë e kam një vërejtje. Se a mund të jetë deputeti anëtar i këtij grupei punues, këtë lë ta mendojë. Ministria e Shëndetësisë.

Pajtohem me pjesën dërmuese të vërejtjeve që i thanë parafolësit. Unë do të isha ndalur edhe në disa të tjera. Te neni 23.2 ku bëhet fjalë për gjendjen e jashtëzakonshme është i përkufizuar mirë migrimi i popullsisë. Këtu duhet migrim, nuk di çka kanë menduar, është fjalë për një migrim masiv, zhvendosje masive apo është një migrim pak më normal, se është fjalë për gjendjen e jashtëzakonshme.

Po ashtu vërejtjet e mia janë te nenet 27 dhe 28 ku bëhet fjalë se kjo do të zbatohet në tërë territorin e Kosovës. Pastaj janë për t'u diskutuar nenet 29 me nënpikat 1, 2, 3. Kur është fjalë për udhëtime individuale apo grupore në vendet endemike, nuk dihet a është fjalë për Kosovë apo jashtë, sepse thotë do t'u nënshtrohen kontrollit sanitari.

Gjithashtu në nenin 44.2. thotë se këto çështje do të rregullohen me Ligjin e shëndetit riprodhues dhe me Ligjin e shtatzënësisë, kur dihet se këto ligje janë në procedim para këtij ligji, prandaj, do të duhej një formulim tjetër, megjithëse nuk di se ligji mund t'i referohet një ligji tjetër, në qoftë se ajo materie rregullohet me ligje që u cekën më lart.

Po ashtu vërejtja ime është sepse jo 30, por 22 nën ligje, për 50 nene i ka, kjo është e tepërt dhe unë e konsideroj këtë si pasojë të një strukture jo mirë të organizuar, brumë ka mjastë por ai brumë nuk është sistemuar si duhet dhe kjo është nga arsyaja, sepse ky ligj është përpiluar nga shumë ligje të tjera të rajonit dhe më gjërë dhe kjo ka bërë që kjo materie të dalë kështu jo mirë e organizuar. Po ashtu kemi një terminologji jo të qëndrueshme nga fusha e mjekësisë. Duhet pasur parasysh, sepse Ligji për shëndetësinë është ligj bazë që duhet t'i nënshtrohen të gjitha ligjet e tjera edhe në aspektin e terminologjisë, po them, këtu thotë ka zbatim të pëlqimit, pëlqimi nuk zbatohet, por zbatohet vendimi i ligjit. Kur është fjalë për masat që ndërmeir inspektori përkatës, me ato fusha merret mjekësia e jo inspektori, inspektorët merren me faktorët që mund ta

trezikojnë shëndetin në një mjeshter të caktuar. Pra në parim edhe unë e përkrah dhe kontributin tim, si thashë, do ta jap në Komisionin e Shëndetësisë. Ju faleminderit.

**KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori**

**DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra ,të nderuar kolegë deputetë. Unë mbështes nxjerjen e këtij Projektligji për shëndetësinë publike, por ua tërheq vëmendjen në një aspekt dhe ai mendoj se është ndër më të rëndësishmit. Mundësia buxhetore e implementimit të ligjit. Nëse vërejmë shtrëngesa tonë buxhetore për një periudhë të caktuar kohore dhe fakti se ligji duhet të fillojë se implementuari pas një viti, mendoj se do të hasim në vështirësi të caktuara. Për këtë qëllim mendoj se Ministria e Shëndetësisë brenda strukturës së shpenzimeve buxhetore në lidhje me ligjin, duhet të ketë parasysh mundësinë e reduktimit të pozicioneve të ndryshme buxhetore, të cilat do ta bënin të mundur implementimin e ligjit. Një planifikim i quartë buxhetor, lidhur me implementimin e këtij ligji për një periudhë të caktuar kohore është më se i domosdoshëm me një bashkëpunim të mirë të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. Ju faleminderit.**

**KRYETARI – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj**

**DEPUTETJA NURISHAHE HULAJ – I nderuari kryetar i Kuvendit të nderuar ministra kolegë deputetë. Meqenëse këtu u cekën shumë gjera nuk do të doja t'i përsëritja, por dëshiroj që t'i theksoj disa gjëra shumë të rëndësishme për këtë ligj. Ligji për Shëndetësi Publike është i një rëndësie të veçantë, një ndër ligjet më të rëndësishme të shëndetësisë, gjegjësish në strukturën e shëndetësisë së Kosovës, sepse, e ka arsyeshmërinë e plotë meqenëse me këtë ligj rregullohet çështja e shëndetësisë e më se 80% e popullatës së Kosovës, kryesisht shëndetësia e saj, mirëqenia psikike, fizike, dhe mendore. Paraqitura e ligjit për shëndetësi publike karakterizohet me shkaqet që e bëjnë të domosdoshme nxjerjen e tij ,por këto shkaqe paraqesin rëndësi të veçantë në fushën që e mbulon shëndetësia publike.**

Rëndësia e projektligjit mbështetet në indikatorë të matshëm që evakuohen, analizohen dhe raportohen në periudha të caktuara . Qëllimi i ligjit siguron bazën e përshtatshme ligjore për zbatimin e politikave efektive,që të cilat do të rregullojnë organizimin, dhe funksionimin e shëndetësisë publike si dhe përcakton institucionet që janë bartës kryesorë të përgjegjësisë për shëndetin publik, dhe që merren me identifikimin, zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkësisë,të grupit,të individit etj. me këtë merren masat e parandalimit të sëmundjeve, hulumtimi dhe etiologja e sëmundjeve, pastaj promovimi dhe edukimi shëndetësor që është një segment shumë i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës, rehabilitimin dhe riadaptimi i të hendikepuarëve dhe çështjet sociale. Ligji është mbështetur në një numër të madh të vendimeve,të rezolutave dhe konkluzioneve të dhëna nga Këshilli i Bashkësisë Evropiane ,sigurisht të adaptuara në kushte dhe rrethana të Kosovës.

Ligji përbëhet prej 21 kapitujsh dhe 50 nene, ka bazën në strategjinë shëndetësore të Kosovës të periudhës shkurt 2001 dhe në Ligjin për shëndetësi të Kosovës. Pjesa substanciale e ligjit është veprimtaria e Institutit të Shëndetësisë Publike të Kosovës që është si qendër referente e politikës programore edukativo- shëndetësore, e përpilimi.

mbikëqyrja dhe vlerësimi i programeve, materialeve të informimit dhe të edukimit dhe komunikimit shëndetësor. Në këtë kudër zhvillohen, mbrojtja e mjedisit, e ushqimit dhe e shëndetit, gjendja shëndetësore dhe ushqyeshmëria, shëndeti dhe rrezatimi, që janë efekte të dëmshme të rrezatimit jonizues dhe jo jonizues janë objekt i mbikëqyrjes, i hulumtimit dhe vlerësimit të ndikimit në shëndetin publik. Kujdesi shëndetësor i të punësuarave, mbrojtja shëndetësore në kushte të jashtëzakonshme. Këtu bëhet fjalë për çështjet e epidemive të ndryshme që mund të paraqiten, për veprimtarinë diagnostike, mikrobiologjike éshtë laborator referent. Pastaj imunizimi éshtë i obligueshëm sidomos te sëmundjet preventabile. si u cekën më parë, do të thotë ku ka vaksinë për këto sëmundje dhe éshtë shumë efektive ,shumë e lirë dhe éshtë e domosdoshme, por edhe e obligueshme me ligj.

Masat parandaluese dhe kundërepidemike, parandalimi i përhapjes së HIV- AIDS-it, Instituti i Shëndetit publik me laboratorët referentë bën diagnostifikimin dhe identifikimin e rasteve, promovimin dhe edukimin shëndetësor, sepse që me këtë ngritet dhe mbikëqyret çështja shëndetësore, personale dhe kolektive. Kjo do të jetë me ligj shumë afër bashkësisë, shumë afër qytetarit, që me to të merren informata të drejta te qytetarët për t'u mbrojtur nga sëmundjet ngjitëse dhe për ngritjen e nivelist dhe të vetëdijesimit të tyre për të ditur të mbrohen për çështje elementare të shëndetit të tyre. Pastaj kujdesi shëndetësor për nënën dhe fëmijën, për të rinjtë dhe lidhur me sportin e me veprimtari të tjera.

Sigurisht që edhe në këtë ligj ka implikime buxhetore, por duke ditur rrëndësinë e veçantë edhe nga financat edhe nga Qeveria, ky ligj duhet të ketë përkrahjen me buxhet, sepse një pjesë e buxhetit tashmë duhet të jetë e planifikuar me Ministrinë e Shëndetësisë për periudhën 2006 -2008. Mjetet financiare janë në përputhje me planifikimin buxhetor të Ministrisë dhe të sektorëve, me shëndetësinë publike, që do të kenë përkrahje sigurisht edhe nga donacionet që do të japid për këtë shëndet publik. Ministritë që do të jenë në bashkëpunim do të dëshiroja t'i theksoja janë: Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ambientit që kanë interferencë ndërmjet vetes, sepse përputhen edhe veprimtaria e tyre për shëndet publik. Këtu do të theksoja se asnjëri nuk e përmendi se shëndet publik zhvillon edhe mjekësia familjare, që ky ligj e ka bazën në shëndetësinë e përgjithme në ligjin për shëndetësi të përgjithshme që e ka edhe mjekësia familjare. Do të thotë edhe mjekësia familjare e zhvillon shëndetësinë publike, që do të ketë bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Shëndetit Publik. Ky institut e mbikëqyr, jep këshilla dhe bën trajnime të ndryshme. Pra në bazë të ligjit nuk kemi organizime rajonale, por kemi organizime shëndetësore lokale dhe organizime qendrore.

Ne përkrahim këtë ligj dhe e mbështesim me punën tonë të mëtejme. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI - Meqenëse nuk ka kandidat tjetër për diskutim, ftoj deputetët të përgatiten për votim në parim të ligjit. Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë.

Në sallë janë 76 deputetë

Për.....69,  
Kundër.... 3.

Kalon ligji.

NË bazë të rregullave 23 pika 6 dhe 35 pika 2, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Shëndetësi, Pünë dhe Mirëqenie Sociale si komision funksional dhe referues.
2. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
4. Komisioni për Komunitete.

Komisionet,në afat jo më shumë se dy muaj,pas shqyrtimit të parë, duhet ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raport me rekomandime.

Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës

## **5. Shqyrimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 25 prill 2006 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe përmiratimin në parim.

Vërejtjet parimore do t'u drejtohen për shqyrtim komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore.

Ftoj ministrin Adrian Gjini që në emër të Qeverisë ta prezantojë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Projektligjin në fjalë.

MINISTRI ADRIN GJINI – I nderuar z. kryetar, z. zëvendëskryeministër,të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Më lejoni që sot para jush të paraqes arsyeshmërinë e nxjerrjes së një ligji për veprimtarinë hidrometeorologjike në Kosovë. Ky ligj ishte në listën e ligeve prioritare të MMPH-së për vitin kalendarik 2006.E ka hartuar Institutit i Hidrometeorologjisë i Kosovës, që është pjesë e mjedisit të planifikimit hapësinor.

Ligi përmban 14 nene, 17 paragrafë dhe nocionet profesionale. Është i një rëndësie të veçantë për Kosovën, sepse krijon bazë për mbrojtjen dhe monitorimin e resurseve natyrore të ujit, të dheut dhe të ajrit, si dhe mundëson zhvillimin ekonomik në harmoni me kushtet ekologjike, duke respektuar konventat ndërkombëtare, si atë: të Dablinit, Mastrihit, Danubit dhe Kyotos.

Me miratimin e këtij ligji në Kosovë do të krijohen kushtet për aderim në Organizatën Botërore Meteorologjike me seli në Gjenevë, si anëtare e

barabartë e saj. Monitorimi i resurseve natyrore të lartëpërmendura është i karakterit global dhe është obligim ndërkombëtar i çdo vendi.

Me këtë ligj rregullohen:

1. Punët hidrometeorologjike në tërë vendin.
2. Sistemi i vrojtimit meteorologjik .
3. Sistemi i saktësimit të motit dhe parashikimit të vërvshimeve në shkallë vendi.
4. Përpunimi i të dhënave meteorologjike, klimatologjike, agrometeorologjike, biometeorologjike, hidrologjike, hidrometrike si dhe monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe i ujërave nëntokësore në tërë vendin.
5. Vrojtimi i shkarkimit të ujrale atmosferike dhe hulumtimi i ndryshimeve të dukurive në atmosferën e hidrosferës me rëndësi për ekonominë e Kosovës, si dhe studimi i ndikimeve të tyre në mjedis.
6. Nxjerra dhe sistemimi i të dhënave statistikore në fund të çdo viti kalendarik.
7. Hulumtimi i dukurive dhe i elementeve meteorologjike në shkallë vendi me interes të posaçëm për shtetin.
8. Hulumtimi i ndryshimeve në atmosferën e hidrosferës dhe studime të tjera në shfrytëzimin e burimeve energetike të përsëritshme në tërë Kosovën.
9. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve meteorologjike dhe hidrologjike të monitorimit në tërë Kosovën.

Në fund, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, më lejoni t'ju them se për Ministrinë e Mjedisit për stafin e Ministrisë së Mjedisit dhe të planifikimit hapësinor, për mua jo vetëm obligim, do të jetë edhe ndihmesë e madhe bashkëpunimi me secilin prej jush, në mënyrë që edhe në fazën e shqyrtimit të ligjit nëpër komisionet e Kuvendit të arrijmë ta përmirësojmë dhe ta bëjmë sa më të zbatueshëm, në mënyrë që t'u shërbejë të gjitha interesave të vendit tonë. Ju faleminderit

KRYETARI – Ju faleminderit z. ministër, në emër të LDK-së fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

**DEPUTETI LULZIM ZENELI** – I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë. Projektligji për veprimtarinë hidrometeorologjike është pjesë e pakos së ligjeve që i ka nxjerrë Kuvendi i Kosovës dhe që mbulojnë sferën e resurseve të ujit, të tokës dhe të cilësisë së ajrit. Prandaj e konsiderojmë të rëndësishme miratimin e këtij projektligji në parim. Nevojën dhe arsyeshmërین e këtij projekti i dha ministri. Ajo që dua ta theksoj në këtë rast, që është edhe vërejtje e Grupit Parlamentar të LDK-së, se është një mangësi që po na përcillet në proces- mosharmonizimi i projektligjeve me Zyrën për proceset e integrimit evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrat, prandaj e konsiderojmë të nevojshme dhe shumë të rëndësishme që në të ardhmen që të mos ndodhë. Kjo është një vërejtje që i adresohet Qeverisë në përgjithësi.

Grupi Parlamentar i LDK-së e konsideron shum të rëndësishëm miratimin, në parim dhe do ta japë kontributin e vet gjatë procesit të amendamentimit. Ju faleminderit.

**KRYETARI** – Ju faleminderit, në emër të grupit parlamentar të PDK-së fjalën e ka deputeti Xhelal Canziba.

**DEPUTETI XHELAL CANZIBA** – I nderuari z. kryetar, të nderuar z. ministër dhe ju kolegë deputetë.

Nxjerra e këtij Projektligji bëhet me qëllim që të krijohet baza ligjore sipas së cilës do të rregullohej veprimtaria hidrometeorologjike në Kosovë dhe do të harmonizohej me atë të Bashkimit Evropian dhe organizatës botërore. Edhe në këtë projektligj, për fat të keq, nuk mungojnë gabimet gjuhësore, që shoqërojnë prej fillimit këtë Kuvend. Për shembull, te neni 2 përkufizimet, në vend se dukuri meteorologjike, është **dukurti meteorologjike**.

Punët hidrometeorologjike janë të gjitha matjet dhe vrojtimet e elementeve dhe të dukurive meteorologjike, hidrologjike, biometeorologjike, hidrobiologjike. Përpunimet dhe shpallja e rezultateve të mbledhura të këtyre matjeve dhe vrojtimeve, shpallja e informatave të rregullta dhe të kohëpaskohshme, për motin, për gjendja e ujërave sipërfaqësore dhe të ujërave nëntokësore. Vrojtimi dhe hulumtimi i ndryshimeve dhe i dukurive në atmosferën e hidrosferës, me rëndësi për ekonominë e Kosovës. Sa është kostoja e zbatimit të këtij projektligji, që në nenin 6 të këtij projektligji shkruan: financimi i punëve nga neni 5 sigurohen nga buxheti i Kosovës, për monitorimin e cilësisë së ujërave, të ajrit dhe të dheut e të rrjetit themelor, mund të bëhen me pëlqimin e organit kompetent të Kosovës. Sa është zbatimi praktik i këtyre ligjeve që ne i miratojmë në Kuvend?

Vërejtjet shpresojmë që do të mënjanohen në Komision deri në leximin e dytë, prandaj Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah Projektligjin në leximin të parë. Ju faleminderit.

**KRYETARI** - Ju faleminderit, në emër të AAK-së fjalën e ka deputeti Ymer Halimi

**DEPUTETI YMER HALIMI** – Ju faleminderit kryetar, të nderuar qeveritarë, të nderuar deputetë. Ministri Gjini dha shumëcka të nevojshme për këtë projektligj. Grupi Parlamentar i AAK-së, për projektligjin për hidrometeorologji, e mirëpriti. Projektligji është në përputhje me ligjshmërین e zbatuar në vendet e përpunuara perëndimore. Projektligji është i shkurtër dhe adreson detyrimin në mënyrë precize për të gjitha nevojat

që ai i kërkon. Megjithëkëtë te përkufizimet le dilema dhe alternativa të panevojshme. Shkenca ekzakte kërkon saktësi formulimi, e jo si bëhet në atë projektligj me fjalën ose, ose. Gjuhësish ka nevojë lekturimi, besoj edhe i konsiderueshëm. Grupi Parlamentar i AAK-së, në parim e mbështet këtë projektligj dhe do ta japë kontributin e vet në Komisionin funksional atëherë kur është në shqyrtim. Besoj se atje ka çka të thuhet. Ju faleminderit.

**KRYETARI** - Në emër të Partisë Reformiste ORA, fjalën e ka deputeti Gazmend Muhxheri.

**DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI** - Ju faleminderit z. kryetar. Para vetës e kemi shkresën e Zyrës për Integrime evropiane në kuadër të Kryeministrisë. Pas shqyrtimit të dytë të këtij projektligji, u miratuan deklaratën dhe opinioni lidhur me këtë projektligj. Deklarata e Zyrës për Integrime Evropiane është se ky projektligj, nuk mund të konsiderohet se është në pajtueshmëri me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane, për shkak të pakuptueshmërisë së shumë dispozitave të tij.

Ne kemi shkresën se janë bashkangjitur rekomandimet dhe komentet në këtë ligj, pse nuk na kanë dërguar këto rekomandime dhe komente, shtesë, si që qenë praktikë edhe më parë, që të shohim edhe t'i krahasojmë, sa janë marrë parasysh këto vërejtje dhe rekomandime, që është e vërteta në një shkresë përcjellëse të Zyrës Ligjore, e cila gjendet, gjithashtu pranë kryeministrit, thuhet se këto vërejtje dhe rekomandime janë marrë parasysh, mirépo, ne si deputetë nuk i kemi këto dhe nuk mund ta kemi të qartë a janë marrë parasysh këto vërejtje dhe rekomandimet.

Po që se merren parasysh kundërshtitë që janë brenda Kryeministrisë, do të thotë brenda dy zyrave që gjenden në Kryeministri, Zyra për Integrime Evropiane dhe Zyra Ligjore, na shkakton konfuzion në vendimmarje. Ne si grup parlamentar nuk i japid përkrahje këtij ligji, pa ardhur shkresa përcjellëse e Zyrës për Integrime, me të cilën sqarohet çështja se u morën parasysh këto vërejtje lidhur me këtë ligj. Ju faleminderit.

**KRYETARI** - Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ fjalën e ka deputeti Rifat Krasniq

**DEPUTETI RIFAT KRASNIQ** - Ju faleminderit z. kryetar  
Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Kosovada Hidrometeoroloji etkinlikleri sözkonusu iken, ben ilk önce savaştan sonraki dönemde bu Yasadaki boşlukları tamamlama çabasından bulunan Hükümet ve Çevre Bakanlığını selamlamak istiyorum.

Ülkemizde bu gibi etkinliklerin mevcut olmayışı yüzünden, oldukça zayıf olan Kosova tarımı yeterince zarara uğramıştır. Özellikle, tarımcıların çalışmaları topraklarda tabi affetler ve dolu gibi yağışlar yüzünden bazı yörenlerdeki araziler hasar görmüştür. Bu Yasanın yürürlüğe girmesiyle, hidrometeoroloji koşulları tahminlerine yardımcı bulunacak meteorolojinin denetimi yapılacaktır ve bunların esası üzere hem çevremiz, hem de tarım arazileri korunmuş olacaktır. Tarım arazilerini geliştirme olanağımız olmasa bile, en azından onların yağışlar sonucu zarara uğramasından önlememizin

gerekli olduğunu düşünüyorum. Bu etkinliğin çalışmaya başlamasıyla, gerekli olan korunma koşulları da sağlanmış olacaktır.

Bunun için de konuya ilgilenenlere, sözkonusu Yasanın doludan korunmaya ait olmadığını bildirmek istiyorum, çünkü böyle bir Yasa Çevre Bakanlığında özel olarak hazırlanmaktadır.

Tarım ile Çevre Komisyonu, çevreyi koruyanlar ile konuya ilgilenenlere; bu Komisyon sayesinde, Kosova Meclisinde bir an önce onaylanması amacıyla sözkonusu Yasa Tasarısının tamamlanmasına katkıda bulunmaları çağrısında bulunmaktadır.

KRYETARI – Ju faleminderit, ministri Gjini e ka fjalën. Urdhëroni

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit z. kryetar. E kam vetëm një shpjegim shtesë. Unë thashë se Projektligji i merr parasysh konventat e Danubit, të Mastrihit, të Dablinit dhe të Kjotos, ko është e vërtetë që ligji nuk mund të harmonizohet plotësisht me atë të Unionit Evropian, por dua vetëm t'jua përmend se nëse i qasemi trajtimit të ujërave të zeza në Kosovë, do të thotë, në se i harmonizojmë, shpenzimet buxhetore do të janë diku 500 deri 600 milion €. Do të duhej të kihet parasysh se në këtë fazë në Kosovë nuk mund t'i harmonizojmë ligjet plotësisht me rregulloret dhe me ligjet e Unionit Evropian. Ju faleminderit.

KRYETARI – Meqë nuk ka të interesuar të tjerë për diskutim, ftoj deputetët dhe lus reginë të përgatitet për votim në parim. Në sallë janë 78 deputetë. Votojmë tash:

Për.....60,  
Kundër.... 10.

Kalon ligji. Miratohet në parim në bazë të rregullave 23 pika 6 dhe 35 pika 2 dhe Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe për Mjedisin e Planifikimit Hapësinor, si komision funksional dhe referues.
2. Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisionin për Financa dhe Buxhet dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisioni duhet, në afat jo më shumë se 2 muaj, pas shqyrimit të parë ta shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqet raport me rekomandime, sipas rregullës 35 pika 6. Ju faleminderit. Propozoj një orë pushim.

po e fillojmë, në pikën e 6 të rendit të ditës,

KRYETARI – Debatin

**6. Interpelanca e ministrit Qemajl Ahmeti me kërkesë të Grupit Parlamentar të PDK-së për gjendjen në rrugët e Kosovës**

Në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i PDK-së, i është drejtar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit z. Qemajl Ahmeti.

Interpelancën e parashtruar, Kryesia ia ka dërguar z. ministër Ahmeti për shqyrtim dhe për përgjigje. Në afatin e paraparë me Rregullore të punës ministri Ahmeti është përgjigjur në përfundim të mbledhjes se Kryesisë. Përgjigjja e ministrit Ahmeti u është shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve. Gjithashtu ju njoftoj se konform rregullës 27 të Rregullores së punës, deputeti Emrush Xhemajli ka parashtruar pyetje dhe ka marr përgjigje nga ministri i Transportit z. Ahmeti, që ndërlidhet me kërkesën e interpelancës së PDK-së, prandaj mund të vazhdojmë me procedimin e mëtutjeshëm.

Në pajtim me rregullën 25 pika 6 në fillim të debatit, duhet ta marrë fjalën përfaqësuesi i PDK-së z. Jakup Krasniqi.

**DEPUTETI JAKUP KRASNIQI –**Z. kryetar, z. ministër, të nderuar deputetë.  
Edhe pse me vonesë, e përshëndesim gatishmërinë e ministrit për t’iu përgjigjur kërkesave tonë për interpelancë. Përgjigjja që kemi marr nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, më tepër është një përgjigje, një pjetje parlamentare, sesa një përgjigjeje sipas interpelancës që e kemi bërë. Kjo në një mënyrë tregon se Ministrisë i mungon administrata profesionale, i mungojnë ekspertët, madje i mungojnë edhe këshilltarët që ci marrin të ardhura të mira nga buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe që nuk i kanë ndihmuar sa duhet ministrit për të na njoftuar për gjendjen e rrugëve në Kosovë. Në përgjigjen e ministrit kemi vetëm një përshkrim të gjendjes së rrugëve në Kosovë. Në përgjigjen e vet Ministria do të duhej të na ofronte planin për sanimin e magjistraleve të Kosovës. Ky plan nuk është, as për një afat emergjent, as për një afat pak më të gjatë.

Ministria është dashur të na njoftonte se cilat janë pasojat e gropave në magjistrale të Kosovës, sa ndikojnë ato në trafikun kosovar, cilat janë ndikimet e këtyre gropave në fatkeqësitetë në komunikacion? Sa jetë njerëzish pësojnë për shkak të gjendjes së keqe në rrugët e Kosovës? Pse? Këto rrugë sa i kushtojnë buxhetit të qytetarëve të Kosovës.

Qytetarët paguajnë taksë përrugët. Ku shkojnë dhe si shfrytëzohen ato mjete? A po riparohen rrugët me mjetet e tatimpaguesve që jepen për automjete që kanë. Z. ministër ka qenë i obliguar të na paraqes një raport më të detajuar për shembjen e dheut në afërsi të Hanit të Elezit. Në raport sikur nuk thuhet asgjë për këtë, a janë respektuar rregullat e tenderimit? Sa i ka kushtuar buxhetit të Ministrisë myllja e rrugës dhe pengesat që i janë bërë qarkullimit të mallrave, sa i ka kushtuar buxhetit të konsoliduar të Kosovës?

Kush ka qenë dhe a e ka evidencuar Ministria ndonjë përgjegjësi subjektive dhe cilat janë masat që u morën për ato përgjegjësi? Ndërsa sa i përket korridorit të rrugës Merdar – Morinë, mënyra si është vepruar deri më tanë ka dëmtuar buxhetin e konsoliduar të Kosovës, njëkohësisht ka dëmtuar rëndë ekonominë dhe zhvillimin e saj. Po e pyesim ministrin; Pse është shpallur tenderi për projektet pa u kryer studimi i vizibilitetit, studimet e ambientit, studimet gjeomekanike dhe pa bazën e nevojshme ligjore? Sa ka kushtuar tenderi? Sa është vlera e punëve shtesë, përkatesisht përqindja e rrëtjes nga kontrata e parë në atë përfundimtare? A ka pasur ekspertë vendorë nga

Qeveria për monitorimin e projektit? Kush e ka pranuar projektin? Pse nuk është transparent projekti? Pse mbahet larg ekspertëve projekti? Sa do t'i kushtojë projekti këtij korridori rrugor? Sipas logjikës së veprimit të deritashëm duket se Ministria, sipas përgjigjes se saj, nuk kishte plan si të dilej nga gjendja e rëndë që ekziston në rrugët e Kosovës dhe jo vetëm në magjistrale, por të në të gjitha rrugët e tjera të Kosovës që Ministria duhet të jetë mbikëqyrëse, përcjellëse dhe kontrolluese e gjithë sistemit rrugor në Kosovë. Ju faleminderit.

KRYETARI – ju faleminderit, fjalën e ka ministri Ahmeti

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Ju faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë. E falënderoj shumë grupin parlamentar që ka parashtruar pyetjen si interpelancë dhe që më ka dhënë mundësi që të përgjigjem para jush.

Por e ka vetëm një dilemë, pas diskutimit të z. Krasniqi, meqë për të dytë e kam pasur një pyetje parlamentare, konsideroj që ka qenë njësoj si interpelancë, sepse nuk dua t'i dallojë dhe i bëj pyetje kryetarit, a duhet t'ua lexojë përgjigjet me shkrim që i keni marrë të gjithë apo t'u përgjigjem vetëm pyetjeve që u parashtruan tash.

KRYETARI- Forma se si përgjigjeni ju është çështja juaja z. ministër. Mund ta lexoni, mund të përgjigjeni me gojë, është çështje për të cilën përcaktoheni ju.

MINISTRI QEMAJL AHMETI- Meqë konsideroj se përgjigja është marrë me shkrim, dëshiroj që këto elemente që i parashtri kryetari i GP të PDK-së, do të përpinqem të përgjigjem, nëse mund t'i shënoj të gjitha pyetjet.

Në pyetjen e Grupit Parlamentar është shtruar: Cila është gjendja e rrugëve të Kosovës, sipas Ligjit për rrugët, kompetencë e të cilit është Ministria e Transportit dhe çka ka bërë ajo për ta përmirësuar gjendjen e rrugëve? Prandaj këto pyetje që u bënë tash janë pyetje më të hollësishme që ndoshta është dashur të shtroheshin më detajisht ..

Kthehem të pyetjet; Ku shkon taksa rrugore që paguajnë qytetarët e Kosovës me rastin e regjistrimit të automjeteve? Kjo nuk ishte pyetje në kuadër të asaj që kam marrë unë, si pjesë e interpelancës, por përgjigja është shumë e shkurtër. Taksa rrugore, me rastin e regjistrimit të automjeteve, shkon në buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe nuk destinohet për rrugë. Pse nuk destinohet, nuk e di, duhet ta dini ju deputetët. Është në buxhetin e përgjithshëm, pastaj bëhet planifikimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës, ndahan segmentet e tjera, ku dhe Ministria e Transportit është një segment, një njësi buxhetore.

Sa i përket mbylljes së rrugës Prishtinë – Kaçanik, jo në Han të Elezit, por në Kaçanik, para Gurit të Shpuem atje, përsëri kam konsideruar se nuk është bërë pyetje. Unë vetëm kam dhënë një informatë të shkurtër atje në përgjigje, përndryshe mund t'ua jap tash nëse keni durimin se si ka shkuar procedura dhe si është gjendja në rrugë. Nëse më lejohet mund t'ju them.

Rruja e Kaçanikut është mbyllur me shembjet e para të gurëve. Ka ndodhur me 15 janar. Më 16 janar kam marrë urdhëresën për mbylljen e rrugëve për shkak të sigurisë. Më 17

janar u bë shembja e madhe e dheut. Më 20 janar kemi angazhuar kompaninë që ka qenë për mirëmbajtje të rrugëve ta evitonte këtë masë të dheut, Kjo ndodh më 25 janar dhe rruga ka qenë fizikisht e hapur. Por kësaj rruge i është kanosur rreziku i shembjeve të mëdha të kodrës ,prandaj duhej të merrej vendimi për hapjen e kësaj rruge,por nuk ishte lehtë, me fjalë të tjera kanë kaluar disa kompetenca në pjesën e sigurisë. Kam formuar grupet pune prej nivelit më të lartë të menaxhimit të situatës deri të grupet teknike, grupet profesionale me të cilat janë marrë gjatë gjithë kohës. Konform sugjerimeve të grupeve të punës merrja vendimet përkatëse, varësisht nga shembja e dheut Shkaqet kanë qenë në shikim të parë, ato që mandej i konstatonte grupi i ekspertëve . Shkak i shembjes ishte konstatonte eksplorimi shumëvjeçar i keq i kodrës U konstatuaam në teren se shpat quhet fshati Bob. Në vitet 40 e tutje ka qenë hambar i gurëve gëlqeror për mbarë Kaçanikun. Pasoja të eksplorimit të keq dhe të veprimit të ujërave sipërfaqësor ishte shembja e dheut.U konstatua me analizat profesionale që u bënë në fazën e dytë, sepse tërë ky proces u nda në dy fazë: në fazën emergjente , sepse kjo ishte fatkeqësi elementare .që ndoshta është dashur të debatohej për të edhe këtu . Në pjesën emergjente kemi paraparë largimin e dheut nga rruga dhe stabilizimin e kodrës, edhe pse këtu në mungesë të ligjit për fatkeqësi elementare apo të Rregullores për to, është dashur. Ndoshta të debatohej edhe këtu.Kam pasur nuk e di a taksirat apo nderë të ballafaqohet Ministri i Transportit me këtë pünë , meqë realisht i tejkalon përgjegjësit e Ministrisë së Transportit se ka të bëjë me një stabilizim të kodrës që nuk është me ligjin , por ka marrë detyrë nga Qeveria që të vazhdojë punën.

Pyetja sa ka kushtuar kjo rrugë?Të gjitha punët që u kryen brenda 50 ditëve, kanë kushtuar 367 mijë € , që kur i shtohet edhe kompensimi i dy pronave të pronarëve, të cilët atë pronë më nuk e shfrytëzojnë se është shembur, atëherë mbërrin 387 mijë €. Sa i përket korridorit të shtatë, përsëri mund të konstatoj se nuk kam pritur fare të jap përgjigje, por ka qenë pyetja rrugët e Kosovës ,pra në përgjithësi. Para se të kaloj në këtë pyetje mund të japë një informatë, se për herë të parë në historinë e rrugëve të Kosovës , janë shqyrtuar detajisht sipas programit HDM4. Çka përbën ky program? Për herë të parë në historinë që e bëjnë krejt vendet e botës , u maten konstruksioni i rrugëve, trupi i rrugës me të gjitha elementet përcjellëse. Të dhënët e gjithë rrugëve- e kam fjalën gjithmonë përrrugët që janë në kompetencë të Ministrisë , për rrugët magjistrale dhe rajonale dhe për objektet përcjellëse , pra urat dhe tunelet. Në përgjigjen time kam bashkangjitur edhe këtë material të këtyre matjeve të rrugëve.

Sa i përket korridorit, unë mund t'i jap disa elemente përshkruese të korridorit për pyetjet që parashtroi deputeti, por në çfarëdo kohe në çdo mënyrë jam i gatshëm të jap çdo informatë që është për publikim. Projekti i autostradës, Prishtinë – Durrës, përkatësisht Merdar – Prishtinë- Durrës, ka filluar në vitin 2004 dhe kontraktuesi gjerman ,kompania gjermane BPI Kansel, ka pasur për detyrë që brenda 7 muajve ta ndërtojë këtë projekt. Në momentin kur kam ardhur unë projektin ,d.m.th. është dashur diku në mars të kryhej. Unë jam zgjedhur ministër , ju e dini më 3 dhjetor 2004. më 7 dhjetor kam marr detyrën dhe më është dashur të ballafaqohesha edhe me një projekt që nuk ka qenë. Në kontratën e nënshkruar ishte , sipas ekspertëve tanë, mjetet e destuguara për këtë kanë qenë të paguara diku 80 – 85%, kurse puna për projektin ka qenë e realizuar më pak se 40%. që është dashur të merret pastaj me këto. Mungesa e studimit të fizibilitetit dhe paraqitja e të dhënave për ta ndërtuar një projekt ka munguar , sepse janë paraqitur arsyeshmëritë

teknike ose të dhënat preferenca për ta ndërtuar këtë projekt ma pak se ato që kanë dalë në terren. Si rezultat i kësaj është dashur që kompania konsulente në momentin e parë të marrjes së detyrës si ministër ka ofruar kërkuesën që kjo rrugë ose ky projekt do të kushtojë 4 milion e 905 mijë €, kurse kontrata ka qenë e nënshkruar 2 milion e 800 e 49 mijë, nëse nuk gaboj. Në kërkuesën time nga kompania në bazë të çkafit u bë asnjë procedurë nuk ka lejuar në këtë, prandaj e ndala dhe janë bërë vetëm disa elemente shtesë dhe projekti pas disa konsultimeve ka përfunduar dhe ka qenë shumë transparent. Kushtoi diku 3 milion e 175 mijë euro bashkë me këto 15% tvsh-ja. Tash nuk e kam atë shumë të përcaktuar këtu, por kjo është vlera. Projekti pse nuk është bërë transparente, kutoj që shumë është transparente, sepse më 27 tetor të vitit 2005, publikisht para presidentit Rugova, ka përfunduar projekti bazik i autostradës.

Pse shpallet fizibiliteti? Është një pre pyetjeve të tjera. Fizibiliteti i autostradës, këtu është shpallur edhe fizibiliteti i korridorit të shtatë që quhet autostradë edhe të korridorit 6, d.m.th.. rrugët Prishtinë – Hani i Elezit dhe Prishtinë- Pejë -Deçan që mendoj si rrugë e gjashtë. Unë mendoj që të lidhet me korridorin 8, t'jua them të drejtën zakonisht punët duhet të kryhen sipas preferencave të Bankës Botërore dhe standardeve evropiane. Asnjë rrugë nuk mund të fillojë së ndërtuari pa u bërë arsyeshmëria ekonomike, pra fizibiliteti, te ne ka ndodhur një dukuri, d.m.th. kemi filluar ndërtimin e projektit pa e bërë fizibilitetin dhe ne kemi qenë të shtrënguar dhe të detyruar, nëse dëshirojmë që këtë projekt ta çonim përpara, që ta shpallim projektin e fizibilitetit për ta ndërtuar e për ta kompletuar dhe jemi në këtë fazë. Pastaj kemi qenë të shtrënguar, po ashtu. Meqë në fazën e parë për ndërtimin e autostradës nuk është paraparë që në trasenë e saj do të ketë tunel se do të ketë numër të madh urash, ju lutem në studimin tonë që është bërë brenda Ministrisë, ka qenë studimi i mangët, nuk janë paraparë tunelet që tash në projektin e ndërtuar janë afro 5 km. tunel, janë paraparë afér 51 ura, janë 105 ura dhe këto e kanë rritur koston dhe kontrata s'ka pasur mundësi, sepse është dashur procedurat e prokurimit në këtë formë dhe është dashur me shkëput një element disa elemente me i lanë për të shpallur një tender të veçantë dhe kemi arritur mirë dhe do të arrijmë mirë.

Nëse më lejoni, do ta paraqes edhe një informatë që lidhet me autostradën, kjo është pozitive, pra kjo nuk ka të bëjë me interpelancë, ndoshta nuk është keqpërdorim i mikrofonit.

Ministria e Transporteve, pra Qeveria ka arritur që autostradën Merdar-Prishtinë-Durrës ta fuste në mesin e 20 prioriteteve të rrugëve rajonale në kuadër të opservatoriumit të transportit për shtetet e Evropës Juglindore që njihet si SITO dhe në këtë kontekst është një fitore shumë e madhe, sepse kemi arritur të vijnë në prioritet edhe rikonstruimi i Aeroportit dhe mund të vjelim donacion, ndihmesë apo investime, më mirë të them, nga ky asociacion në vlerë prej 154 milion euro për 5 vjetët e ardhshme dhe kjo është një sukses jo vetëm i Ministrisë dhe i tërë Qeverisë bashkërisht, pra edhe i Kuvendit. Këto pyetjet e tjera, z. deputetë nuk di a iu përgjigjja të gjithave. Ju faleminderit!

KRYETARI- Ju faleminderit z. ministër, hapet debati rreth fjalës së z. ministër. Deputeti Bajram Rexhepi e ka kërkuar fjalën.

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI – Faleminderit z. kryetar, do të provojë të jem në kuadër të pyetjeve, dhe temës. Por megjithatë, mund të jetë një shhangje e vogël.

Mendoj se Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, është një ndër ministritë të cilat nuk kanë treguar aktivitet të mjaftueshmë. Kjo shihet nga gjendja e rrugëve magjistrale, por për shkak të një aktiviteti të vogël, ose mos them, kemi humbur shumë iniciativa rajonale, edhe sa i përket paktit të stabilitetit në tryezën e dytë të infrastrukturës, ku kanë qenë të përfshira institucionet e Kosovës dhe Ministria, po edhe në programet e REBIS-it që të mos ju lodhi më tutje, se hynë edhe në projektet e infrastrukturës rrugore, edhe hekurudhore edhe të tjera. Pra tash nuk jemi askund, jemi të izoluar. Kjo është pasojë e një pune të mangët të Ministrisë. Rregulloret nuk di si shkojnë, por desha t'ia bëj një pyetje ministrit: Çka u bërë me mjetet që kanë qenë nga licencimi i Valës 900? , ku ish Qeveria të cilën unë e kam udhëhequr, kam marr vendim që një pjesë e atyre mjeteve t'i ndanë arsimit, ndërsa mjetet e tjera të destinohen përrugët, Skenderaj Klinë, deri në Turiqec, ku është bërë edhe inaugurimi i fillimit të punëve, çka u bë me rrugën rajonale Vushtri, Skenderaj e cila po ashtu ka qenë e planifikuar dhe me segmentin e rrugës 6 km Mitrovicë – Besianë, konkretisht prej Kaçanollit deri në Besianë.

Dhe në fund pa dashur t'ju lodh, mendoj se një sëmundje e përgjithshme që është çështja e marrjes ose fitimit të tenderëve,, po reflektohet edhe më tutje në Ministrinë e Transportit e të Telekomunikacionit, që nuk është diçka e-re, derisa menjëherë pas luftës kemi pasur një vërvshim të kompanive që merren qoftë me ndërtimin e rrugëve qoftë me riparimin e tyre, pra kanë lindur si këpurdhat pas shiut, pa mjete të duhura, nga një herë me një gjysmë traktori dhe me 10 punëtorë, ose me disa punëtorë që vetëm e prenin asfaltin, dhe zakonisht i fitonin tenderët. Mirëpo është koha që pas 6 ose 7, vjetëve të kemi një evidencë dhe kompani të cilat kanë punuar më mirë, kanë bërë punë kualitative t'ju jepet prioritet e jo të marrin kompanitë ose nenkontarktorët që edhe punën nuk e kanë cilësore dhe ende pa hyrë në sezonën e dimrit, për dy- tre muaj ato harrnime që bëhen dëmtohen përsye se as nuk kanë laborator përrkontrollimin e asfaltit as një parametër që garanton. Mendoj se është koha të mendohet dhe të marrin punë ato kompanitë të cilat janë të pajisura dhe kanë seriozitet. Ju faleminderit.

KRYETARI- Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Alush Gashi

DEPUTETI ALUSH GASHI- Ju faleminderit z. kryetar. Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin me shkrim, në formë të përgjegjëses së dhënë përkëtë interpellancë të ministrit z. Qemajl Ahmetit.

Ne i japim mbështetje të plotë përgjegjëses së hartuar me shkrim, dhe sot e mirëpresim përgjigjen e tij me gojë, si përgjigje të plotë sa i përket grupit tonë. Si grup parlamentar ne angazhohemi përshtim të fondevë përrmirëmbajtje, ndërtim dhe zhvillim të infrastrukturës rrugore në Kosovë dhe të rrugëve ndërkombëtare të Kosovës. Kërkojmë nga Ministria dhe Qeveria angazhime shtesë në argumentim të domosdosë së lidhjes së Kosovës me pjesën e Mediteranit si edhe me rrugët të cilat do të shpien për portin e Selanikut dhe për portet e tjera rajonale.

Nga Ministria kërkojmë të bëhen përpjekje shtesë, në promovim të domosdosë së ngritjes së fondevë, mjetet e të cilave krijohen nga taksat dhe pagesat të cilat aktualisht bëhen përshtje të rrugëve të Kosovës dhe nuk derdhen në këtë fond. Andaj duke

përgëzuar ministrin e riafirmojmë qëndrimin tonë se Kosova si vend i vogël ka nevojë për përkujdesje shumë më të madhe për ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe për investim shumë më të theksuar për atë që nuk është sot çështje e bisedës, e që është zhvillimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Kosovës në Prishtinë. Ju faleminderit

**KRYETARI – Fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**

**DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU-** Ju faleminderit z. kryetar, më vjen keq që fjala ime është shumë larg përgëzimit të ministrit dhe fillimisht do t' ia bëjë një pyetje, a ka kaluar kohëve të fundit nëpër aksin rrugor Pejë- Prishtinë?

Thjeshtë po që se ka kaluar, s'e e pashë që e kishte evidencuar që janë disa probleme sidomos në Grykën e Llapushnikut, por unë po ju tregoj se ju e keni detyrë, ju vozitësit që t'u përshtaten gropave dhe falë akrobacioneve njerëzit shpëtojnë kokën në atë aks. Po e përmend ditën e djeshme kur gropat mbulohen me ujë dhe është shumë vështirë të identifikohen, të mos t flasim për autoambulancat, të cilat çdo ditë transportojnë të sëmurë në gjendje të rëndë dhe a thua a është bërë ndonjë analizë sa jetë ka kushtuar kjo rrugë.

Z. ministër merreni shumë seriozisht çdo ditë njerëzit pyesin, në e kuptuam që shkojnë në buxhet, por megjithatë një rehabilitim, së paku i përkohshëm, se e kuptuam se e keni të dobët bazën, i keni planet afatgjata, por disa çështje nuk mund të presin, mbushja e një grope së paku e përkohshme ,do të shpëtonte shumë jetë, do të na mundësonse së paku ne deputetëve të vijmë të sigurt në Prishtinë. Ka edhe shumë problemeve të tjera brenda qyteteve, por po ia lëmë komunës. Së paku për këtë kisha dashur përgjigje apo ndoshta arsyeshmëria e numrit kaq të madh të xhipave që janë me të vërtetë komforë dhe gropat i hetojnë më pak. Atëherë e kuptoj pse blihen,sepse me të vërtetë nuk lihen rrugët malore ,por autostradat me xhipa dhe në këtë rast kur e pash sot e kam arsyetuar ekzistimin e numrit kaq të madh të xhipave për rrugët tona magjistrale ndërkunale. Ju faleminderit

**KRYETARI- Ju faleminderit fjalën e ka deputeti Naim Maloku**

**DEPUTETI NAIM MALOKU -** Ju faleminderit z. kryetar, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të them se e mirëpresim paraqitjen e z. ministër në interpellancë. Ne e kemi shqyrtuar raportin me shkrim që e kemi marrë si përgjigje në pyetjen e parashtruar nga Grupi Parlamentar i PDK-së dhe i deputetëve të nënshkruar për atë pyetje.

Më lejoni të them se Grupi Parlamentar i AAK-së ka shqetësimin për gjendjen e rrugëve në Kosovë. Nuk dua t'i përsëris fjalët që u thanë nga parafolësit, por do ta citoja fjalët e Bajram Rexhepit dhe të deputetit Alush Gashin, por më lejoni se në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të them se duhet të rishqyrtomë vendimin e Parlamentit të Kosovës, që në Ligjin për rrugët, nuk kemi lejuar fond të veçantë nga taksat që merren nga qytetarët e Kosovës me afatin e regjistrimit të veturave dhe të ndahet një fond i veçantë, e kemi bërë në ligj që ajo taksë të derdhet në buxhetin e konsoliduar të Kosovës, pra, ne vetë kemi vendosur si Kuvend që Ministria të mos e manipulonte atë taks dhe normalisht ka shkaktuar huti te qytetarët e Kosovës dhe të të gjithë pronarët e automjeteve që pyesin se ku janë ato mjete. Unë ftoj që një procedurë të fillojë a është e

arsyeshme tē rishqyrtohet edhe një herë apo tē plotësohet Ligji mbi rrugët dhe ky Kuvend tē marrë vendimin që me ndryshimin e Ligjit tē formohet një agjenci që c kishte me u marrë me mbledhjen e asaj takse dhe normalisht me planifikimin e ripërtëritjes apo me rehabilitimin e rrugëve, pra që taksa t'i dedikohet vetëm mirëmbajtjes së rrugëve. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI- Fjalën e ka deputeti Rifat Krasniq

DEPUTETI RIFAT KRASNIQ –

Sayın Meclis Başkanı, sayın bakanlar ve değerli milletvekilleri

Konuşmamin başında Kosova Meclisi, Kosova halkı ve politik partilerine, Mamuşa Pilot Projesinin gerçekleşmesi yönündeki katkılarından dolayı teşekkür etmek istiyorum. Biz Kosovanın her açıdan daha zengin ve celbedici olması için elimizden geleni yapacağız. Mamuşalar yıllarca Mamuşa-Pirane yol sorunuyla karşılaşmaktadır. Ancak bu sorunun görüşülmeye başlamasından dolayı kendimizi mutlu hissediyoruz. Bize göre bu sadece Mamuşaların sorunu değil aynı zamanda Mamuşa, Zoys ve Pirane köylerinin ortak sorunudur. Geçenlerde biz bu konuya ilgili olarak Dünya Bankasıyla bir temasta bulunarak onlar bize Kosova Meclisi ve bakanlıklarla işbirliği sayesile yoğun etkinliklerin sürmekte olduğunu bildirdiler. Dünya Bankası yetkilileri bu projenin gerçekleşmesi konusunda yardımcı olacaklarını söyledi.

Aynice geçenlerde Ulaşım ve Telekomunikasyon Bakanı Çemal Ahmeti de Mamuşayı ziyaret etti ve projenin gerçekleşmesi konusunda etkin olacaklarını ileri sundu. Biz de Sayın Ahmetiye ziyareti için teşekkür ederek hazırladığımız projeyi sunduk. Buna rağmen şimdilik tüm bu girişimler sadece proje halindedir. Hazırladığımız projeye göre Mamuşa-Pirane yolu, Yakova-Prizren yoluna bağlandığı için bay-pas rolüne de sahiptir. Bu projenin gerçekleşmesi halinde yöredeki yol 50 kilometre için daha kısa olacaktır. Bu yörede 26 000 kişinin yaşadığı gözümüzde bulundurursak, bu proje ile sadece Mamuşalar değil civarda yaşayan herkesin rahatlaması sağlanacaktır.

Sağlıklı bir yıl dilerim. Saygıdeğer milletvekilleri, bu yörede yaşadığım için bu sorunun çözümlenmesiyle yakından ilgilenen yerlilerle devamlı olarak temastayım. Sorunları kendim de doğrudan yaşadığım için her fırsatta bu soruna güncelik kazandırmak için kendimi sorumlu hissediyorum. Burada bulunan herkesi, sorunumuzun çözümlenmesine katkı sunması için davet ediyorum. UNMİK Özel temsilci Soren Yesen Petersen ve Kosova Başkanı Sayın Fatmir Seydiunun da gözlemlediği gibi bu proje gerçekten gereklidir ve hepinizin yardımını beklemektedir. KDTP Başkanı Mahir Yağcılar ve ben birkaç defa bu soruna parmak basarak bu gibi projelerin hayatı önem taşıdıklarını ileri sürmüşüzdür. Çünkü bu ve buna benzer projeler Kosovanın gelimesi ve yakınlaşması için son derec önemlidir. Şu anda bu bize Kosovanın verebileceği en büyük ödülüdür. Çünkü yollar bizi her alanda birleştirip bağlayan unsurdur.

KRYETARI- Ju faleminderit. Urdhëroni z. Nekibe Kelmendi

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Unë, z. kryetar, do tē përqendrohem vetëm në përgjigjen që e dha z. ministër për pyetjen: ku po shkojnë mjetet e taksave që po mblidhen me rastin e regjistrimit tē veturave. Të gjithë ne deputetët e kemi pasur para

vetit Ligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2006, kemi pasur pasqyrën se si po bëhet ndarja e parave, prej atij buxheti. Pse atëherë nuk na binte ndër mend që ta ngrenim zërin dhe të thoshim : Hajde të ndajmë të holla më shumë për ndërtimin apo rindërtimin e rrugëve të Kosovës ,sepse e kemi në gjendje të keqe. Tash kur Ligji për buxhetin e Kosovës është miratuar para 5 muajsh është jo korrekte t'ia shtrojmë pyetjen ministrit se: ku shkuan ato para dhe pse nuk po i ndërtoni rrugët. Me çka ka t'i ndërtojë rrugët kur buxheti nuk ia ka mundësuar? Kjo vlen për herë të tjera. Nëse duam rrugë të mira, kur të diskutohet për Ligjin për buxhetin , duhet të jemi më aktiv dhe të insistojmë që një pjesë e mjeteve të konsiderueshme të ndahet për rrugët e Kosovës. Ne e dimë se sa janë të rëndësishme ato, por mos harroni edhe një gjë, nuk ka kontroll edhe në komunikacion apo në trafik, sidomos në trafik për mbipeshën që është duke i dëmtuar shumë rrugët rajonale të Kosovës. Edhe unë udhëtoj në relaciuni Pejë -Prishtinë. Prej Prishtinës kur shkoj për Pejë, ana e djathtë e rrugës është më e mirë, kur kthehem prej Pejës për Prishtinë, ana e djathtë prapë e imja është si një harmonikë, pse? Pse kalojnë automjete me rërë me mbi peshë, kalojnë autobote me mbipesha për të cilat ajo rrugë nuk është paraparë kur është ndërtuar, sepse e ka bazën më të dobët dhe e ka asfaltin jo kualitativ , por edhe më të hollë, prandaj le të jemi më syçelur kur të diskutohet për buxhetin e Kosovës dhe të insistojmë , nëse dom ta ndihmojmë Ministrinë që të na ofrojë komunitet më të madh në rrugët e Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYETARI- Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Zef Morina**

**DEPUTETI ZEF MORINA-** Ju faleminderit z. kryetar, zonja dhe zotërinj. Nuk e kam ndërmend të adresoj kritika për punën e Ministrisë dhe të ministrit, edhe pse ka arsyë dhe argumente për të qenë të pakënaqur me ecurinë e punëve në këtë digaster shumë të rëndësishëm për jetën e qytetarëve të Kosovës.

Kritikat tashmë janë shfaqur nga qytetarët, të cilët çdo ditë e më tepër në mënyra të ndryshme paraqesin zhgënjin e tyre. Është e vërtetë se buxheti i cili është ndarë për Ministrinë, është i pamjaftueshëm për t'i mbuluar dhe për t'i ndërtuar të gjitha rrugët e Kosovës ,të cilat vërtetë janë në një gjendje jo të mirë për shkak të komunikacionit shumë të dendur që ka në Kosovë, pra një disproporcionalë më mes të automjeteve dhe infrastrukturës rrugore. Për hir të njoftimit të drejtë të opinionit vendor pas disa deklaratave të pa përgjegjshme dhe të pavërteta të bëra nga ministri ditë më parë, jam i detyruar t'i bëjë disa sqarime. Nuk është e vërtetë që projektet e infrastrukturës rrugore, për të cilat janë kryer procedurat dhe rregullat tenderuese nuk kanë pasur mbulesë financiare, mund të them me përgjegjësi të plotë se të gjitha projektet e shpallura dhe të përgatitura për vitin 2004, kanë pasur mbulesë financiare nga buxheti i Ministrisë, mjetet e siguruara nga kuvendet komunale dhe nga komuniteti. Mendoj se fajtor për mos realizimin e disa projekteve për vitin 2005 kanë qenë mosrealizimi i mjeteve të ndara ,si e ceku z. ish -kryeministër Bajram Rexhepi .Nga licencimi i telefonisë mobile Vala 900 vlera ka qenë 6.3 milion €. Nuk e kam ende të qartë pse ato mjete nuk u shfrytëzuan dhe pse ato projekte të cilat ishin të përgatitura për t'u realizuar nuk u realizuan. Ndoshta këtu ka qenë edhe arsyja se ministri, si e ceku se ishte fillimi kur e mori detyrën dhe nuk kishte mundësi ta argumentoj në një mënyrë që ato mjete duhet të barteshin për vitin 2005, në mënyrë që të kryhen projektet, mund të them shumë shkurt që gjatë viteve 2002 dhe 2004 në Kosovë janë ndërtuar dhe rikonstruar 500 km rrugë nga po ky buxhet të cilin edhe tash Ministria e ka, por natyrisht ka qenë ndoshta një angazhim tjetër. Sa i

përket autostradës dëshiroj një sqarim pak më të thuktë, sepse në ato kohë unë kam qenë ministër dhe nuk është e vërtetë që nuk ka pasur fizibilitet ose arsyeshmëri ekonomike. Në bazë të fizibilititetit që është bërë nga ekspertët e Drejtorisë së Rrugëve del që rruga Prishtinë – Durës mund të kategorizohet ose të punohet si autostradë, pasi brenda 24 orëve nëpër të rrugë tani kalojnë më së 13 mijë e 500 automjete, kriter i mjaftueshëm që rruga të kategorizohet ose të ndërtohet autostradë dhe pikërisht për këtë ne e kemi shpallur tenderin për ndërtimin e projektit zbatues, i cili ka qenë ndërkombe tar dhe kanë marrë pjesë 4 kompani. Është e vërtetë që kompania më e shtrenjtë ka qenë rreth 4 milion, ndërsa më e lira ka qenë rreth 2.5 milion €, pa llogaritur tvsh-në. Mua më intereson pas raportit që e kam lexuar, pse u ndryshua kontrata dhe u shtrenjtua 35% dhe çështje tjeter, pse nuk janë ndërtuar ose nuk janë projektua projektet e veprave të artit? Nuk është e vërtetë që në autostradë nuk parashihen ura, urat kategorizohen në ura estakade, të cilat shërbejnë përmendime, urat viadukt të cilat i mbulojnë luginat dhe urat nyjelidhëse. Ndërsa përtuneli është paraparë me fizibilitet që do të jenë vetëm dy, a në fakt kanë dalë tri tuneli që është e mundshme për shkak të ndryshimit të trasesë.

Pra, unë mendoj që arsyaja pse është shtyrë projekti dhe nuk është realizuar dhe arsyaja tjetër pse nuk qenka bërë fizibiliteti, nuk qëndrojnë, sepse në atë kohë kemi pasur edhe kompani të interesuara për të ndërtuar këtë autostradë. Sigurisht ministri tanë do të ketë takime me ato kompani të cilat kanë pritur të aprovohet Ligji mbi koncesionet. Është e vërtetë që në marrëveshjen e REBISIT, të nënshkruar në Luksemburg, të vitit 2004 parashihen edhe ndihmat ose mënyra e financimit të projekteve, duke përfshirë këtu edhe autostradën. Mua më intereson vetëm një pyetje e z. ministër: Ku është arsyaja që ia ktheni mjetet komunitetit që me dëshirë ka kërkuar ndërtimin e rrugës rajonale tek Ura e Tabakut, te Qafa e Prushit dhe i ka depozituar mjetet në bankë, pikërisht për këtë destinim. Nga ana tjetër më 7 shtator këruat nga nga Qeveria tejkalimin e mjeteve për këtë rrugë, nga njëra anë ua ktheni paratë komunitetit, kurse nga ana tjetër kërkon nga kryeministri Kosumi që t'ju japë mjete shtesë për ta mbuluar projektin. A mos ishte ky një gabim teknik apo ndonjë qëllim tjetër politik? Ju faleminderit.

**KRYETARI**- Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Hatixhe Hoxha

**DEPUTETJA HATIXHE HOXHA**- Z. kryetar, të nderuar deputetë, nga informacionet që janë ofruar si dhe nga raporti që na sjell nga ministri i Transportit, thuhet se kjo ministri ka realizuar shumë projekte në konstruimin e rrugëve dhe sipas tyre pritet që edhe shumë të tjera të realizohen, mirëpo gjendja faktike në rrugët e Kosovës paraqitet krejtësisht ndryshe, përfaktin se të pakta janë rrugët që nuk janë të dëmtuara, ku ka fjetje të trupit të rrugës apo të mbushura plot e për plotë me gropat të cilat paraqesin vështirësi në komunikacion, si për jetën e njeriut, ashtu edhe po shkaktojnë dëme materiale.

Po t'i referohemi një statistike të rrugëve shihet se sa i përket rrugëve të shtruara, 6% e tyre kërkojnë rikonstruim, ndërsa 27% kanë nevojë për rehabilitim. Por asfaltimi dhe rehabilitimi do të duhej të bëheshin konform nevojave e jo me këto punë të merremi në prag të fushatave zgjedhore. Për infrastrukturën rrugore më shumë interes është edhe ruajtja e kualitetit të rrjetit rrugor, si dhe mirëmbajtja e rregullt e tij. Dëshiroj të theksoj një fakt se në bazë të disa informacioneve që kemi shihet se në vitin 2005 dy regjione nuk kanë pasur mirëmbajtje verore, Prishtina dhe Gjilani, për shkak të anulimit të tenderit. Mirëmbajtja dhe ruajtja e infrastrukturës rrugore është domosdoshme për arsyet e

shkatërrimit të rrjetit, si pasojë e ngarkesave të komunikacionit, sidomos nga dëmet që po ia bëjnë nga mbipeshat dhe vjetërsia së rrjetit rrugor e tjera.

Mospërmbushja e rregullt gjatë një viti ka për pasojë rritjen e çmimit 50 deri 75% në vitin e ardhshëm si dhe rrezikimi e pjesëmarrësve në komunikacion. Sipas disa studimeve shihet se 8% aksidenteve të trafikut shkaktohen si pasojë e infrastrukturës së dobët rrugore. Sa i përket faktit se në dëmtimin e rrugëve po ndikojnë në masë të madhe ngarkesat, sidomos mbipeshat, dëshiroj të ripërsëris se do të ishte më shumë interes të investohet në hekurudhë. Ndër të tjera dhe përfaktin, se me këtë do të ndikonin që me këtë mjet të transportit hekurudhor do të shkarkonim transportin rrugor. Me transportin hekurudhor do të mund t'i transportimin thëngjillin nga KEK-u në Maqedoni, derivatet e të naftës, zhavorrin, gurët, drutë e të tjera.

Sepse të gjitha këto mbipesha sot po e mbingarkojnë dhe po e dëmtojnë seriozisht infrastrukturën rrugore. Shkalla jo e kënaqshme e zhvillimit të infrastrukturës rrugore, veçmas ajo hekurudhore, në Kosovë do t'i kushtojë shtrenjtë vendit për shkak se nuk mund të përfitojmë nga lidhjet me transportin rajonal dhe atë transevropian.

Kosova ka mbetur jashtë planeve për lidhjen e vendeve të Ballkanit me Evropën me korridore rrugore E 8 dhe E 10, me ç'rast nga këto korridore nuk do të kalojë nëpër Kosovë, prandaj është me rëndësi të posaçme dhe nevojë shumë e ngutshme që Qeveria, përkatësisht Ministria përkatëse të investojë në zhvillimin e infrastrukturës rrugore në nivel të autostradave transballkanike. Për ne është me shumë rëndësi korridori Durës – Kukës, Prishtinë – Merdar. Dëshiroj të ndalem pak dhe te menaxhimi jo i mirë i Ministrisë të Transportit si dhe të neglizhencë e saj sa i përket qasjes për t'u përballur në kohë me situatat emergjente siç ishte rasti me bllokimin e magjistralit Prishtinë – Shkup që i shkaktoi dëme të mëdha ekonomisë së Kosovës. Komuniteti i biznesit ka shprehur shqetësimin duke thënë se humbjet në ekonominë e Kosovës janë të konsiderueshme, përvèç që ka humbje buxheti i Kosovës, ka humbje dogana, kompanitë bizneset etj. Dëmet ekonomike që ka pasur Kosova nga bllokimi i rrugës Prishtinë – Shkup sipas Shërbimit Doganor të UNMIK-ut janë 3.4 milion euro. Përfaktin se Kosova ka humbur shumë nga mbyllja magjistralit Prishtinë – Shkup dhe përfaktin se kjo rrugë është e pasigurt edhe në të ardhmen Qeveria e Kosovës do të duhej të nxirre si prioritet përfundimin e projektit Zhegër – Shurdhan- Stançiq. Hapja e kësaj rruge- një urë si dhe udha për Kumanovë që nga viti 2000 që ka qenë ndër prioritetet kryesore të komunës së Gjilanit. Mendoj se kjo duhet të bëhet me hap më të shpejtuar se Kosovën e ndajnë më pak se 10 km rrugë me Maqedoninë. Ky pra është edhe korridor i shpresës jo vetëm për më se 10 mijë banorë të Grykës së Karadakut, por edhe për Kosovën.

Dëshiroj të potencojoj edhe një projekt të premtuar, qysh në vitin 2000 për asfaltimin e rrugës 7.5 km. Drejkos – Firajë- Brod të komunës së Shtërpçës. Projekti i është dorëzuar ish ministrit Zef Morina, ndërsa në vitin 2001 është shtruar me zhavorr, asfaltimi i kësaj rruge është me shumë interes. Kjo rrugë lidh dy komuna Kaçanikun dhe Shtërpçën, edhe pse kjo rrugë është prioriteti nr. 1 i komunës, komuna nuk ka pasur asnjëherë mundësi buxhetore për një projekt që kushton 600 deri 700 mijë € sipas disa llogarive, prandaj Ministria do duhej ta mbëshreste këtë projekt. Asfaltimi i kësaj rruge do të mundësonë kthimin e banorëve, do të ngritej perspektiva e zhvillimit ekonomik të turizmit, madje

kjo rrugë në një të ardhme më të afërt mund të lidhet edhe me rrugën ndërkufitare për në Qafë Shqipe.

Veçmas dëshiroj të ndalem në infrastrukturën rrugore në Prishtinë, gjendja fare më e mirë si në qytetet e tjera, as edhe në Prishtinë. Shumë rrugë të Prishtinës të cilat edhe pse kohët e fundit janë asfaltuar apo rinojuar, megjithatë nuk janë përfunduar si duhet, ngase në këtë rregullim në shumë rrugë nuk është përfshirë edhe rregullimi i rrjetit të kanalizimeve për pasojë mjafton një shi për t'i vërvshuar rrugët nga ujërat e zeza. Nga ana e tyre qytetarët ankohen se punimet në rregullimin e rrugëve të kryeqendrës sonë po kryhen shumë ngadalë dhe kjo po i pengon në jetën e përditshme dhe u shkakton banorëve vështersi të ndryshme. Ministria sigurisht është e informuar se janë të pakta ato rrugë të cilat nuk janë pranuar teknikisht nga inspektorët komunalë edhe pse cilësia e asfaltit të shtruar në disa rrugë nuk i ka përbushur kriteret e duhura. Disa nga rrugët të cilat janë asfaltuar së fundi nuk i plotësojnë kriteret, por janë pranuar teknikisht nga komuna edhe pse cilësia e asfaltimit nuk i plotëson kriteret e nevojshme e që po manifestohet me pas me shfaqjen e gropave. Gropat dhe çarjet në rrugët gjenden në gjithë qytetin e Prishtinës, gropat gjenden edhe në sheshin kryesor të Prishtinës dhe mund t'i shohë çdokush përditë. Mendoj se ishte ide shumë e qëlluar kur u iniciua nga mediat tona, që ndërmorën iniciativën që gropat më të mëdha të qyteteve tonia të marrin emrat e kryetarëve të komunës. Unë këtu pranë vetes kam vetëm disa fotografi ku shihet një rrugë afër qafës, prapa OSBE-së që ka disa gropë gati gjithë rruga është me gropë. Një gropë e gjatë 4 metra, Në fund mendoj se duhet të përmirësohet cilësia e ndërtimit të rrugëve, duhet të kemi më shumë ente e institute të kontrollimit të kualitetit e këtu nënkuptoherë e tërë infrastruktura, jo vetëm asfalti, ndonëse asfalti është shtresa e fundit dhe ai tregon tërë të metat. Mirëpo është e pafalshme që pas dy ose tre muajsh të riparohen gropat, është koha e fundit që punët të bëhen me cilësi me standardet ndërkombëtare. Ju faleminderit.

KRYETARI- Fjalën e ka deputeti Berat Luzha

DEPUTETI BERAT LUZHA – Ju faleminderit z. kryetar, edhe një herë do të kthehen temës së folur dhe shumë të përfolur për rrugën e Grykës së Kaçanikut. Nuk ka më shumë se dy javë se kryeministri me ministrin dhe me shumë zyrtarë të tjerë. Më në fund me bujë përuroi një rrugë që nuk është rrugë të cilën e quajtën rrugë alternative, kjo rrugë në Grykën e Kaçanikut e gjatë vetëm 1500 metra, e cila kësi soji si është bërë ka mundur të bëhet për tri ditë, edhe kështu si u bë u bë pas katër muajve, por çfarë ndërtimi u bë kësaj rruge një zgjerim i mjerë i saj dhe një shtresë e hollë me gurë dhe në baltë. Kështu si është sot vetëm dy javë pas ndërtimit kjo rrugë është në gjendje të mjerueshme, është gati edhe e pakalueshme edhe për makinat e vogla e lë më për maunë dhe makinat e rënda, kështu si është bërë ajo asnjë herë nuk mund të trajtohet si një rrugë normale dhe me të përdorur si rrugë alternative. Në këtë mënyrë në rast të shembjeve të serishme të dheut në rrugën magjistrale Kosova përsëri mund të mbyllët keq ashtu si është mbyllur gjatë dimërit të kaluar.

Si e dimë rruga magjistrale nëpër Grykën e Kaçanikut, aty ku ka pasur shembje dheut edhe pas dy muajve e gjysmë të hapjes së saj, ende është e irrezikshme për kalim, sepse ende nuk është rehabilituar. Madje ajo është shumë larg nga rehabilitimi i saj i tërësishëm. Qeveria ka planifikuar që rehabilitimin e kodrës dhe të rrugës ta bëjë në afat

deri në tetor të këtij viti. Por aty sot nuk punohet asgjë sikur puna të jetë kryer kaherë. Edhe sa do të kushtojë që kjo rrugë të rehabilitohet në tërësi? Ata të cilët kanë kaluar nëpër këtë rrugë, të cilët kanë udhëtuar për Han të Elezit për Shkup apo më larg, kanë parë se edhe sot kalimi i aksit të rrugës ku është bërë shembja e dheut është i rrezikshëm. Për kalimin e pjesës së rrezikshme edhe më tutje aty non stop kujdestaron policia e cila mban rendin e kalimit njëdrejtimesh. Edhe sa kohë duhet që kjo rrugë të sanohet në tërësi, edhe sa ajo duhet të ruhet nga policia. Këtë nuk e di askush, nuk e di as Qeveria, por ndoshta dikujt po i konvenon që rruga të mos sanohet edhe për një kohë të gjatë ku ta dish. Ashtu siç është hapur rruga pas shembjes në çdo variant ka mundur të hapet por jo më shumë se 10 ditë ashtu si është bërë rruga alternative si thanë kanë mundur të bëhet për tri ditë, atëherë çka ngjau me te. Nëse vërtet rruga magjistrale nuk mund të rehabilitohej shpejtë që është e pabesueshme, pse nuk u ndërtua një rrugë e qëndrueshme alternative që do t'i përballonte sfidave të shembjeve të serishme. Pse nuk u bë asgjë për rehabilitimin e rrugës tjetër alternative asaj që lidh Hanin e Elezit me Qafë Shqipen, e gjatë vetëm 10 km, e cila i shmanget Grykës së Kaçanikut. Kjo rrugë e cila edhe më parë ishte në gjendje të keqe gjatë krizës ka përballuar fluks të madh të makinave, sidomos të kamionëve dhe ka pësuar aq shumë sa tash është bërë e pakalueshme.

Është interesant se Qeveria asnjëherë deri më sot nuk ka dalë me shënimë të sakta se sa i ka kushtuar asaj hapja e rrugës gjatë janarit dhe shkurtit të këtij viti. Dihet se në opinionështë folur dendur në manipulime të ndryshme, madje Qeveria nuk ka bërë ende asnjë analizë se sa i ka kushtuar gjithsej Kosovës myllja e rrugës në dimrin e ashpër të këtij viti?. Se sa ka pësuar ekonomia e brishtë nga kjo katastrofë njerëzore? Se sa e ka penguar ajo biznesin, eksportin etj.

Dhe sikur edhe për rastet e tjera as për këtë dështim Qeveria nuk barti asnjë përgjegjësi, ajo nuk e ka prishur tymin as për humbjet e mëdha të ekonomisë kosovare, as për izolimin e gjatë të një treve të tërë nga pjesa tjetër e Kosovës, as për humbjet e jetëve të njerëzve dhe për asgjë. Fajet nuk i paska Qeveria, fajet i paska natyra dhe vetëm natyra për shkak të lëvizjes së kodrave, kështu del të jetë. Qeveria deri tash ende nuk ka bërë asnjë analizë apo vlerësim profesional për gjendjen e rrugëve në Kosovë, Qeveria nuk ka bërë asgjë për sanimin e tyre kur ato janë në gjendje katastrofike. Qeveria ende nuk ka bërë asgjë që afér 2 vjet për ndërtimin e rrugëve të reja. Qeveria ende nuk ka ndërtuar as ato rrugë për ndërtimin e të cilave njëherë para dy vjetëve, gjatë fushatës zgjedhore është bërë prerja e shiritave. Qeveria ende nuk ka ndërtuar asnjë rrugë të vetme në Kosovë, që nga konstituimi i saj në dhjetor 2004. Qeveria nuk i sheh se si janë bërë rrugët e Kosovës nëpër cilat, për shkak të gjendjes së tyre përditë bëhen ndeshje fatale. Ju faleminderit!

KRYESUESI - Xhavit Haliti Ju faleminderit Z. deputetë, fjalën e ka Sala Berisha Šala, le të përgatitet Bajrush Xhemajli

DEPUTETJA SALA BERISHA - SHALA - I nderuari z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë, z. ministër.

Në fjalën time do të përqendrohem rreth projektit të korridorit rrugor Mërdar-Morinë. Pa u ndalur në rëndësinë ekonomike dhe strategjike të korridore të tillë, që kanë rëndësi

të jashtëzakonshme jo vetëm për razonin, por edhe për vendin. Këtu e kemi një raport të dërguar nga Ministria, ku thuhet, me lejoni të citojë: Projekti i autostradës Mërdar – Morinë ka përfunduar në vitin 2005. Gjatë vitit 2006 janë paraparë aktivitete për projektin e autostradës sikur është fizibiliteti. Mua personalisht nuk më tingëllon as në aspektin profesional aktivitet fizibiliteti. Fizibiliteti nuk është aktivitet, fizibiliteti është më shumë se aktivitet. Fizibiliteti duhet të jetë një studim në të cilin do të përfshiheshin shumë aktivitete. Pra, duhet të jetë një studim që përfshin aktivitetin që ndoshta keni menduar ju të thoni se e kini thënë të kundërtën. Unë, pa e përsëris nga pak folësit e mi rrëth këtij korridori kisha me e pyet Ministrin se sa janë përfillë kriteret për ndërtimin e një projekti të tillë aq të rëndësishëm siç është, do të isha ndalë kriteret i infrastrukturës ligjore. Me sa e dimë ne as 50% nuk janë përfillur gjatë hartimit të këtij projekti, mungojnë shumë ligje, që do ta përbushnin këtë projekt. Mandej, si mund të kryhet projekti pa e ditur sesa do të shpronësohet prona, sa do të kushtojë shpronësimi dhe prona në tërësi.

Dësha t'ua përkujtoj vetëm një rast, rastin e zhvendosjes së banorëve të Hades sa i ka kushtuar dhe sa i kushton Qeverisë, po edhe vetë banorëve ky problem si i tillë. Mandaj, në këtë projekt ka edhe anashkalime të natyrave të ndryshme, natyrës profesionale, shkencore etj. Çdo projekti do të duhej t'i paraprijë studimi dhe analiza shkencore siç janë studimi i fizibilitetit, arsyeshmëria ekonomike, financiare, ambientale etj. dhe mbi bazën e këtyre duhet të kryhet projekti zbatues në tërësi. Këtu është shkelur çdo procedurë e lartcekur dhe është shpallur tenderi për projekt zbatues. Mandej ky tender i jepet një firme gjermane mos ta përmendi shumën që e përmendi edhe z. ministër. Në vend që të përfillen hapat projektues ndodh e kundërtë. Do të kisha bërë një krahasim, fillohet prapsht. Bëhet projekt për kulmin pa e ditur se si do të vijnë themellet dhe katet, d.m.th. kulmi, themellet dhe katet duhet t'i përshtaten kulmit. Edhe në këtë tender shihet se bëhet një propagandë politike se gjoja është kryer një punë e madhe, e vërteta qëndron krejt ndryshe. Këtu është kryer një pjesë e projektit zbatues dhe si i tillë është tepër i gjyqtë. Në këtë gjysmëprojekt mungojnë projektet e veprave të artit, siç quhen në kësot rastesh: ura, tunelet, muret mbrojtëse, muret drenazhuese, kanalet kulluese, mbikalimet, nënkalimet etj.

Lëshimet e tillë, anashkalimet e tillë janë të patolerushme aq më tepër kur dihet se janë dhënë shuma të mëdha me një milion, dy milion e afër tre milion euro, të mos i cek dhe të mos ju mundoj me cent. Nëse tanë është shpallur dhe ende është i hapur tenderi tjetër për këtu të ashtuquajtura veprat e artit siç janë: tunelet, urat e tjera që mund të kushtojnë pasi edhe tenderi i mëparshëm, ndoshta edhe më shume. Edhe ky tender përsëri nuk e zgjidh problemin e projektit Morinë-Mërdar, sepse duhet shpallur tender tjetër për vlerësim ekonomik, vlerësim ekologjik etj. Pra, sipas kësaj logjike qeveritare çdo vit duhet të shpallet nga një tender deri në pafundësi. Pyetja ime për Ministrin është: sa është numri i tenderëve derisa të kompletohet në tërësi projekti. Në mesin e shumë defekteve të tenderit të parë, më shqetësues është edhe fakti se projektuesi nuk ka përfillur asnjë procedurë që do të duhej në raste të tillë, për shembull ndërtohet projekti pa studime gjeologjike, gjeomekanike, hidrologjike etj. Planifikohet që korridori rrugor të kalojë në zonat tepër urbane që janë shumë të kushtueshme për buxhetin e Kosovës dhe për më keq planifikohet që ky korridor të kalojë nëpër vendburime minerale, kjo nuk lejohet në asnjë mënyrë. Pyetja ime është këtu: a janë konsultuar ekspertët ose Ministria gjatë përpilimit të këtij projektit me ekspertët e fushës së minierave, me ekspertët e fushës së planifikimit hapësinor apo ministritë mes veti janë në garë se cila të bëjnë prezantimet ma pompoze siç e kemi sot rastin që është në prezantim tjetër diku në hotel

Grand rrreth planifikimit hapësinor. Është një prezantim tjetër që e bënë Ministria e Energetikës rrreth një dokumentit të politikës së energjisë e pikërisht në një pjesë e minierave që ka bukur rezerva të mëdha të qomyrit i bie ky korridor për të cilin po bëjmë fjalë. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI – Ju faleminderit! Për fjalë është paraqitur Bajrush Xhemajli, në radhë pas tij është Selvije Halimi

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Ju faleminderit z. kryesues, përshëndetje për ju për z. Ministër, për kolegë deputetë

Për gjendjen e mjerueshme menjëherë pas lufte, besoj të gjithë e kemi vetëkuptuar, apo është nënkuptuar ashtu siç edhe në fazën e emergjencës, por tani pas 6 – 7 vjetëve po thuaj një gjendje përafërsisht e njëjtë, nuk ka mundësi që të mirëkuptohet së paku raporti që keni prurë ju z. ministër nuk përkon me realitetin. Mjetet e pakta, është e vërtetë që ka pak mjete dhe për këtë natyrisht që ju kuptojmë; por edhe këto mjete të pakta që janë vërtet janë keqmenagjuar, janë keqpërdorë në mënyrë të tmerrshme, në mënyra të ndryshme. Unë do të mundohem që të them diçka në këtë drejtim edhe pse është pak vështirë që të përmblidhen krejt edhe sigurisht që këto kanë ndikua në kualitetin a po ma mirë të themi në kualitetin tepër të dobët të rrugëve. Për këtë ka ndodhur që është shtruar rruga, parapë është rishtuar apo gropë të njëpasnjëshme etj. pse nuk ka kualitet të rrugëve, ato duhet riparuar vazhdimesht. Unë duhet ta përmend faktin se tenderët qendrorë zgjasin edhe me vite vetëm e vetëm pa e gjetur kompaninë e përshtatshme e jo ato që i plotësojnë kushtet e tenderit, d.m.th nuk është kjo tendencë, por kushtet jashtë tenderit që janë kushtet jashtë më të renda se kushtet e tenderit, qoftë papërshtatshmëria politike, qoftë malverzimi e të ndryshme, manipulimet e ndryshme allishverishet e ndryshme, pra me ata që mundësisht që mundësojnë një bashkëpunim që të shkelet ligji e mos të bëhet shumë zhurmë. Por ka edhe ma keq, njerëzve që nuk jepet tenderi i kompanisë që nuk mund ta kryejë punën me kompetencë, por i jepet firmave unë do t'i quaja fantom firma apo kompani, sidomos atyre jashtë Kosovës që askush nuk e dinë që ekzistojnë, së paku në Kosovë nuk kanë kryer asnjë punë, as kur kanë konkuar, para se të konkurrojnë as pasi që kanë konkuuar. Çfarëdo qoftë pune do të thotë, pikërisht këto firma që nuk ekzistojnë në Kosovë po i marrin tenderët më të rëndësishëm dhe prapëse- prapë punët i kryejnë kompanitë vendore si nënkontraktor dhe këto stërshitje mund të kuptohet se si janë punimet. Për shembull, kompania IDG nga Italia e cila nuk e ka prurë asanje lopatë në Kosovë, kurse ka marrë njërin nga tenderët më të rëndësishëm, më me peshë dhe me cmim përbë 3 milion. Zoti ministër a mban përgjegjësi dikush, që ky projekt në lidhje me aeroportin është, ju besoj e dini mirë nuk është kryer fare dhe që në fillim të punës është ndërprerë dhe pritet të ritenderohet, tash këtu dikush duhet të japë përgjegjësi për një gjë të tillë. Është pritur 3 vjet derisa është tenderuar kjo, tash edhe 3 vjet për ritenderim me siguri do të shkojnë dhe merre me mend se sa përpjekje janë për manipulim, këto tri vjet përpjekje janë, nuk janë 3 dite as 3 muaj. Cilësia sigurisht varet edhe prej mirëmbajtjes. Sipas rregulloreve mirëmbajtja dimërore duhet të fillojë më 15 nëntor dhe të mbarojë më 15 mars dhe të njëjtën datë duhet të fillojë mirëmbajtja verore, kurse në realitet nënshkrimi i kontratave për të dy sezonat e mirëmbajtjes vonohet pa masë për shkak të kalkulimeve për zgjedhjen e punëkryerësit, jo që nuk ka punëkryerës të mirë, por më duhet me e zgjedhë të

përshtatshmin. Në vitin e kaluar në regionin e Prishtinës nuk ka pasur fare mirëmbajtje verore. Si rezultat i kësaj rruge, rruga M9 në Grykën e Llapushnikut është e pakalueshme. Në rajonin e Gjilanit vonohen për një 6 muaj. Në rrugën Prishtinë-Gjilan konkretisht te liqeni i Badovcit për çdo vit kemi deformime në një pjesë të rrugës, gjegjësisht uljen e një pjesë të rrugës edhe për 40 – 50 centimetra, në atë pjesë për çdo vit shpenzohen mjete të shuma. Arsyja është se asnjëherë nuk është marrë ndonjë ekspert seriozisht me këtë problematikë. Askush për këto lëshime nuk besoj që ka dhënë përgjegjësi dhe ka shkuar në ndonjë përgjegjësi ma të lartë. Çështja është, se në mirëmbajtjen e rrugëve ka edhe raste të tilla vërtet ndoshta edhe qesharake. Ata që merren me mirëmbajtjen e kanalizimit puseta ju thohet jo thuhet edhe shahte, e ka marrë tenderin për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve për rajonin e Prishtinës edhe pse vërtet, kanë marrë shumë mirënjojje kompanitë e ndryshme që janë prestigjioze për këtë drejtim, e ka marrë për kanalizim. Llogarite tash. Tash projektet të rrugëve thuhet se nuk vlejnë ose nuk ka fare, e nuk punohet fare në projekte, punohet me një fletë paramasëse, paramasa kuptohet një plan ideor është aty shkon e mat me një veturë ndodh edhe u kryhet hesapi, kaq është e gjatë etj etj. paushall me i thonë me një fjalë tjetër. Pra nuk e kanë vlerën reale në tender që të ndërtohet për një kohë afatgjate, por edhe kjo sigurisht ndikon në cilësi. Për shembull rruga magjistrale Pejë – Kuqishtë si rrugë magjistrale është punuar pa projekt fare dhe është shumë e gjatë, me një fletë paramasës dhe ishtë në vlerën mbi 2 milion edhe pse njëherë është menduar se duhet të ndahen 4 milion. Edhe buxheti i ndarë për rrugën nuk është, nuk ka qenë as gjysma çka më së miri flet për gjendjen e saj të tanishme. Qëllimi ka qenë, thuhet që kemi shtruar një rrugë, cilësia kush e ka kontrolluar aty nuk ka dhënë llogari askush kërkujt edhe për këtë arsy, sigurisht që është kjo që është. Tash në cilësi sigurisht që ndikon se kujt tash t'i jepet tenderi tash, por ka edhe raste qesharake. Lulishtja Labi, e njohim të gjithë që është shume pun kryerëse e mirë për lule, e ka marr për me shtrua asfalt veç nëse z. ministër keni menduar që me bo rrugët lule krejt edhe me i kënaqë, po kërkush nuk shkon në përgjegjësi as kurxho, e tash t'i lëmë këto. Thatë këtu që shumë[ keni punue e krejt këto tjera. Rrugët çdo ditë tregojnë se sa po punohet. Unë e kuptoj veç një, buxheti është shumë i vogël me pas mundësi më shumë: Menaxhimi është i tmerrshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI – Ju faleminderit – Selvije Halimi le të përgatitet Ramadan Kelmendi

DEPUTETJA – SELVIJE HALIMII – I ndeuari kryesues, të ndeuar deputetë z. ministër

Ju e kemi pasur një pyetje shumë konkrete por të vini në interpellancë për gjendjen teknike të rrugëve dhe po qe se shikojmë këtë material me shkrim që na e keni dhënë, më tepër i gjason një planifikimi apo një organizimi të punëve brenda Ministrisë suaj. Edhe pyetjet konkrete që ju bënë këtu nga shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së ishin me një përgjigje aq të përgjithësuar saqë mua më le përshtypje, po më vjen keq, por duhet ta them atë çka e ndiej se nuk e keni të qartë pozicionin tuaj si ministër që e mbanë.

Ju thatë se taksa e paguar për rrugë shkon në buxhetin e Kosovës e jo për mirëmbajtjen e rrugës. Kosova ka vetëm një buxhet. Pastaj, ato mjete duhet të planifikohen në mënyrë që të destinohen sipas planit. Sa plane i keni bërë ju apo para kësaj pyetje a e dini numrin – shifrën e të hyrave nga kjo taksë me rastin e regjistrimit të automjeteve. Sa plane i keni bërë që për mirëmbajtjen e rrugëve apo edhe rrugë të reja që do të mund të realizoheshin

nga kjo taksë. Nëse po atëherë na tregoni cilat janë? Te rruga Prishtinë –Shkup, sipas ekspertëve tuaj thatë se u shemb dheu për shkak të eksplotimit të keq dhe shembjes dhe ujërave sipërfaqësor që kanë ndikuar në shembjen e dheut. Kam thënë në seancën e parë të këtij Kuvendi në vitin 2005 dhe e them edhe sot nuk kemi harmonizim të prioriteteve. Ujërat sipërfaqësore dhe eksplotimi janë në menaxhimin e Ministrisë të Planifikimit Hapësinor. A keni bashkëpunuar ndonjëherë që të keni një pamje sipërfaqësore se sa mund të jenë të dëmshme këto eksplotime dhe sa do të kishit mund që të ndikoni që ujërat sipërfaqësore të mos shkaktojnë shembje të dheut dhe mbylljen e rrugëve. Nga kjo mbyllje e rrugës, sipas një raporti të paraqitur në dy ditët e fundit nga Ministria e Financave thuhet se vetëm për tremujorin e parë ka humbje afér 10% të buxhetit të planifikuar të Kosovës? A keni menduar se si do të sigurohet kjo humbje në të ardhmen apo, ndoshta do të presim si projektet e shumë ministritive se cili projekt do të jetë viktivë e shkurttimeve buxhetore, në mënyrë që të mbulohet kjo humbje. Z. ministër unë ju pyes: se çka keni ndërmarrë që ta bëni sigurimin e urës së parë në aktin rrugor Prishtinë-Besjanë në Bardhosh. Aty është një urë që është me rrezik potencial, a duhet të presim që të shembet ajo apo të shkaktohet traumë psikike te popullata kur kalojnë andej dhe e shohin se ura po mbahet me drunj. Këtu u pa një reagim i deputetëve kur një prej kolegëve foli për rrugët në kryeqytetin e Prishtinës, është një dukuri që duhet ta pranojmë. Hapja e gropave bëhet pikërisht në distancat prej gropës së parë ku është mbyllur deri në 20 metra, d.m.th. nuk hapen gropat të reja në vëndet ku nuk ka pasur sanime apo renovime, por hapen për afér apo në të njëjtin vend ku është bërë renovimi. Kjo të jep me kuptuar se këto kompani që bëjnë mirëmbajtjen e rrugëve, a e kanë si obligim të parashkruar që çdo sanim i rrugës të qëndrojë vetëm 6 muaj. Për këtë dua përgjigje nga ju z. Ministër. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI - fjalën e ka Ramadan Kelmendi, le të përgatitet Xhevati Bislimi

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Të faleminderit kryesues, i nderuari kryesues, i nderuari ministër, të nderuar të pranishëm deputetë  
Mendoj se duke u bazuar në pikën 6 të aprovuar nga një interpellancë lidhur me gjendjen në rrugëve, sa e kemi tejkaluar se bukur shumë ju kemi shhangur qëllimit të rendit të ditës, por ajo është çështje që deputeti mund të shpreh mendimin e vet.  
Unë mendoj se fillimi shqyrtimin dhe aprovimin e ligjeve dhe në veçanti kur kemi bërë aprovimin, gjegjësisht shqyrtimin e Ligjit mbi rrugët ne kemi bërë lëshimet e para dhe nuk kemi përcaktuar kompetencat dhe të drejta e Ministrisë dhe në veçanti me taksën e regjistrimit të automjeteve. Pra, sot shumëçka mund të diskutojmë, por nuk mund ta orientojmë pa e bërë këtë përmirësim. Duke shfrytëzuar edhe unë këtë të drejtë do të shtroja dy kërkesa, cila prej tyre pak a shumë dallohet që këtu u prezantuan, sepse gjendja e rrugëve është e vështirë, baza materiale e ulët e tjera e tjera. Nuk di sa këta deputetë dhe Qeveria jemi të informuar, është një aks rrugor Mitrovicë-Zveçan-Leposaviq, i cili është i mbyllur për shqiptarë dhe andej mund të kalohet shumë rrallë ku janë pjesa perëndimore e rajonit të Shalës së mbyllur. Është bërë përpjekje të bëhet një rrugë fshati e cila do ta lidhte atë rajon duke filluar prej fshatrave Magjerë, Dedi, Bistricë dhe Cerajë. Do të ishte mirë të punohet në atë drejtim sepse do t'i ndihmohet asaj popullate në rrëthanat ekzistuese të ketë lidhje me qytetin e Mitrovicës dhe me Kosovën, pa ndonjë frikë dhe pa përcjellje, të cilat janë shumë të rralla dhe

javore. E dyta, është mbyllur aksi rrugor që shpie në kompleksin e kullave të Isa Boletinit nga kisha ortodokse në një mënyrë të njëanshme dhe pa pëlqimin dhe pa nënshkrimin e familjeve të Isa Buletinit. Ai kompleks nuk mund të funksionalizohet, do të ishte mirë të gjithë ata që e kemi ndikim dhe ne si organ më i lartë të bëjmë diçka në këtë drejtim, sepse po bëhen 15 muaj dhe rrinë varret e hapura dhe nuk bëhet rivarimi i heroit tonë kombëtar Isa Buletini me luftëtarët e tij, edhe pse është krye i tërë projekti, por fle ky projekt për një rrugë prej 2 kilometrave. Ju faleminderit!

#### KRYESUESI – Xhevati Bislimi le te përgatitet Gjylnaze Sala – atëherë Gjylnaze e ke fjalën

Ju faleminderit z. kryesues, unë mendova se do të ma jepni pak më herët fjalën, sepse desha me kërkua zbatimin e Rregullores 25 që ka, gjegjësisht rregullës 25, që është pika 8 ku shumë mirë është përcaktuar si zhvillohet 1 debati për interpelancën. Thuhet se deputetët kanë të drejtë të diskutojnë lidhur me çështjen e shtruar në interpelancë në pajtim me dispozitat e Rregullores së punës. Kjo përcakton që nuk duhet me dalë jashtë lëndës së shtruar që ka të bëjë me interpelancën. Tani z. ministër faleminderit përgjigjën tuaj dhe gatishmërinë që të përgjigjeni.

E kam lexuar me shumë vëmendje dokumentin që e keni dërguar dhe e kam një propozim për Ministrinë, duke lexuar me kujdes. Është e qartë që rrugët lokale dhe urbane nuk janë në kompetencën tuaj dhe ju nuk mundeni të përgjigjeni për atë që nuk është nën kompetencën tuaj. Thënë çështja e rrugëve të Prishtinës dhe të qyteteve nuk është në kompetencën e Ministrit të tuaj, por sa i përket autostradave mendoj që Ministria duhet të jetë më këmngulëse dhe më konkurrente në projektet që ekzistojnë dhe në institucionet ndërkombëtare sidomos ato evropiane siç është Banka investive dhe pra Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim por edhe Banka botërore ashtu që të konkurroni dhe t'i fitoni projektet, meqë nuk kemi fond të mjaftueshëm për ndërtimin e rrugëve. Kjo natyrisht do të ndihmonte shumë edhe zhvillimin ekonomik, sepse shpresojmë se do të kemi edhe investime të huaja dhe është e natyrshme që rrugët për zhvillimin e ekonomisë duhen të jenë të mira, gjegjësisht një infrastrukturë rrugore e zhvilluar. Ju faleminderit!

KRYESUESI – Ju faleminderit zonja Syla Duhet t'jua përkujtojë, që gjithçka që ka të bëjë me rrugët në Kosovë deputetët kanë të drejtë me diskutua dhe me Rregullore dihet çka u ndalohet deputetëve. Unë nuk mundem me ja imponua askujt çka diskuton për rrugët, kohën po është 10 minuta të lutem, jo kohën – hapësira kohore z. Hamiti e di je anëtar i Kryesisë, 10 minuta i ka secili deputet me diskue në debat dhe secili deputet që është në këtë sallë është i barabartë me tjetrin. Unë nuk mund me ia kufizue askujt të drejtën me folë.

Të lutem, fjalën e ka Behxhet Brajshori, le të përgatitet Gjergj Deaj

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Ju faleminderit z. kryesues, i nderuar ministër, të nderuar deputetë

Unë përshëndes gatishmërinë e ministrit që të japë përgjigje për interpelancën e sotme dhe materialin që na e ka ofruar unë nuk do ta komentoj materialin, por do të kthehem nga e ardhmja, çka në të vërtet mund të bëjmë në këtë drejtim bashkërisht të gjithë diçka

e mori në fjalën e saj deputetja Syla, por mendoj se nuk është e tëra. Thjesht është një obligim i tërësishëm i Ministrisë që të mbërrijë gjithçka atë që e dëshirojmë të gjithë ne infrastrukturën rrugore sot është e pamundshme, sepse mungojnë fondet. Nuk është po ashtu e tëra përgjegjësi veç e Qeverisë, sepse jemi edhe ne këtu si Kuvend për t'i shtuar politikat zhvillimore të vendit natyrisht përmes Qeverisë e cila do t'i prezantonte në Kuvend dhe mundësitë e financimit në këtë rast infrastrukturës rrugore në Kosovë Padyshim se zhvillimi ekonomik i vendit është tepër ngushtë i lidhur me infrastrukturën rrugore si infrastrukturë. Në këtë drejtim duhet të bëjmë gjithçka çka është e mundur që të krijojmë kushte në këtë drejtim. Unë do të propozoja dy-tri masa do të thosha të shohim bashkërisht a thua çka mund të bëjmë brenda në Kosovë, pra edhe si strategji e Ministrisë që ka përmendur mundësinë e krijimit të një fondi të rrugëve, por natyrisht në harmoni me legjislacionin që e kemi në Kosovë, gjithnjë duke pasur parasysh atë, dhe kërkësën tjetër për institucione financiare ndërkombëtare. Pakti i Stabilitetit nuk duhet ta tejkalojë Kosovën sa i përket infrastrukturës, është shumë e vërtet se prioritet i Paktit të stabilitetit dhe projektet që realizon Pakti i Stabilitetit kanë të bëjnë me një infrastrukturën. Do të ishte një kërkësë e të gjitha institucioneve financiare ndërkombëtare që të kthejnë kokën në këtë kuptim nga Kosova dhe të realizojnë programe në Kosovë, natyrisht duke pasur parasysh edhe gatishmérinë tonë në këtë drejtim se vërtet ofrojnë projekte të qarta dhe ata do t'i merrnin si prioritete. Kjo do të bënte të mundur që vërtetë, që sa më shpejtë të arrijmë hapin e zhvillimit ekonomik dhe të mos anashkalohet Kosova, qoftë edhe në një transit rrugor, por që vërtet Kosova të shfrytëzohet si vend si infrastrukturë rrugore prej ku do të lidheshin shumë vende ndërmjet veti në kuptim të komunikacionit dhe të zhvillimit sa më të shpejtë, pra në përgjithësi të ekonomisë në vend dhe të Ballkanit Perëndimor. Kjo do të ishte diçka që vërtet ne do të na ndihmonte, me qëllim që këtë buxhet të vogël, të cilin e kemi vështirë, por e kemi kur po vjen radha që ta përimtojmë në shumë sektorë dhe prioritete, natyrisht se janë të nevojshme, por gjithmonë duhet bërë prioritete brenda prioriteteve që janë karakteristike e vendeve jo mjaf të zhvilluara sikur që është Kosova. Ne si vend duhet vëmë prioritete dhe mendoj se infrastruktura rrugore ka prioritetin e vet dhe në të ardhmen edhe buxheti brenda mundësive të veta të ketë parasysh nevojat për investim në infrastrukturën rrugore. Ju faleminderit !

KRYESUESI – Ju faleminderit! – Fjalën e ka deputeti Gjergj Deda, le të përgatitet Gjelal Canziba

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ - Ju faleminderit z. kryesues - unë nuk jam ekspert për rrugë, por lëvizzi shpesh nëpër Kosovë, që shumë rrugë nëpër Kosovë .Nuk është e tepërt të themi se tash e mbas, ndoshta mundemi të kalojmë vetëm me traktorë ose këmbë, për shkak të dëmeve evidente, Mendoj se për këtë duhet të jetë e shqetësuar dhe e preokupuar Ministria në fjalë dhe vet ministri, por kisha dashur të më lejohet pak, sepse ne deputetët si po dalim pak jashtë teme thuajse jemi në shkollë filllore për me na shkrue te shpija e na me lexua këtu. Mendoj se duhet të na lejohet që, d.m.th t'i themi edhe mendimet dhe shqetësimet tona dhe të dalim prej uniformave dhe prej disa shprehive tashmë të së kaluara moniste dhe të shprehim lirshëm shqetësimet dhe preokupimet tona. Para disa muajsh u rrëzua një aeroplan i ushtarëve sllovakë të cilët ktheheshin nga Kosova nga misioni në Kosovë dhe konstatimi ishte se aeroplani u rrëzua për shkak të

fajit të pilotëve, por ne e dimë se ministri i Sllovakisë i Komunikacionit edhe pse ishin fajtorë pilotët ai dha dorëheqje. Kam një përshtypje edhe kisha pasur dëshirë ta pyes ministrin a i ka shprehur ngushëllime ndonjë familjeje në Kosovë, të cilave u kanë vdekur djemtë, si pasojë e gropave, rrugëve të dëmtuara dhe e lëvizjes nëpër rrugë të Kosovës. Më kujtohet para disa muajsh ,po ashtu, në Fushë Kosovë u dogjën, përmungesë të energjisë elektrike 5 anëtarë të familjes Tatari, ashkalijë dhe nuk u dha asnjë përgjegjësi nga Ministria për Energetikë. Ju lutem nëse ka mundësi me mbajt qetësi, nëse nuk ju dëgjohet mundeni me dalë përjashta, kush nuk ka durim me dëgjua, lirisht mund me dalë me shëtitë. Këtu është edhe bufeja nja andej e një këndeje prapa, kështu që desha me e kërkue deri kur do të jemi të pandërgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm që të mos japim llogari, të mos na brejë ndërgjegjja për lëshimet që janë evidente në Qeverinë e Kosovës dhe kur do të fillojë një ministër i Qeverisë të Kosovës të japë një herë dorëheqje për shkak të këtyre gabimeve, dëmtimeve, përgjegjësive edhe lëshimeve që bëhen çdo ditë në Qeverinë e Kosovës. Ju faleminderit !

KRYESUESI – Ju faleminderit z. deputet – fjalën e ka Xhelal Canziba le të përgatitet Gani Koci.

DEPUTETI XHELAL CANZIBA - Inderuar z. kryesues, inderuar ministër dhe ju kolegë deputetë

Pëkundër disa rindërtimeve të vogla, rrjeti ekzistues i rrugëve është përgjithësisht në gjendje të vështirë. Mjafton t'ua hedhesh një shikim rrugëve magjistrale të Kosovës dhe vjen në përfundime se ato tash janë bërë një fyt i ngushtë për nevoja të mëdha të transportit të njerëzve dhe të mallrave. Një zhvillim i mirëfilltë ekonomik, pa rrugë të reja e moderne, është i pamundur.

Kosova nuk mund të jetë pjesë integrale e rajonit nëse në të ardhmen e afërt nuk zgjidhet çështja e transportit rrugor dhe e atij hekurudhor. Për më shumë Kosova nuk mund të llogarisë në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik nëse në vitet që vijnë nuk bëhen investime kapitale në përmirësimin dhe zgjerimin e kapacitete të rrjetit rrugor. Gjendja aktuale është e pavolitshme .Sikur t'i hidhnik një shikim hartës rrugore evropiane mund të vëreni se Kosova nuk është pjesë e asnjë rrjeti të rëndësishëm ndërkombëtar rrugor apo hekurudhor. Kjo gjendje duhet të ndryshohet, jo vetëm me ndërtimin e autostradës, por edhe nëpërmjet modernizimit të rrjetit të brendshëm rrugor si dhe me modernizimin, elektrifikimin e hekurudhave kosovare. Sot infrastruktura e dobët rrugore nuk ka kapacitete të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit, gjë që u dëshmua me problemet e paraqitura pas mbylljes së rrugës Prishtinë – Shkup. Njëherësh kjo gjendje, në të cilën ndodhen sot rrugët dhe hekurudhat kosovare e izolojnë Kosovën nga vendet e rajonit dhe e bëjnë më pak atraktive për investitorët e huaj. Perspektivën e gjatë të integrimit të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në mes strukturave evroatlantike duhet të krijojë bazën e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të rajonit. Kosova duhet të ketë një trajtim të veçantë posaçërisht kur është fjalë për realizimin e projekteve të rëndësisë së lartë siç janë projektet e modernizimit të infrastrukturës. Të njëjtën kohë i kam edhe dy pyetje për

ministrin është bërë renovimi i rrugës që lidh Prizrenin-Gjakovën ,me rrugën që i lidh fshatrat :Malësi e Vogël dhe Ratkoc. 15 ditë ka qëndrua e pas 15 ditëve ka qenë në gjendje të njëjtë? E pyes edhe një pyetje ministrin për lidhmërinë mes Rahovecit dhe Therandës, kanë kufi të përbashkët, nuk kanë rrugë të përbashkët. 10 km. rrugë janë të asfaltuara në Rahovec, 4 në Therandë, 4 janë pa asfaltuara, që do thotë një qytetar i Rahovecit të shkoj në Therandë duhet t'i kalojë 50% km nëpërmjet Prizrenit për të arritur në Therandë , ku ka mundësi me mbërrit për 18 km. Ju faleminderit?

**KRYESUESI** – Ju faleminderit! Deputeti Gani Koci le të përgatitet deputeti Sabri Hamiti

**DEPUTETI GANI KOçi** – Ju faleminderit z. kryesues. Nuk e kisha ndërmend të marr pjesë në këtë debat. A mund t'ia filloj apo po do të vazhdoni ju. z. kryesues dialogun me. Ju faleminderit.

Nuk e kisha ndërmend të diskutoj sot as të marr pjesë fare në këtë debat, po sikur më nxitën disa diskutime të deputetëve rrëth interpretimit të Rregullores të punës të Kuvendit. Unë përgëzoj administratën e Kuvendit që na e ka bërë një broshurë të tillë përkëtë rregullore se vetëm tash kemi filluar ta lexojmë, se deri tash nuk e kemi lexuar edhe pse ka ekzistuar si rregullore dhe nuk do të ndalem as të flas profesionalisht për çështjen e rrugëve, sepse nuk është faji im, nuk është fushë imja.

Unë ,shkurt, do të bëjë disa pyetje për z. ministër edhe pyetje shumë të qarta dhe shumë të thjeshta. Nuk do të hyjë në 2005 çka ka ndodhur me buxhetin, kemi raportet dhe sigurisht do të diskutohet, por përkëtë viti, vitin 2006, ju keni pasur afér 8 milion € në linjën ose në vijën buxhetore për mirëmbajtje të rrugëve. Do të dëshiroja të di nga kjo pjesë e fondit , sa keni harxhuar dhe sa gropë i keni mbyllur në rrugët që janë kompetencë juaj, thjeshtë sa gropë i keni mbyllur 3, 4 e 5 nëse është vështirë që është numër i madh atëherë sa metra rrugë keni mirëmbajt gjatë këtij sezoni, nëse edhe kjo ju vjen pak vështirë se mund të dalin metra shumë, atëherë sa kilometra, Çështja tjetër, them se dua ta përgëzoj z. ministër, kërkoj që në një farë mënyre të korruptohej, kërkojë një kafe prej meje se është realizua projekti dhe se do të fillojë realizimi i projektit të rrugës Vushtri - Skenderaj në një pjesë të tij dhe tha së shpejti do ta presim shiritin, Unë i thashë se unë nuk i besoj prerjes së shiritit, sepse kemi shumë rrugë në të cilat është prerë shiriti sa e sa herë. E keni rrugën Skenderaj – Klinë , gati në dy mandatet e Qeverisë, por unë i besoj asfaltit kur të shkel në të dhe ministri do ta ketë kafenë prej meje në momentin që unë shkel në asfalt të rrugës Vushtri -Skenderaj.

**KRYESUESI** – Ju faleminderit! Deputeti Sabri Hamiti, besoj se Xhevati Bislimi është përgatitur, tash është pas tij..

**DEPUTETI SABRI HAMITI** - Ju faleminderit z. kryesues. Unë nuk do të flas asnjë fjalë përrrugë, unë veç desha të flas, që kur kërkohet të zbatohet Rregullorja është sjellja më parlamentare që mund të ekzistojë. Nëse zbatohet Rregullorja kjo interpellancë as nuk

do të zgjaste kaq shumë as nuk do të përsëritheshin sendet që u përsëritën disa here dhe as që do të kalohej përtej temës. Në të gjitha parlamentet shumë ma demokratike se te ne një interpelance ma shume se një orë nuk zgjatë kurrë. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI – Ju faleminderit! Unë e di që secili deputet ka të drejtë të diskutojë 10 minuta dhe kjo shkruan në Rregullore, 10 minuta. Temën, Parlament është ky, unë nuk mund me ua nda, as nuk kom mi notu, as ti as kërkush. Xhevati Bislimi

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryesues, kolegë deputetë. z. ministër – më shumë se të gjithë deputetët e këtij Kuvendit flasin vetë rrugët e Kosovës, flasin gropat e këtyre rrugëve, falsin aksidentet e përditshme, falsin viktimat e shumta që ndodhin për shkak të gjendjes tepër të keqe të këtyre rrugëve në Kosovë. Gjendja më e mirë e rrugëve nuk është as në komunën e Vitisë, nga e cila komunë unë vij. Qeveria ka bërë disa investime, por megjithatë rrugët që janë ndërtuar në këtë komunë janë të cilësisë tepër të dobët, mbyllja e shpeshtë e gropave nuk ka qëndruar ma shumë se 6 muaj, një dimër dhe kur vjen pranvera gropat prapë janë të hapura, rrugët pothuajse të pakalueshme. Këtu dikush është fajtor për gjendjen e rrugëve në Kosovë, e bëri buxhetin. Unë dua-t'ia kujtoj kolegut ose koleges dhe qytetarëve të Kosovës se buxhetin nuk e ka miratuar as propozuar opozita, por koalicioni qeverisës, i cili nuk mori parasysh vërejtjet që ne opozita patëm bërë për këtë buxhet. Kërkosat tona që të ndahen më shumë para për mirëmbajtjen e rrugëve, më shumë para për shëndetësi, më shumë para për arsimin, ma shumë para për nevojat e qytetarëve dhe më pak para për luksin e Qeverisë dhe të qeveritarëve. Prandaj, mos u thirri shumë në dobësitë e buxhetit, në planifikimin e buxhetit, sepse vetë e propozuar dhe vetë e miratuar. Taksa rrugore këtu dikush nxori Ligjin si pengesë për shpenzimin e kësaj takse rrugore për mirëmbajtjen e rrugëve. Unë mendoj se këtu nuk duhet të ketë pengesa, ministri dhe Qeveria mund ta propozojnë korrigimin e ligjit, nuk është dojë gjë e madhe dhe taksa rrugore vërtetë të shfrytëzohet për mirëmbajtjen e rrugëve, dhe kjo mund të bëhet fare lehët, mos u arsyeton me ato pengesa. Për gjendjen e rrugëve dihet. Përgjegjëse është Ministria e Transportit dhe qeverisja vendore për rrugët që dihen. Prandaj, ne Kuvendi i Kosovës dhe ne kuvendarët kërkojmë nga Qeveria, që të ofrojë planet e veta, ambicjet e veta, përpjekjet e veta se si do të dal nga kjo gjendje Kosova dhe rrugët e saj apo edhe kjo ministri si ministritë e tjera si vetë Qeveria do të jetë e dështuar në mirëmbajtjen, ndërtimin dhe rregullimin e mugëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI – Ju faleminderit! Bislim Hoti është lajmëruar për fjalë dhe pas tij Xhavit Haliti

DEPUTETI – BISLIM HOTI – Ju faleminderit z. kryesues, përshëndetje për ministrin i cili iu ka përgjegjës interpelancës. Unë nuk do të jem i zgjatur shumë. Kam një kërkosë dhe dy pyetje.

Meqë u fol shumë për rrugët dhe gropat në rrugë, unë do ta lusja ministrin që të paktën më s'i vejë rëndësi gropave, por disa bunar që janë hapur në rrugë, sepse udhëtoj çdo ditë Gjakovë – Prishtinë dhe shohë që vërtetë disa gropa kanë kaluar në bunar, si kanë mundësi që ato të paktën të mbyllen. Kërkosa e parë kishte me qenë çfarë po bëhet me

kombibusët në të gjitha qytetet e Kosovës, të cilat me të vërtetë janë problemi kryesor në komunikacion? Kurse kërkesa që dua ta bëjë prej nga vijë unë nga Gjakova e sa jeni në dijeni se çfarë po bëhet me aeropordin në Gjakovë, aktivizimi i tij që ka pasur të aktivizohet në vitin 2003, unë kërkoj për këtë pyetje, nëse nuk jeni në gjendje të përgjigjeni tani, kërkoj nga ju që së shpejti, të paktën të na e dërgoni me shkrim. Ju faleminderit!

DEPUTETI XHEVAT HALITI - z. Ministër unë sikur të gjithë kolegët e mi jam i shqetësuar vërtet përrugë, por desha ta trajtoj një problem pak ma ndryshe, sepse nuk është qëllimi me e vu ministrin para gjyqit, sepse e përgëzoj përrugën e tij dhe e përgëzoj, sepse është një ndër ministrat që më së paku është përpjekur të paraqitet para mediave për ta lavdëruara veten dhe Ministrinë e tij. Nuk kam informata shumë se sa ka punuar, por do të dëshiroja sa kilometra rrugë janë ndërtuar në mandatin e tij si ministër. E di që gropat dhe ky i përjeton se është ndër ministrat e vetëm që e kam pa me makinë të tij personale në familje, një makinë të vogël, por krahas kësaj do të dëshiroja që edhe nga ministri të di a është bërë ndonjë kontroll për investimet në rrugë në Qeverinë e kaluar, a janë shkelje dhe keqpërdorime të buxhetit nga Ministria në Qeverinë e kaluar dhe në qoftë se po, atëherë a keni ngritur padi penale në prokurori. Po ta them këtë, sepse që do të vijë pas teje mendoj se e ka këtë detyrë para se t'i fillojë punës që të kontrollojë se ku ka mbetur Ministria, sepse nuk është personale as Ministria dhe as Buxheti i Kosovës. A keni konstatuar gjatë këtij mandati shkelje ligjore në Ministrinë tuaj dhe shkelje ligjore në dhënien e tenderëve nga Drejtoria e Rrugëve, apo kush i jep tenderët, qoftë për meremetimet e rrugëve, qoftë për ndërtimin e akseve të rrugëve të reja. Një çështje tjeter, të cilën desha ta them është se ne i kemi miratuar tri ligje deri me tash përrugët. Ligji përrugët që u miratua në nëntor të vitit 2003; Ligji për transportin rrugor që është miratuar në vitin 2004 dhe Ligji për transportin e mallrave të rrezikshme që është miratuar në vitin 2004, d.m.th nga mandatimi i Qeverisë aktuale ne nuk kemi miratuar dhe nuk kemi në dispozicion, nuk na është vënë në dispozicion asnjë ligj tjetër. Pyetja ime është në cilën fazë është përgatitja e Ligjit për siguri në rrugë dhe a është duke u hartuar në përputhshmëri me Kartën e Unionit Evropian për sigurinë rrugore? Dy, në vebfaqen e Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, shihet qartë se a keni aktivitet apo jo, sepse për atë punë është edhe kjo vebfaqe. Në anën e majtë të saj është një rubrikë që shkruan për aktivitetet dhe kjo faqe është fare e zbrazët. Si qytetar, si deputet dhe konform domosdoshmërisë për zbatimin e Ligjit për transparencën nuk ka asnjë shënim. Kisha pasur dëshirë që ju sot, sepse e di se në kuadër të pyetjeve që i kemi shtruar, me siguri se nuk keni mund të përgatiteni përsot të përgjigjeni, por në të ardhmen të përgatitni përgjigje përsot ne deputetët, përsot qytetarët e Kosovës, lidhur me transparencën e buxhetit që është ndarë përrugët në Kosovë, që nënkupton këtë buxhetin që është ndarë përrugët në vitin 2006 dhe do të kërkoja, prapë po them se shumë çështje që u ngriten këtu mbështetët nuk janë edhe kompetencë juaj, por këtu ndërlidhen si Ministria dhe ministri domosdoshmërisë do të ndërlidheni në Qeveri dhe në Ministrinë e Financave. Është e drejtë e deputetëve të kërkojnë veçanërisht përsot zonat e tyre. Edhe unë e kam një problem me zonën nga vij, qytetarët kanë ndarë një buxhet, kanë grumbulluar të hollat me kërkësë të Kuvendit komunal që ta bëjnë një rrugë që liddh magjistralin Pejë-Mitrovicë dhe Pejë - Rozhajë dhe lidh disa vendbanime – rrugë e cila del shkurt nga fshati Fierzë në Banjë të Pejës përmes fshatit Dubovë dhe kam përshtypje që këto të holla me urdhër të Qeverisë janë tërhequr përrugët në vitin 2007. A është

kjo ide që këto të holla të jepen në vitin kur fillon fushata zgjedhore për zgjedhjet apo ka pasur të holla dhe pse u janë kërkuar fshatarëve që t'i grumbullojnë dhe pastaj të térhiqen. Ju faleminderit!

**KRYESUESI** – Tani po prcodojmë. Deri tash nuk ka pasur të paraqitur të tjera. Ibush Jonuzi u paraqit tash. A ki, a do me diskutua. Veç para se të diskutoni nuk kisha pasur dëshirë që të krijohet pakënaqësi as me udhëheqjen e seancës. Na e kemi një rregullore, të gjithë ne si deputetë i kemi pasur nga 10 minuta me diskutua dhe me dhënë mendime, me ia përmendur gabimet, me e sulmua Ministrinë, me lavdërua të gjitha ato që kemi pasur interes, sipas Rregullores. Pas fjalës së ministrit në qoftë se ministri nuk e përmend dikë me emër dhe nuk e fyeni askë, nuk ka më diskutime, përvëç kërkuesit të interpelancës që nënkupton kryetarit të Grupit parlamentar ose në emër të Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës kush do të flas Kisha pasur dëshirë që mos të krijohet një situatë që si në seancën e kaluar në debat kur vërtet nuk pat nevojë me reagua, sepse keni pasur, ju përgëzoj të gjithëve, sepse askush nuk e ka kaluar më shumë se 7 minuta gjatë kësaj seance dhe në seancën e kaluar shumica kanë kërkuar me ju zgjatë. z. Ibush me fal, vazhdoni

**DEPUTETI IBUSH JONUZI** - Ju faleminderit z. kryesues, i nderuari ministër, ju përshëndes të gjithëve. Nuk e kisha ndërmend të diskutoj, por pyetjen që ju ia shtruat ministrit për çështje të Projektligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor, mendoj sa me përket mua që të përgjigjem si kryetar i Komisionit përkatës, Projektligi është miratuar në parim me 16 mars është një Projektlig shumë i rëndësishëm, po megjithatë është voluminoz prej 376 nenesh. Unë së bashku me zëvendëskryetarin kemi shkuar te Kryetari i Parlamentit ia kemi shtruar si çështja me rëndësi, por njëkohësisht duhet të punohet me shumë kujdes dhe kemi kërkuar të shtyhet afati për disa ditë, sepse afati i përfundimit do të thotë skadon me 16 të këtij muaji dhe kemi marrë miratimin prej kryetarit të Parlamentit të punojmë. Është formuar një nënkomision dhe me ekspertë të jashtëm dhe besoj se projektligli duhet të jetë së shpejti në Parlament. Ju faleminderit!

**KRZESUESI** – z. Ministër, në përputhje me Rregulloren e keni fjalën, nuk keni kufizim, përgjigjuni pyetjeve që i kanë bërë deputetët. Ju faleminderit!

**QEMAJL AHMETI MINISTËR** – Unë para se të filloj t'u përgjigjem i falënderoj të gjithë deputetët pa dallim si ata, që më kanë përkrahur në një mënyrë ose kanë sugjerime. Unë sinqerisht edhe një here ju falënderoj shumë për këto pyetje se me këto quartësohen shumë punë që po kryhen dhe që nuk janë kryer e që duhet të kryhen. Prandaj, unë jam i hapur edhe më tutje derisa të gjendem në këtë pozicion, përgjegjësitë i kam të bashkëpunoj me deputetët dhe e keni derën hapur në kuptimin deputetë individual për informatat që ju interesojnë, përrugët, mund të vini të bashkëbisedojmë dhe të bëjmë zgjidhje. Është vështirë pak sa të përgjigjem radhas meqë kemi të bëjmë me një numër prej 25 sa kam mundur t'i evidentoj. Do të mundohem nëse, kaloj në një pyetje ma sugjeroni ndërkohë ata që e kanë parashtuar pyetjen.

Është e vërtet që një numër i pyetjeve kanë tejkaluar përgjegjësitë dhe kompetencat që i kam unë si ministër. Këto dy po i paraqes në fillim.

Çështja e hekurudhave dhe avacionit civil është kompetencë ekskluzive e rezervuar e pushtetit të PSSP-së, kështu që unë nuk kisha dashur të përgjigjen në këto.

Po filloj me pyetje. Ishte një konstatim se ka pasur pak aktivitete në Ministrinë e Transportit. Çështja e REBIS-it. REBIS-i më nuk ekziston. Është myllur në vitin 2004, d.m.th. aktivitet sa ka qenë Ministria e angazhuar ajo ka qenë në ministri.

Një numër i pyetjeve e tejkalon fazën prej kur unë jam ministër deri tash. Nëse doni që të përgjigjem për ato pyetje, atëherë e tejkalojnë çdo gjë, sepse ka shumë projekte që u përmenden këtu, këto janë projekte të kohës para 3 dhjetorit 2004. Po mund të jap një përgjigje juve rrith taksës që është marrë prej Valës 900 dhe është destinuar për projekte kapitale në Njësinë e Transportit. Ajo taksë ka qenë në vlerë prej 6.9 milion €, për atë shumë janë paraparë 9 projekte, prej atyre 9 projekteve 8 projekte kanë dalë në tender. Janë kryer shumica e procesit të tenderimit- procedurat unë mud të ju citojë, ka qenë rruga lokale 28 Mramur, Klinë Skenderaj, pjesa dytë është pyetja veç që është bërë Pantinë –Frashë; Zhegër –Shurdhan; Drenas – Gradicë; Kamenicë – Busovatë; rruga Batushë-Koshare; Tugjec-Hajkobillë.

Në kërkesat e Ministrisë ka qenë edhe rruga Vushtrri-Skenderaj, por kjo nuk është shpallur në tender dhe nuk ka pasur mjete të ndara për këtë rrugë. Dhe këto 8 projekte të shpallen tender kanë tejkaluar shumën 6.9 milion €, diku 7.400.000 me duket, nuk e kam këtu regjistrin, por çka dëshiroj ky fond i ndarë prej Qeverisë prej 6.9 milion me 3 dhjetor është alukuar në Ministrinë e Transportit. Ministria e Transportit i ka marr hapat ashtu që me 7 dhe 8 dhjetor 2004 ka zotuar këto mjete për projektet e destinuara, por me 20 dhjetor këto mjete humbin, përkatësisht nuk kanë ardhur asnjëherë në Ministrinë e Transportit. Unë kam bërë disa herë kërkesë në Qeveri që këto mjete të kthehen për t'i realizuar këto projekte, por asnjëherë nuk kam hasur në mirëkuptim, përkatësisht është menduar se është kërkesë e pabazë dhe sot e kësaj dite këto mjete nuk kanë ardhur në Ministri dhe si të tilla 8 projekte kanë mbetur pa mbulesë financiare.

REBIS-i që ka të bëjë me rrugët është shkrirë në organizmin që është ndërtuar nga Komisioni Evropian, përkatësisht Observatoriumi i Transportit për shtetet e Evropës Juglindore dhe këtu Ministria merr pjesë aktive. Në këtë organizëm janë tri nivele, është koordinatori nacional, Komiteti drejtues dhe Grupi i nivelit të lartë që është në kuadër të Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian që përcaktohen kriteret dhe mënyrat dhe destinohen se cilat rrugë praktikisht janë të pan evropiane dhe kalkulime të ndryshme. Ne këtu marrim pjesë, në Sekretariatin ISTITUS, është në Beograd, dhe kjo nuk është bërë në kohën e ministrit, por mendoj është përcaktuar nga SITO-ja para se të vij këtu. Ne bashkëpunojmë dhe unë e dhashë një informatë pak ma herët si informatë e gëzueshme që në kuadër të asaj SITO-je që kemi dy projekte në mesin e 20-vë që është një sukses shumë i madh dhe ky tregon për një aktivitet të Ministrisë. Nëse nuk ju lodhi, unë mund t'u jap edhe shumë elemente tjera. Në takimin e parë ministrorë që është mbajtur në Shkup, pra SITO-ja, ne e kemi hundhër një dokument prej 60 faqe, po mendoj takimi ministror që ka pasur kontribut edhe Ministria e Transportit përmes Komitetit Drejtues, në të cilat faqe ka qenë një numër i madh i projekteve rajonale për këtë pjesën tonë, po asnjë projekt i Kosovës dhe prej Takimit ministror të ministrave të SITO-së është marrë vendim që të krijojmë kriteret e reja, dhe kur ka ndodhur me 10 nëntor të vitit 2005, janë formuar kriteret e reja dhe tash në bazë të kritereve të reja dhe veprimit që kem ndërmarrë bashkërisht me shtetet tjera përreth, ne kemi arritur që t'i kemi dy projekte në kuadër të prioriteteve nga d.m.th në mesin e 20 projekteve, që

konsideroj që për 5 vitet e ardhshme mund të marrim, mund të kemi investime 154 milion siç u thash pak ma herët.

Rreth shtimit të fondeve. Unë po i jap vetit të drejtë, meqë nga diskutimi i parë sikur është paraqitura me shkrim, bërja me shkrim e informatës, përkatësisht përgjigjes nuk është lexua. Për mirëmbajtje të rregullt verore në bazë të studimeve, që i kemi të Ministrisë, të AER-it, të Bankës Botërore, në rrugët e Kosovës aty që është përgjegjës Ministria e që janë rrugët magjistrale dhe regionale që kapin 1 km 630.40 km është magjistrale dhe 1.244.7 janë regionale, nevojiten 14 milion €. Sot Ministria e Transportit, por edhe në vitin e kaluar për mirëmbajtje të rrugëve i ka 5 milion €, 4 milion e gjysmë janë për mirëmbajtje verore, 500 mijë janë për mirëmbajtje dimërore, 2.700 mijë janë obligime ligjore, përkatësisht është ajo garancioni 10% i një vitit paraprakisht dhe tash mendohuni nëse jua merr mendja që me 5 milion € të mirëmbahen 2000 km rrugë në nivelin çfarë dëshirojmë dhe që janë me vite të tëra, përkatësisht është bërë paraprakisht, por edhe tash në vazhdimësi edhe vetë mund të jap përgjigje. Pjesa tjetër, nga i njëjtë studim për rehabilitimin e rrugëve në ristrukturimin e atyre magjistrale rajonale, për dhjetë vjetët e ardhshëm nevojiten 48 milion € në vit. Prandaj, për këtë arsy, duke pasur parasysh këtë studim, unë kam propozuar, pra Ministria e Transportit ka propozuar disa here në Qeverinë e kryesuar – atëherë ishte Bajram Kosumi, të themelojmë Fondin e rrugëve në i-dili do të mbushej, pastaj prej taksave të destinuara. Një prej taksave është taksa rrugore. Parimisht në Qeveri është përkrahur një propozim i tillë, por themelimi i fondeve ju e dini se është pengesë Ligji për menagjimin publik të financave, prandaj kemi nismën në Qeveri që të bëjmë ndryshimin dhe amendamentimin e këtij ligji. Megjithatë nuk ka shkuar lehtë, sepse këtë nismë duhet ta marrë Këshilli Fiskal. Ju e dini pastaj se si shkon procedura që të vij deri këtu. Por unë insistoj, megjithatë, insistoj që të kemi një fond për ndërtimin e rrugëve enkas, që do të grumbullohen nga taksat e rrugëve edhe taksa të tjera që unë sot nuk dëshiroj t'ju lodhi të cilat do të ishin mbushë, por që do të miratoheshin ose ratifikoheshin këtu në Kuvend.

Është e vërtetë, thashë se është bërë një studim për herë të parë i rrugëve të Kosovës duke filluar prej strukturës së rrugës deri në asfalt. Gjendja e rrugëve të Kosovës edhe ato ne në pamje të parë na duken shumë të mira- nëse kemi pjesë të mira. Edhe ato janë të mjerueshme nga të dhënët, nga shqyrtimet, sepse janë ndërtuar në një kohë tjetër, me një trafik tjetër, me një bazë tjetër, pra trupi i rrugës nuk është ndërtuar që të kemi pesha çfarë i kemi sot, trafikun çfarë e kemi sot, prandaj nevojiten shumë investime. Në region përrugë ndahen 10 deri 12% të buxhetit të përgjithshëm të vendit. Ka vende që ndajnë edhe 20% të buxhetit të përgjithshëm të vendit, ne i ndajmë 2% 3.4%. Në kërkësën e Ministrisë, në bazë të ekspertëve që i kemi dhe planifikimet që janë bërë, kriteret që i kam paraqitur në propozim të Qeverisë kemi kërkuar 72. milion e 780 mijë euro për vitin 2006, meqë planifikimi 2005 unë nuk kam qenë ministër, por nga kjo shumë është ndarë vetëm 27 milion, e keni të shënuar atje. Ju faleminderit!

Çështja e fizibilitetit të autostradës dhe rrugët e Kosovës. Unë edhe në përgjigjen e parë, mendoj në fjalimin e parë nuk e mohova një studim që është bërë nga Drejtoria e Rrugëve, përkatësisht nga Ministria. Studimi i tillë për autostradën a nuk është pranuar nga Banka Botërore dhe institucionet ndërkombëtare, me fjalë tjera, nuk njihet. Si e tillë është dashur dhe duhet të bëhet arsyeshmëria ekonomike, përkatësisht fizibiliteti i rrugëve të Kosovës dhe këtë e kemi futur fizibilitetin e autostradës, pra korridori i shtatë dhe korridorit të gjashtë që pak ma herët ju thashë.

Rreth autostradës, me projekte të autostradës u tha shumë. nëse mund ta përfshijë, një projekt zbatues bëhet për autostradë dhe është fizibiliteti, projekt i dytë, përkatësisht fizibiliteti i rrugëve të Kosovës është i pari, pastaj vjen projekt zbatuesi i autostradës, projekt zbatues është përfunduar, fizibiliteti duhet të përfundojë diku në shtator dhe me këtë kompletohet pjesa e parë, por ju thashë është më në fillim për shkak se nuk kemi pasur studim të fizibilitetit është dashur të mjeket, të largohen objektet e caktuara gjatë përpunimit të projektit, po qe nuk e kanë dëmtuar projektin. Janë shqyrtimet gjeofizike, sizmike, shqyrtimet e urave që kanë më tepër ato janë larguar në bazë me qëllim që të vijnë në koston. Nuk kanë pasur mundësi një projekt që ka filluar në vitin 2004 të fillojë rishtas atëherë kur kontrata ka qenë e nënshkruar nën kontratën e tillë 80% të mjeteve kompania e ka marr përsipër, prandaj është dashur me vazhdua në këtë shtesë siç ju dhashë edhe në fillim. Duhet të ndalem edhe në disa elemente, por mbetën disa rrugë pse nuk kanë vazhduar. Unë si ministër kam pasur të detyrë dhe kam qasje që të gjitha to rrugë të cilat kanë filluar në vitin 2004, në momentin kur kam ardhur kam dalë, kam vazhdua kontinuitetin e ndërtimit. Asnjë rrugë nuk e kam ndërpore, sepse parimisht edhe logjikisht ndryshimet e ministrave dhe qeverive ju e dini ma mirë se unë, nuk do të thotë të fillohet prej fillimit, jam startuar në të gjitha ato, por unë jam ballafaquar me një mungesë të mjeteve prej 90 milion e 800 mijë të kontratave të vitit 2004, që është dashur të vazhdohet në vitin 2005 dhe këtë e kam vazhduar. Jam ballafaquar me një numër 37 projekteve pa mbulesë financiare, gjithnjë kam thënë është dëshirë që të ndërtohen sa më shumë rrugë, por unë mund t'jua lexoj të gjithëve juve këtu, cilat rrugë kanë qenë të shpallura pa mbulesë financiare, normalisht i kam marr prej grupit të ekspertëve. E di që do t'ju merr kohë, por, atëherë do t'ju kursej. Ju faleminderit!

Falënderoj në veçanti deputeten Hatixhe Hoxha që ka përmendur projektin Zhegë-Stanqiq - Kumanovë nëse gjatë miratimit të buxhetit ky projekt veç është futur nga Qeveria dhe është në fazë e sipër. Tash është në fazën e procesit të tenderimit dhe besoj që këtë vit do të hapet. Mbyllja e rrugës në Kaçanik veç këtu e ka dokumentuar që Kosovës i nevojiten edhe rrugë të tjera për lidhje me Evropën. U mundova të përgjigjëm rreth bllokimit të rrugës në Kaçanik. Ju lutemi kemi të bëjmë me një rrugë të Kosovës gjatë 20 viteve të fundit, nëse nuk keni durim unë e shkurtoj përgjigjen. Në 20 vitet e fundit rrugët e Kosovës po shkojnë përmes kodrave – shpateve, nuk, nuk janë mirëmbajtur kemi këtë shfrytëzim të kodrave qoftë prej druri qoftë edhe eksplorativ prej kodrave. Sot sipas informatave që kam prej Komisionit për Miniera dhe Minerale diku në Kosovë veprojnë 406 kompani ose ndërmarrje që eksplorojnë gurë, dhe nëpër kodra, male në tokën e Kosovës që nuk janë të licencuara dhe prej tyre është një numër simbolik, mendoj diku nëse nuk kam harruar 40 – 45 kompani që nuk janë të licencuara dhe këto shkaktojnë probleme... Në këtë viti kishim edhe një shumë të madhe të shiut e të borës dhe ajo shkaktoi një lëvizje më të madhe të dheut. Kjo lëvizje e dheut nuk ndodhë vetëm në Kosovë, ndodhin anë e kënd botës ndodhin në Shqipëri, në Maqedoni, në Serbi këtë pjesë të regjionit, por ndodhin edhe në pjesë tjera. Po them kjo është lëvizje e natyrshme e dheut, por nuk është e natyrshme kur veprohet ilegalisht. Në mes të dy tuneleve në rrugën për Kaçanik-Han të Elezit në 100 metra vija ajrore, prapa në kodrën, në anën e majtë vepron ilegalisht, mendoj eksploraton ilegalisht një ndërmarrje nxjerr dhe, ju e dini si bëhet ajo, kur vihet eksplozivi nuk ka qare pa pasur dridhje mund të jetë rezultat edhe i asaj lëvizjeje. Në Qeveri këto e kemi ngritë dhe janë marrë masat që qeveritë përkatëse të punojnë dhe të pengohen këto, pra Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Ministria Minierave dhe Mineraleve, edhe pse në këtu ka pak përgjegjësi se është përgjegjësia më tepër e Komisionit për Miniera dhe Minerale.

Prapë është një pyetje rreth korridorit. Edhe disa fjali rrreth kodrës së Kaçanikut. Është kryer pjesa e parë d.m.th. faza emergjente. Tash javën që shkoi është nënshkruar marrëveshja dhe kontrata me një ndërmarrje që do të bënë shqyrtimet gjeofizike dhe gjeologjike të tokës dhe pas shqyrtime gjeologjike gjeofizike të tokës sipas sugjerimit të kompanisë do të shohim se si duhet të stabilizohet ajo kodër në pikëpamje afatgjate. Sa do të kushton kjo, vërtet është vështirë të paramendohet se do të varen prej rezultatit të këtij shqyrtimi. Nëse mendohet se kodra do të ketë lëvizje, nëse e marrim pjesën më të keqe, do të ketë lëvizje dhe do të duhet vendosen muret mbrojtëse ashtu siç është ndërtuar kaskadat, mund të shkon deri në 7 - 800 mijë €, por kjo është vetëm një propozim, por do të shohim pas shqyrtimit. Normalisht kjo përsëri më është ngarkuar nga Qeveria që të vazhdojë, edhe pse praktikisht drejtpërdrejtë nuk i takon Ministrisë, ka edhe një element, një çështje që ndoshta që duhet ta ngriti këtu. Unë e thash edhe me herët, ne nuk kemi ligj për çështjet, për rastet emergjente, katastrofat natyrore, dikush e quajti katastrofë njerëzore, tregomëni kush e ka shkaktuar këtë atëherë do ta nisim procedurën.

Unë kam konstatuar se kjo që ka ndodhur në Kaçanik është katastrofë humanitare ose natyrore, por këtë çështje po e ngriti me qëllim, që do të duhej, më kanë propozuar këta edhe ne Qeveri, do të duhej ta bëjë një rregullore ose ta bëjmë një ligj në bazë të cilit duhet të ndajmë kapacitete njerëzore dhe kapacitete teknike në rastet e këtilla jo të kontraktohen kontraktorët ishin procedurat emergjente, por si çdokund në botë me rastin e regjistrimit të kompanive, ndërmarrjeve që merren me ndërtimë në rastin e regjistrimit i caktohet se kjo forcë ose masë teknike lihet dhe prej shtetit merret për ta tejkaluar gjendjen faktike, përkatësisht gjendjen me rastin e katastrofave humanitare. Prandaj, kjo nuk ekziston procedura për këtë pastaj janë shumë më të rënda.

A kalon korridori i 7-të sipas projektit nëpër basenin e energjisë elektrike, e keni pasur këtë rast sepse bashkëpunojmë me ministrinë se nuk jemi ndaras me ministritë përkatëse: Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Minierave dhe të Mineraleve. Projekti në fazën e – ka kaluar nëpërmes basenit d si quhet nga Ministria e Minierave dhe Mineraleve, ku është baseni 2 i lignitit, pra tha thëngjillit. Kemi kërkuar që ta ndërrojmë destinacionin, përkatësisht nuk kalon tash nëpër 50% kalon në një pjesë që marrë në tërësi prej projektit të parë është diku 2%, me fjalë tjera është larguar prej krejt basenit, madje dikush atje thotë po e ndërtojmë këtë për ... se derisa ta shfrytëzojmë këtë thëngjill do të vijë koha që ta ndërtojmë përsëri vijën e drejtë këtu ka humbur një element i, një standard në kuptimin – 1 km e 200 metra. Autostrada nuk e plotëson kushtin e shpejtësisë 220 km për shkak të atij devijimi.

Kjo kompania IBGJ Beton, unë më duket se e dhashë përgjigjen se ka të bëjë me aeroportin që nuk është në kompetencë të Ministrisë. Ka këtu shumë rrugë që janë filluar dhe kanë përfunduar atëherë kur kam qenë ministër prandaj nuk e shohë të arsyeshme që të përgjigjem.

Sa do të janë të hyrat nga taksat rrugore. Është planifikuar sepse numri i automjeteve të regjistruara në Kosovë nuk dihet, kur them nuk dihet për shkak se nuk kemi një rregullore obligative që me rastin e daljes së afatit të regjistrimit të automjeteve të paraqiten në organet përkatëse dhe te dimë numrin e saktë. Po ky numri i automjeteve sillet diku prej 280.000 deri në 340.000 automjete. Nëse merret në treqind mish atje nga 40 € ishin diku 12 apo 13 milion € mund të grumbullohen nga kjo taksë. Sa janë humbjet për shkak të mbylljes së rrugës Kaçanik. Unë e dëgjova mbrëmë një koment që u tha 9.1% janë të hyrat më të vogla në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nuk u tha se 9.1% të hyrat në fazën kur kjo rrugë është e mbyllur, dhe

këtu ka një dallim. Pastaj, kam dëgjuar doganat, në kohën kur ka qenë e mbyllur rruga është thënë: se Buxheti i konsoliduar i Kosovës është mbushë për 2 milion më shumë se sa në të njëjtën periudhë, rruga ka qenë e mbyllur. Këtu ka kalkulime që nuk ishin ashtu. Disa rrugë që u përmendën këtu dhe që nuk kanë filluar të zbatohen janë në mesin e atyre rrugëve, ju thashë që janë pa mbulesë.

Liqji për sigurinë e rrugëve u tha, unë edhe një here për këto bunarë jemi në fazën e përfundimit. Nesër përfundon procesi ligjor i tenderimit të kompanive për mirëmbajtjen verore, nëse nuk do të ketë ankesa, prej të hënës kontratat nënshkruhen dhe fillon të mbyllen dhe me këto mjete që i kemi ne do të mundohemi që t'i harrojmë gjithë ato rrugë, normalisht se këto bunarë e ju veç i quajtët bunarë, unë nuk i kisha quajtur kështu, por do të mbyllen dhe do të kemi një rrugë për aq sa kemi mundësi dhe për aq sa kemi buxhet të jetë më mirë, prandaj edhe një herë ju falënderoj nëse i kom mbetur borxh dikujt për përgjigje do të jap. Ju faleminderit!

#### KRYESUESI – Ju faleminderit z. Ministër.

Konstatoj se debati është pothuajse në përfundim, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që të paraqesë mendimin e vet lidhur me interpelancën.

**DEPUTETI JAKUP KRASNSIQI** – Unë po them drejt e kam përcjellë debatin dhe më vjen mirë që pjesa më e madhe e deputetëve kalojnë nëpër rrugë të mira të asfaltuar pa gropa dhe nuk janë të shqetësuar shumë për gjendjen e rrugëve. Po përgjigjem z.deputet dhe akademik. Përgjegjësinë për numrin e automjeteve, ju lutem do të përgjigjem, se ke pyetur, e ka administrata e Ministrisë të Shërbimeve Publike. Për qarkullimin e automjeteve të paregjistruara përgjegjësinë e ka policia e komunikacionit. Gjendja në të gjitha rrugët e Kosovës është e keqe dhe mendoj që për këtë u folë shumë këtu. Ministria duhet të hartoje strategjinë e daljes nga kjo gjendje. Duhet të ketë një pasqyrë të tërësishme, do të ketë një plan të detajuar afatshkurtër dhe afatmesëm, thënë ndryshe një plan emergjent për ta sanuar gjendjen e rrugëve në Kosovë, se përndryshtë kështu po dëmtohet fuqia e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, por edhe e qytetarëve. Në praktikat e njohura evropiane e botërore, korridoret rrugore kanë rëndësi të veçantë për ekonominë, zhvillimin ekonomik. Mekanizmat financiar evropian e ndërkombëtar shpesh ndihmojnë dhe financojnë projekte të rrugëve me rëndësi të vendeve në transicion. Po donatorët e fuqishëm evropian e ndërkombëtar kërkojnë respektim të standardeve studimore e projektuese. Studimet e fizibilitetit, studimet e ndikimeve të ambientit, përgatitja e infrastrukturës ligjore, pra kërkohet hartimi dhe miratimi i disa ligjeve dhe kanë mbetur pa u miratuar këto ligje, që mendoj Ministria duhet të përshtaptohet në këtë plan. Ligji për sigurinë në komunikacion. Ligjet që lidhen me ndikimet e ambientit, Ligjin e trashëgimisë kulturore, Ligjin mbi shpronësimet dhe Ligjin mbi pasuritë natyrore ku hyjnë minierat dhe të tjera. Pastaj, ne mendojmë se edhe doli nga ky debat se nuk të krijuar mekanizma për mbikëqyrjen e kontrollin e kryerjes së punëve në rrugët e Kosovës. Pastaj, mungojnë laboratorët për ta kontrolluar cilësinë e asfaltit.

Nga të gjitha këto që u thanë, pra mos ta zgjatum dëmet ekonomike, dëmet financiare për xhepat e qytetarëve, fatkeqësitet e shpeshta, keq shfrytëzimi i Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, humbjet e shpeshta të jetëve të njerëzve në komunikacion, mendoj që, por në mënyrë të veçantë dua ta ceku siç tha në përgjigjen e fundit ministri 6.9 milion janë

humbur, ku kanë shkuar nuk e di, po 6.9 milion është një shumë dhe Qeveria dhe Ministria janë përgjegjëse për këtë shumë. Me ligj lejohet tejkalimi i mjeteve financiare për një projekt deri në 10%. Për projektin e rrugës Merdar-Morinë është e kaluar do të thotë 35% është e kaluar 2.5 here. Nuk po i numëroj parregullsitë e tjera se ka edhe parregullsi të tjera që i di ministri, sidomos në dhënien e tenderëve për mirëmbajtjen e rrugëve të 7 – 8 qendrave të Kosovës, po e përmendi vetëm rastin e Prishtinës, ku ofertuesi i parë i paaftë për t'i kryer punët fillimisht ka qenë më i lirë se i dyti 40 e 3000 €, pastaj ofertuesit të parë i është ngritur shuma me një diferenca prej 2000 € dhe krejt në fund i janë shtuar edhe 1500 € dhe diferenca ka mbetur në 500 €. Mendoj se janë këto shkelje, që i di edhe Ministri, disa nuk janë vetëm të ministrit, por janë edhe të Qeverisë, dhe përgjegjësia është e Qeverisë, ne si kërkues dhe shtrues të interpelancës kërkojmë që të formohet së paku një komision hetimor për t'i gjetur se ku kanë mbetur 6.9 milion € të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Ju faleminderit!

**KRYESUESI** – Ju faleminderit! – ministri e ka kërkuar për një sqarim të shkurtër fjalën

**QEMAJL AHMETI MINISTËR** – Ju faleminderit! unë nuk dëshiroj t'ju marr kohë shumë, por kjo vlera prej 6.9 milion ndoshta e kam thënë kanë humbur. Unë e kam pasur mendimin të them ato mjete nuk kanë ardhur fare në Ministri dhe se janë shkri në buxhetin 2005, por nuk ka të bëjë me humbje, por nuk kanë ardhur në buxhetin e Ministrisë së Transportit, prandaj kërkoi falje për keqinterpretim, dhe sa i përket projektitligjeve, përpërsë Ligjit për shpronësim që e kemi ngritur në Qeveri dhe është kah punohet në Parlament, këto ligjet e tjera nuk i takojnë Ministrisë së Transportit. Ligji përsiguri është shqyrtua në Parlament. Ju faleminderit!

**KRYESUESI** – Ju faleminderit z. ministër, ju faleminderit të nderuar deputetë. Seanca e sotme mori fund. Nesër në orën 10,00 fillon seanca e paralajmëruar për propozimet dhe kërkesat që u janë bërë ministrit dhe Ministrisë dhe ky i fundit, grupet parlamentare, deputetët duhet të ndjekin procedurat e rrugullta dhe të bëjnë kërkesa. Ju faleminderit!